



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER



Interethnic Integration in Education Project



PRAKTIKUM

PËR INTEGRIMIN E

MËSIMIT MULTIKULTUROR

NË MËSIMDHËNIE

NË ARSIMIN FILLOR

DHE TË MESËM



PRAKTIKUM
PËR INTEGRIMIN E
MËSIMIT MULTIKULTUROR
NË MËSIMDHËNIE
NË ARSIMIN FILLOR
DHE TË MESËM



Shkup, 2016

Ky botim është përgatitur me ndihmën e Projektit të USAID-it për Integrim Ndëretnik në Arsim, në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim. Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik në Arsim është zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ). Përmbajtja e dokumentit u takon autorëve dhe nuk i shpreh qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Boton:

QMEQ në kuadër të projektit të USAID-it për Integrim Nderetnik në Arsim

Autorë:

Ajshe Ajrullai (Byroja për Zhvillimin e Arsimit)
Alma Tasevska (Instituti i Pedagogjisë)
Anita Angellovska (SHF „Kërste Misirkov,, Shkup)
Ardijana Palloshi (Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim)
Dijana Karavilloska (SHF „Mançu Matak,, Krivogashtani)
Zhaneta Çonteva (Byroja për Zhvillimin e Arsimit)
Jasmina Atanasova - Simjanoska (ShMNGjQSh „Zdravko Cvetkovski,, Shkup)
Lepa Terpcavska (Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim)
Liljana Samarxhiska (Byroja për Zhvillimin e Arsimit)
Snezhana Jankullovska (QMEQ)
Tylaj Tahir (QMEQ)
Ana Piskaçeva (QMEQ)

Redaksia profesionale:

Mitko Çeshllarov (Byroja për Zhvillimin e Arsimit)

Bashkëpunëtorë gjatë përgatitjes së publikimit:

Loreta Georgieva (QMEQ)
Svetlana Gashoska (QMEQ)
Nebojska Mojsoski (QMEQ)

Përkthimi dhe lektura shqip:

Nazif Zejnullahu

Disenji:

KOMA design studio

Shtyp:

Peçatnica Napredok DOOEL - Tetovë

Tirazhi:

850

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје
373.3/.5.035(076)

PRAKTIKUM për integrimin e mësimit multikulturor në mësime ndëretnik
në arsimin fillor dhe të mesëm / [autorë Ajshe Ajrullai ... и др.]. - Shkup :
Qendra maqedonase për edukim qytetar (QMEQ), 2016. - 146 стр. : илустр. ; 30 см

Publikacijata e во рамки на проектот: "Për integrim ndëretnik në
arsim". - Автори: Ajshe Ajrullai, Alma Tasevska, Anita Angellovska,
Ardijana Palloshi, Dijana Karavilloska, Zhaneta Çonteva, Jasmina
Atanasova-Simjanoska, Lepa Terpcavska, Liljana Samarxhiska, Snezhana
Jankullovska, Tylaj Tahir, Ana Piskaçeva. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4529-69-9

1. Ajrullai, Ajshe [автор]

а) Основно образование - Мултикултурно учење - Практикуми

б) Средно образование - Мултикултурно учење - Практикуми

COBISS.MK-ID 102287370

PËRMBAJTJE



HYRJE	7
PËR PRAKTIKUMIN	8
SHEMBUJ PËR MËSIM MULTIKULTUROR NË ARSIMIN FILLOR	11
1. „ALO...ALO”	12
2. AUTORË DHE VEPRA	14
3. URIME PËR MUA, PËR TY, PËR TË GJITHË NE.....	18
4. LLOJLLOJSHMËRIA E VESHJEVE TONA POPULLORE.....	22
5. „UNË DHE SHOKU IM I RI – NE JEMI TË NGJASHËM DHE TË NDRYSHËM” ..	28
6. TEATRI – ARTI I JETESËS SONË	32
7. FESTAT TONA	36
8. QILIMAT NË KRIJIMTARINË POPULLORE	40
9. ARKITEKTURA E VJETËR QYTETARE	44
10. NJOHJA E KARAKTERISTIKAVE ARKITEKTONIKE TË OBJEKTEVE RELIGJIOZE	48
11. NGA IDEJA NË REALIZIM.....	52
12. SI TË KOMUNIKOJMË MË MIRË?	56
13. KUSH JEMI NE NË MAQEDONI?	62
14. ISLAMI DHE KRISHTERIMI	66
15. ZBULIMI I BOTËS SË RE	70
16. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E FËMIJËVE	74
17. DITARI – DËSHMITARI I HISTORISË.....	78
18. DIVERSITET DHE EMPATI	82
19. SI TË ZGJIDHET KONFLIKTI NË MËNYRË PAQËSORE	88
20. KËNGË POPULLORE TË DASHURISË	94

21. KULTURA TË NDRYSHME DHE PASURIA E TYRE.....	96
22. A ËSHTË KY KONFLIKT?	100
23. PUNIM GAZETARESK PËR BASHKËSITË KULTURORE	104
24. ALL READY AND PACKED.....	108

**SHEMBUJ PËR MËSIM MULTIKULTUROR
NË ARSIMIN E MËSËM 113**

1. „JO”, DISKRIMINIMIT.....	114
2. ETNO-ORNAMENTE.....	120
3. PASURI E KULTURAVE TË NDRYSHME	124
4. PLANI I RI URBANISTIK	128
5. KRAHASIMI I NDËRTIMEVE TË VJETRA NË MAQEDONI	132
6. SAPUNI DJE DHE SOT	136
7. PRODHIMI TRADICIONAL KUNDREJT ATIJ BASHKËKOHOR I KREMRAVE	138
8. HACCP dhe HALLALL	142



HYRJE



Praktikumi për integrimin e mësimit multikulturor në lëndët e mësimit të rregullt në arsimin fillor dhe të mesëm doli si rezultat i përvojave nga Projekti i USAID-it për Integrim Ndëretnik në Arsim (PINA), që është implementuar nga ana e Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe me institucionet arsimore kyçe: Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA), Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT), Inspektoratin Shtetëror të Arsimit (ISHA) dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP) në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi kryesor i PINA është që t'u ndihmohet shkollave fillore dhe të mesme që të realizojnë aktivitete të cilat te nxënësit zhvillojnë vlera për integrim ndëretnik në arsim (INA). Kjo praktikisht do të thotë se nxënësit kanë mundësi të fitojnë kompetenca të nevojshme për të jetuar në një shoqëri multikulturore në frymën e mirëkuptimit të ndërsjellë, të paqes, të respektimit të të tjerëve, pranimit të dallimeve dhe të së drejtës për të qenë të gjithë njësoj.

Bazë për përgatitjen e Praktikimit ishin arritjet e realizuara nga *Analiza e programeve mësimore nga arsimit fillor dhe gjimnazial dhe i programeve mësimore për arsimin e mesëm profesional (Analiza)*. Analiza ishte realizuar nga grupi i punës¹ i përbërë nga këshilltarë nga BZHA dhe QAPT, me mbështetjen e ekipit të PINA. Me Analizën u vërtetua prania e elementeve multikulturore dhe multi-etnike në qëllimet e programeve mësimore, që jep mundësi për integrimin e këtyre elementeve në përmbajtjet mësimore në lëndë të caktuara mësimore.

Si rezultat i njohurive nga Analiza, grupi i punës inicioi përgatitjen e Praktikimit me shembuj praktikë të aktiviteteve për integrimin e përbajtjeve multikulturore në lëndë të caktuara mësimore, gjë që mësimdhënësve do t'u ndihmojë në arritjen e qëllimeve për ngritjen e vlerave dhe qëndrimeve pozitive për integrim ndëretnik te nxënësit. Besojmë se të rinjtë kanë potencial jashtëzakonisht të madh që të ngrenë vlera dhe qëndrime të këtyra dhe të kontribuojnë në përparimin e integritit ndëretnik dhe në zhvillimin e shoqërisë sonë. Me këtë rast, mësimdhënësit janë ata të cilët më së miri mund t'i japin kahe energjisë dhe entuziazmit të tyre në mënyrë pozitive në ndërmarrjen e aksioneve demokratike për futjen e ndryshimeve në kontekstin shkollor e më gjerë. Këtë praktikum, gjithashtu, mund ta shfrytëzojnë edhe profesorët nga fakultetet për mësimdhënës në mësimin praktik me studentët e tyre, për përgatitjen adekuate të tyre në realizimin e ardhshëm të aktiviteteve për mësim multikulturor.

1 Grupi i punës është i përbërë nga këshilltarët nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit: Liljana Samarxhiska, Ajshe Ajrullai dhe Zhaneta Çonteva; dhe këshilltarët nga Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim: Adrijana Palloshi dhe Lepa Tërçevska.

PËR PRAKTIKUMIN



Praktikumi përmban shembuj aktiviteteve për mësim multikulturor, të cilat realizohen me nxënës që mësojnë në të njëjtën gjuhë mësimore në kuadër të mësimin të rregullt në arsimin fillor dhe të mesëm. Shembujt e ofruar janë të integruar në lëndë të caktuara për periudha të caktuara arsimore dhe janë në kuadër të qëllimeve dhe përmbajtjeve ekzistuese nga programet mësimore, të cilat në mënyrë eksplicite ose implicite kanë të bëjnë me sfera të caktuara të mësimin multikulturor: **1)** multikulturalizmin, **2)** të drejtat e njeriut, demokracinë, drejtësinë dhe barazinë sociale, **3)** stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimin, **4)** zgjidhjen e konflikteve.

Shembujt e aktiviteteve që kontribuojnë që nxënësit të zhvillojnë kompetencat nga mësimi multikulturor kanë të bëjnë me këto sfera dhe aspekte:

1. MULTIKULTURALIZMIN

- ▶ Njohjen me vlerat e kulturës së vet dhe me veçoritë e kulturave të tjera.
- ▶ Zhvillimin e identitetit kulturor pozitiv.
- ▶ Njohjen e ngjashmërive dhe të dallimeve midis njerëzve të kulturave të ndryshme.
- ▶ Zhvillimin e ndjenjës së respektit, empatisë, besimit dhe pranimit të kulturave të tjera.
- ▶ Zhvillimin e shkathtësive për komunikim dhe bashkëpunim.

2. TË DREJTAT E NJERIUT, DEMOKRACINË, DREJTËSINË DHE BARAZINË SOCIALE

- ▶ Të kuptuarit e parimeve të të drejtave të njeriut.
- ▶ Zbatimin e konceptit për të drejtat e njeriut në situatat nga përditshmëria.
- ▶ Përballjen me sfidat e padrejtësisë dhe të ndërmarrjes së aksioneve për drejtësi sociale.
- ▶ Ngritjen e aksioneve demokratike dhe futjen e ndryshimeve në kontekstin shkollor dhe më gjerë.

3. STEREOTIPET, PARAGJYKIMET DHE DISKRIMINIMIN

- ▶ Njohjen dhe uljen e stereotipeve e të paragjykimeve.
- ▶ Ballafaqimin me sfidat e diskriminimit.

4. ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE

- ▶ Njohjen me faktorët për krijimin e konflikteve.
- ▶ Njohjen me parimet për zgjidhjen e problemeve.
- ▶ Analizimin dhe zgjidhjen e situatave konfliktuoze.

Shembujt e ofruar drejtpërdrejt mund të merren nga Praktikumi dhe të zbatohen në orën mësimore, e gjithashtu mund të nxisin ide të reja për mësim multikulturor në arsim.


Aktivitetet janë të disenjuara ashtu që përmes aplikimit të ushtrimeve interaktive, nxënësit të angazhohen në mësimin bashkëpunues dhe nga përvoja, me qëllim që më mirë t'i kuptojnë aspektet e mësimit multikulturor dhe të zhvillojnë vlera dhe qëndrime pozitive për integrimin ndëretnik. Shembujt përmbajnë aplikimin e këtyre metodave: të dialogut, të diskutimeve në grupe të vogla ose të mëdha, hulumtimin, luajtjen e roleve, demonstrimin dhe simulimin, analizën e teksteve, të fotografive ose të situatave.

Nxënësit, përveç se mësojnë për përmbajtjet nga sfera e lëndës dhe për multikulturalizmin dhe i arrijnë qëllimet mësimore dhe qëllimet për mësim multikulturor, me zbatimin e këtyre metodave dhe të mësimit mbi këtë përvojë i thellojnë shkathtësitë për komunikim dhe bashkëpunim, për mendim kritik dhe zgjidhjen e problemeve.

Shembujt në Praktikum janë të ndarë në dy pjesë, edhe atë pjesa e parë i kushtohet arsimit fillor, ndërsa pjesa e dytë, arsimit të mesëm. Përmbajtjet e ofruara për disa prej aktiviteteve është e mundur të modifikohen dhe të përshtaten për grup-mosha më të mëdha ose më të vogla të nxënësve.

Shpresojmë se këto shembuj do të paraqesin nxitje për ide të reja të mësimit për integrimin e sa më shumë përmbajtjeve për mësim multikulturor në kuadër të mësimit të rregullt në arsimin fillor dhe të mesëm, e në të njëjtën kohë edhe të profesorët nga fakultetet pedagogjike për edukimin e studentëve të tyre gjatë arsimit të tyre universitarë.



A stylized human figure is depicted in various shades of green, serving as a background for the text. The figure is composed of several overlapping shapes: a large circle for the head, a curved shape for the torso, and a trapezoidal shape for the base. The text is centered over the figure's torso.

**SHEMBUJ
PËR MËSIM
MULTIKULTUROR
NË ARSIMIN
FILLOR**

„ALO...ALO“



Klasa

E PARË

Lënda





GJUHË AMTARE

Tema nga programi
mësimor

DËGJIM DHE TË FOLUR

Njësia mësimore

BISEDË TELEFONIKE

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësjë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ udhëzohet në shfrytëzimin kulturor dhe racional të telefonit për bisedë.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësjë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ zhvillojë shkathtësi për komunikim dhe për bashkëpunim me pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike; ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, të empatisë, të besimit e të pranimit të kulturave të tjera; ▶ zhvillojë identitetin e vet personal dhe të hulumtojë për identitetin e të tjerëve.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Aparati i telefonit. ▶ Audioaparati (diktafon, telefon celular, tablet, e të ngjashme).
	KOHA	<p>Një orë mësimore prej 40 minutash.</p>



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Ora fillon ashtu që mësimitdhënësi bën simulimin e cingërimës së telefonit dhe demonstroi shembullin pozitiv të bisedës telefonike me bashkëfolësin.
2. Pastaj, mësimitdhënësi inicon bisedë me nxënësit se për çka përdoret telefoni dhe shtron pyetje, si për shembull:
 - ▶ A e dini se për se shërben aparati i telefonit?
 - ▶ A e shfrytëzoni në jetën e përditshme për të biseduar me prindërit dhe shokët tuaj?
 - ▶ Sa gjatë flisni në telefon?
 - ▶ A ju është paraqitur gjë më tani ndokush në telefon dhe a ju ka folur në një gjuhë të ndryshme prej asaj që ju e flisni? Po qe se përgjigja është PO, mësimitdhënësi i pyet nxënësit se në cilën gjuhë kanë komunikuar.
 - ▶ Cilën gjuhë e përdorni kur bisedoni në telefon? Gjuhën amtare apo ndonjë tjetër?

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimitdhënësi u shpjegon nxënësve se ka rregulla të caktuara që të çojnë drejt shfrytëzimit kulturor dhe racional të telefonit për bisedë; me këtë rast e shfrytëzon shembullin e vet pozitiv nga fillimi i orës.
2. Mësimitdhënësi i nxit nxënësit që në mënyrë të mëvetësishme të theksojnë shembuj personalë të fjalive shprehëse gjatë shfrytëzimit të telefonit për bisedë.
3. Nxënësit ndahen në çifte dhe secili prej çifteve, njëri pas tjetrit, zhvillojnë bisedë me telefon, duke respektuar rregullat e bisedës.
4. Më tej, mësimitdhënësi i njofton nxënësit edhe me përshëndetjet dhe me shprehjet e shkurtra në gjuhë të tjera, të cilat fliten në rrethinën tonë të drejtpërdrejtë. (Shembull: Добар ден, моето име е Орхан, би сакал да разговарам со Јован; Mirëdita. Emri im është Orhan. Kisha dashur të bisedoj me Jovanin; İyi günler, benim adım Orhan, Yovan ile konuşmak isterdim.)
5. Pas përgatitjes paraprake, mësimitdhënësi me ndihmën e audio-aparatit e incizon të folurit e vet dhe porosinë e shprehjeve në gjuhë të ndryshme dhe këtë material e shfrytëzon në punë me nxënësit në grupe.
6. Mësimitdhënësi i ndan nxënësit në tri grupe, me detyrë që ta mësojnë konverzacionin themelor me telefon në gjuhët që shfrytëzohen në rrethin tonë
7. Nxënësit, në kuadër të grupit, i dëgjojnë porosinë e shprehjeve të shkurtra të incizuara më parë që shfrytëzohen gjatë bisedës me telefon në gjuhë të ndryshme prej asaj që flasin dhe secili prej fëmijëve, në kuadër të grupit, përpiket që t'i përsërit frazat dhe fjalitë shprehëse.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Për të kontrolluar arritjen e qëllimeve, të gjithë bashkë i dëgjojnë porosinë e veçanta dhe nxënësit duhet të njohin gjuhën në të cilën bisedohet.
2. Bisedojnë për përvojat personale në lidhje me bisedat telefonike përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Si u ndjetë derisa flisnit me telefon?
 - ▶ Cilat fjalë i përdorët, e cilat fjalë i mësuam, e që kanë të bëjnë me shfrytëzimin kulturor dhe racional të telefonit?
 - ▶ Cilat shprehje të shkurtra për bisedë me telefon i mësuam, e të cilat përdoren në gjuhën e ndryshme prej asaj në të cilën ne flasim?
 - ▶ Si mund të na ndihmojnë shprehjet e shkurtra në gjuhë të ndryshme, të cilat i mësuam në jetën e përditshme?
 - ▶ A ndihemi më të pasur kur dimë se si të drejtohem në më shumë gjuhë?

AUTORË DHE VEPRA



Klasa

E DYTË

Lënda

GJUHË AMTARE

Tema nga programi
mësimor

LETËRSI

Njësia mësimore

PËRPUNIMI I TEKSTIT



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ aftësohet të dallojë dhe të njohë titullin e veprës;
- ▶ të dallojë tekstin, ilustrimin, autorin;
- ▶ të aftësohet që t'i dallojë ngjarjet (ndodhitë) dhe personazhet.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me krijime nga shkrimtarë nga kultura të tjera (sidomos nga ata nga rrethina e drejtpërdrejtë);
- ▶ të njihet dhe të udhëzohet drejt vlerave të kulturave të tjera nga rrethina e vet e drejtpërdrejtë;
- ▶ të zhvillojë qasjen e hapur për njohjen e veçorive të kulturave nga rrethina e vet e drejtpërdrejtë;
- ▶ të zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të ndryshme prej të vetes.



RESURSE

- ▶ Një tekst nga përmbledhja me tregime „Orhan” nga autori Nexhati Zekirija. Si alternativë mund të shfrytëzohen edhe fragmente nga vepra të tjera të Nexhati Zekirijas, si për shembull: „Fëmijët e rrugës sonë”, „Fëmijët nga rruga e vjetër”, „Fëmijët nga rruga e re”, „Romeo dhe Zhulieta nga rruga jonë”.
- ▶ Fletë pune.



KOHA

Dy orë mësimore nga 40 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me atë që mësimdhënësi nxënësve u tregon shembullin e librit për fëmijë që përmban tekst dhe ilustrime.
2. Ai ua lexon titullin e librit dhe emrin e autorit dhe ua bën këto pyetje:
 - ▶ Çka është autori dhe cili është roli i tij?
 - ▶ Çka do të thotë ilustrim i librit dhe përse shërben?
 - ▶ Kush e bën ilustrimin e librit?
 - ▶ Cili është libri më i dashur i juaj që keni lexuar deri tani?
 - ▶ A ju kujtohet se kush është autor i atij libri?
 - ▶ Cilët autorë të tjerë i njihni?
 - ▶ Për cilat vepra të njohura të tyre keni dëgjuar?
 - ▶ A keni dëgjuar për ndonjë autor që shkruan në gjuhë të ndryshme nga gjuha në të cilën ju flisni?
 - ▶ A e dini që veprat e këtyre autorëve përkthehen në gjuhë të tjera?
3. Mësimdhënësi bën paralajmërimin e përpunimit të tekstit nga përmbledhja me tregime „Orhan” dhe ua shtron këto pyetje:
 - ▶ A keni dëgjuar për Nexhati Zekirijan, autorin e përmbledhjes me tregime „Orhan”? (Po qe se përgjigjja është JO, në pika të shkurtra mësimdhënësi e paraqet autorin dhe i tregon veprat e tij.)
 - ▶ A keni shokë që flasin në gjuhë tjetër nga gjuha juaj? Si quhet? (Në dërrasë të zezë shkruhen emrat.)
 - ▶ Po qe se nuk ka shokë të tillë, mësimdhënësi e shtron pyetjen: „A mund të kujtoheni në emra të tjerë të njerëzve nga rrethina juaj e drejtpërdrejtë, që janë pjesë e kulturave të tjera?” (Emrat shkruhen në dërrasë të zezë.)

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimdhënësi u lexon nxënësve një tekst nga përmbledhja me tregime „Orhan” dhe i nxit që me kujdes të dëgjojnë, për ta kapur tërësinë e tekstit.
2. Pas leximit, mësimdhënësi i shtron këto pyetje:
 - ▶ Ku ndodh ngjarja kryesore?
 - ▶ Cilat janë përshtypjet tuaja për Orhanin si personazh kryesor në tregim?
 - ▶ Cilat janë vetitë kryesore të Orhanit?
 - ▶ Cilat janë përshtypjet tuaja për personazhet tjera?
 - ▶ Në cilat gjuhë flasin personazhet në tregim?
 - ▶ Si shoqërohen personazhet në tregim?
 - ▶ A shoqëroheni me fëmijë që flasin në gjuhë të tjera?
 - ▶ Cila pjesë e tregimit ju pëlqeu më së shumti?
3. Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit që ta ilustrojnë personazhin kryesor në tekst, Orhanin, të paraqitur përmes një skene, situatë ose vizualizimi...
4. Në fund nxënësit i ekspozojnë punimet e tyre në një vend të caktuar të lokalit.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Ora kryhet me bisedë për pyetjet në vazhdim:

- ▶ Çfarë bëmë sot?
- ▶ Si u ndjemë derisa e lexuam tekstin?
- ▶ Cilat zhvillime i karakterizojnë personazhet kryesore në tekst?
- ▶ Si u ndjemë derisa e ilustruam personazhin kryesor, Orhanin?
- ▶ Cilat emra, si përfaqësues të kulturave të tjera, i dëgjuam në tekst?
- ▶ A mund të theksoni ju ndonjë emër të shokut nga rruga juaj ose nga rrethina e drejtpërdrejtë, që i takon kulturës tjetër?
- ▶ A mund të kujtoni shembull pozitiv nga shoqërimi i përbashkët me fëmijë, sipas shembullit të veprave të autorit Nexhati Zekirija?

UDHËZIME PËR DETYRË SHTËPIE

1. Nxënësit për detyrë shtëpie, duhet të kalojnë në rolin e autorit dhe të mendojnë një tregim të ri për shoqërimin e Orhanit dhe shoqërinë e tij me fëmijë nga mëhalla e tij, që flasin në gjuhë të ndryshme. Prezantimi i detyrës së shtëpisë bëhet në orën vijuese.
2. Për këtë aktivitet, nxënësve u ndahet Fleta e punës 1 dhe u jepen udhëzimet për të shkruar ose për të vizatuar (mundet edhe kombinim të tekstit dhe të vizatimit/ilustrimit), siç është dhënë në Fletën e punës:
 - ▶ titulli i tregimit dhe personazhet kryesore;
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i vendit të ngjarjes (fillimi);
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i ngjarjes së menduar nga shoqërimi i tyre (pjesa kryesore);
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i pjesës përfundimtare të ndodhisë.
(mund të jepet shembull: kremtimi i ditëlindjes, kush kremton ditëlindjen, ku kremtohet, çfarë lojërash luhen e të ngjashme)
3. Në orën vijuese nxënësit i përndajnë tregimet e tyre dhe i prezantojnë ilustrimet.



1. Merrni rolin e autorit dhe sajoni një tregim të ri për shoqërimin e Orhanit dhe të shoqërisë së tij me fëmijët e mëhallës ku flitet në gjuhë të ndryshme.
2. Ndiqni udhëzimet për shkrim ose vizatim (mundet edhe kombinim të tekstit dhe të vizatimit/ilustrimit):
 - ▶ titulli i tregimit dhe personazhet kryesore;
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i vendit të ngjarjes (fillimi i tregimit);
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i ngjarjes së menduar nga shoqërimi i tyre (pjesa kryesore);
 - ▶ përshkrimi ose ilustrimi i pjesës përfundimtare të ngjarjes (pjesa përfundimtare).

TITULLI I TREGIMIT

FILLIMI I TREGIMIT

PERSONAZHET KRYESORE

PJESA KRYESORE

PJESA PËRFUNDIMTARE

URIME PËR MUA, PËR TY, PËR TË GJITHË NE



Klasa

E TRETË

Lënda

GJUHË AMTARE

Tema nga programi
mësimor

SHPREHJE DHE KRIJIM

Njësia mësimore

SI SHKRUHET NJË URIM



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ mësojë të shkruajë urimin;
- ▶ të përshkruajë drejt fjali dhe tekste të shkurtra.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ shfrytëzojë shprehje urimi në gjuhë të ndryshme nga ajo në të cilën flet dhe t'i shkruajë ato me shkrim;
- ▶ zhvillojë identitetin e vet personal dhe të hulumtojë për identitetin e të tjerëve;
- ▶ zhvillojë shkathtësi për komunikim dhe bashkëpunim me moshatarët e vet nga bashkësitë tjera etnike.



RESURSE

- ▶ Materiale për përgatitjen e urimeve.
- ▶ Listë me shprehje për të uruar në më shumë gjuhë.
- ▶ Shtojca 1 – Linqe për te këngët „Gëzuar ditëlindjen” në gjuhë të ndryshme.
- ▶ Shtojca 2 – Shprehje urimi për ditëlindje në më shumë gjuhë.



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI HYRËS

1. Aktiviteti fillon ashtu që nxënësit dëgjojnë këngë të ditëlindjes, ndërsa mësimdhënësi i nxit të shprehen me lëvizje sipas kompozicionit të dhënë.
2. Mësimdhënësi i nxit nxënësit në disponim pozitiv me anë të bisedës:
 - ▶ Si i kremtoni ditëlindjet tuaja?
 - ▶ A pranoni urime për ditëlindje?
 - ▶ Çfarë dhuratash më shpesh ju dhurojnë?
 - ▶ Me cilën shprehje verbale ju urojnë ditëlindjen?
 - ▶ Cilat shprehje i dini dhe i këndonin në gjuhë tjetër, me të cilat urohet ditëlindja?
 - ▶ A dini ndonjë këngë në gjuhë tjetër nga rrethinat tona, me të cilat urohet ditëlindja?
 - ▶ A doni që të dëgjojmë ndonjë këngë në gjuhë tjetër nga rrethinat tona dhe të mësojmë se si urohet ditëlindja në më shumë gjuhë?

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësve u jepen udhëzime se në aktivitetin vijues do të dëgjojnë këngë për ditëlindje në më shumë gjuhë dhe do të përgatisin urime në të cilat do t'i shkruajnë shprehjet për urimin e ditëlindjes në më shumë gjuhë.
2. Derisa shkon muzika e këngëve që lidhen me kremtimin e ditëlindjes, të kënduara në gjuhë të ndryshme (shih Shtojcën 1 – Linqe deri te këngët "Gëzuar ditëlindjen" në gjuhë të ndryshme), nxënësit në mënyrë individuale, me ndihmën e materialit të shumëllojshëm, përgatisin kartë për urime me formë dhe madhësi sipas dëshirës së tyre.
3. Ndërkohë, mësimdhënësi ua shkruan në dërrasë të zezë shprehjet për urimin e ditëlindjes në disa gjuhë të ndryshme nga gjuha që e flasin nxënësit (shih Shtojcën 2 – Shprehje për të uruar ditëlindjen në më shumë gjuhë).
4. Nxënësit shpërndahen në katër grupe, me detyrë që të shkruajnë shprehjen e urimit të ditëlindjes në gjuhë të ndryshme në kartën e tyre të urimit, me ç'rast i shfrytëzojnë shembujt që i shkruan mësimdhënësi në dërrasë të zezë:
 - ▶ **grupi i parë** në gjuhën shqipe;
 - ▶ **grupi i dytë** në gjuhën maqedonase;
 - ▶ **grupi i tretë** në gjuhën turke;
 - ▶ **grupi i katërt** në gjuhën serbe.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Pasi që grupet të kenë mbaruar me aktivitetin, nga një përfaqësues i grupit, prezanton përgatitjen e vet dhe gojarisht e shqipton shprehjen e urimit në gjuhën gjegjëse; me këtë rast tërë klasa në një zë e përsërit shprehjen.
2. Si aktivitet përmbyllës mësimdhënësi inicon bisedë përmes pyetjeve:
 - ▶ Çka bëmë sot?
 - ▶ Si u ndjemë derisa i përgatitëm urimet dhe dëgjuam këngë për ditëlindje?
 - ▶ Cilat shprehje i mësuam, në cilat gjuhë mësuam të urojmë?
 - ▶ Çka ngjason e çka dallon gjatë urimit të ditëlindjes së një shokut (të gjithë kremtojnë ditëlindjen, e urojnë në gjuhë të ndryshme)?

Vërejtje: Aktiviteti mund të përshtatet për urimin e festave dhe kremteve të tjera të kulturave të ndryshme.



Gjuhë MAQEDONASE

<https://www.youtube.com/watch?v=XxaR7YbpmPg>

Gjuhë TURKE

<https://www.youtube.com/watch?v=ITDNECBPMQc>

Gjuhë SERBE

<https://www.youtube.com/watch?v=CfhdDq9zcUI>

Gjuhë SHQIPE

<http://youtu.be/-eciQfNwvB0>

Gjuhë MAQEDONASE

Sreќen rodenден и сè најдобро!
Најубави желби за твојот роденден!
Искрени честитки за sreќen rodenден!
Rodenден e денот што го славиме заедно!
Sreќen rodenден ти посакува твоето другарче!

Gjuhë TURKE

Dođum g¼n¼n kutlu ve her istediđin gercek olsun!
Senin dođum g¼n¼nde en g¼zel dileklerimi iletiyorum!
Dođum g¼n¼n i¼in en i¼ten duygularım senin olsun!
Dođum g¼n¼ birlikte kutladığımız g¼nd¼r!
Senin arkadaşın senin dođum g¼n¼n¼ kutluyor.

Gjuhë SERBE

Sreћan roћendan i sve najbolje!
Најлепше жеље за твој роћендан!
Искрене честитке за sreћan roћendan!
Roћendan je дан када прослављамо заједно!
Sreћan roћendan ти жели твој пријатељ!

Gjuhë SHQIPE

Gëzuar ditëlindjen dhe gjithë të mirat!
Dëshirat më të mira për ditëlindjen tënde!
Urime të përzemërta dhe me fat ditëlindja!
Ditëlindja është dita të cilën bashkë e festojmë!
Ditëlindje të lumtur të dëshiron shoku yt!

LLOJLLOJSHMËRIA E VESHJEVE TONA POPULLORE

4



PLANIFIKIMI DITOR I INTEGRUAR

Klasa	Lënda	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
E TRETË	SHOQËRIA	VENDLINDJA IME	VENDLINDJA IME KA TË KALUAR DHE TRADITË - VESHJE POPULLORE
	MATEMATIKË	GJEOMETRI	2D-FORMA
	ARSIM FIGURATIV	DISENJI DHE KOMUNIKIMI VIZIV	ELEMENTE FIGURATIVE TE DISENJI



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

Shoqëria

- ▶ zgjerojë njohuritë për traditat kulturore të atdheut;
- ▶ njohë traditën dhe trashëgiminë kulturore të bashkësisë së vet dhe të bashkësive të tjera në vendlindje.

Matematika

- ▶ njohë, të përshkruajë dhe të vizatojë 2D-forma, përfshi pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, tetëkëndësh dhe gjysmë-rrethe.

Arsimi figurativ

- ▶ vlerësojë se çka e tërheq vëmendjen e tij/të saj ndaj ndonjë lënde dhe përse;
- ▶ shfrytëzojë ritmin tek disenji.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ forcojë qasjen e hapur drejt njohjes së veçorive të kulturave nga rrethina e drejtpërdrejtë;
- ▶ të zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të tjera;
- ▶ të ndërtojë vlera për integrimin ndëretnik në shoqërinë multikulturore;
- ▶ të zhvillojë shkathtësi komunikimi dhe bashkëpunimi, që janë të nevojshme për interaksion me nxënës të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Hamer.
- ▶ Fotografi (për shembull, Shtojca).
- ▶ Internet-linqe: <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-MK.pdf> dhe <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-SHQ.pdf>
- ▶ „Strajca e magjishme”.
- ▶ 2D-forma (pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, tetëkëndësh dhe gjysmë-rrethe).
- ▶ Fletë pune nga publikimet në linqet e internetit: <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-MK.pdf> dhe <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-SHQ.pdf>.
- ▶ Vegjë (përgatitur nga mësimdhënësi ose të sigurohet sipas marrëveshjes së mëparshme me nxënësit).
- ▶ Lesh.
- ▶ Çorape leshi me ngjyrë të çelët.
- ▶ Materiale leshi me ngjyra të ndryshme.
- ▶ Gërshërë.
- ▶ Fllomasterë për lesh dhe tekstil.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT në orën mësimore nga Shoqëria

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon ashtu që nxënësit i shikojnë këndet e krijuara në klasën e tyre dhe bisedojnë për përmbajtjen dhe pamjen në lidhje me këto çështje:
 - ▶ Çfarë kreacioni i është dhënë klasës sonë?
 - ▶ A i kemi organizuar këndet dhe cilat janë ato?
 - ▶ Çka paraqet këndi etnologjik?
 - ▶ Për çfarë qëllimi e krijojmë këtë kënd?
 - ▶ Cilat sende duhet të zënë vend në të?
 - ▶ Këndin tonë etnologjik a mund ta pasurojmë me elemente nga veshjet popullore që janë pjesë e kulturës dhe e traditës së bashkësive të ndryshme etnike që jetojnë në shtetin tonë?

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimdhënësi paralajmëron se për këtë qëllim duhet që nxënësit të njihen me elementet e ndryshme të veshjeve të bashkësive etnike nga rrethina jonë e drejtpërdrejtë.
2. Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Secili grup ka për detyrë që t'i hulumtojë këto elemente: këmishën, jelekun, veshjen e sipërme, veshjen e prehrit, çorapet, kollanin, të mbathmet, stolitë, materialet, kësulën fes dhe ngjyrat që janë karakteristike dhe specifike për veshjet popullore të bashkësisë etnike. Anëtarët e grupit të dhënat e fituara i shkruajnë në hamer.
 - ▶ **Grupi i parë** hulumton për veshjen popullore serbe.
 - ▶ **Grupi i dytë** hulumton për veshjen popullore turke.
 - ▶ **Grupi i tretë** hulumton për veshjen popullore shqiptare.
 - ▶ **Grupi i katërt** hulumton për veshjen popullore maqedonase.
 - ▶ **Grupi i pestë** hulumton për veshjen popullore rome.
 - ▶ **Grupi i gjashtë** hulumton për veshjen popullore vllehe.

**PËRSHKRIMI
I AKTIVITETIT
në orën
mësimore nga
Shoqëria**

Për të bërë kërkimin e këtyre të dhënave nxënësit mund të shfrytëzojnë literaturë profesionale, doracakë, fotografi (shih Shtojcën) ose linqe me arritje interneti, si për shembull: <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-MK.pdf> dhe <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-SHQ.pdf>

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nga një përfaqësues prej secilit grup i prezanton të dhënat e fituara.
2. Përmes pyetjeve, në vazhdim fillon diskutimi:
 - ▶ A ka ngjashmëri dhe dallime te veshjet e bashkësive të ndryshme etnike dhe cilat janë ato?
 - ▶ Kur janë bartur këto veshje?
 - ▶ Çka kanë paraqitur ato?
 - ▶ Çka mendoni, përse njerëzit nga bashkësi të ndryshme etnike i kanë veshur këto veshje në të kaluarën?
 - ▶ A barten edhe sot këto veshje?
 - ▶ Çfarë rëndësie kanë veshjet sot?
 - ▶ A mund të krijojmë në këndin tonë etnologjik së paku një pjesë nga këto veshje?



**PËRSHKRIMI
I AKTIVITETIT
në orën
mësimore nga
Matematika**

AKTIVITET HYRËS:

1. Pas përgatitjes paraprake, mësimdhënësi bën kreacionin e së ashtuquajturës strajcë e magjishme, në të cilën ka 2D-forma (pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, tetëkëndësh dhe gjysmë-rrethe).
2. Secili nxënës ka mundësi që, me sy të mbyllur, të bëjë tërheqjen e nga një 2D-forme.
3. Pasi që të gjithë nxënësit të kenë tërhequr 2D-formën e tyre, lëvizin nëpër klasë dhe kërkojnë çifte me 2D-forma identike dhe në këtë mënyrë formojnë grupin.
4. Secili grup e cakton 2D-formën e vet dhe e gjen vendin e vet (shënuar me 2D-formën gjegjëse) në klasë dhe në këtë mënyrë formohen katër grupe.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimdhënësi e paralajmëron aktivitetin në të cilin nxënësit do të kenë për detyrë që t'i gjejnë dhe t'i numërojnë të gjitha 2D-format (pesëkëndëshat, gjashtëkëndëshat, tetëkëndëshat dhe gjysmë-rrethet) që janë në secilin prej elementeve të veshjeve popullore në materialin konkret të punës.
2. Në këtë rast e kanë për detyrë që të bëjnë përshkrimin:
 - ▶ se për çfarë elementi të veshjes popullore bëhet fjalë;
 - ▶ cilat janë karakteristikat e tij;
 - ▶ cilës bashkësi etnike i takon;
 - ▶ cili detal i elementit të veshjes popullore më së shumti i ka pëlqyer grupit.

Mësimdhënësi secilit grup i jep nga një kopje nga materiali i punës nga faqja gjegjëse e publikimit, e cila në versionin elektronik gjendet në linkun vijues: <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-MK.pdf> dhe <http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-SHQ.pdf>

- ▶ **Grupi i parë** punon shembullin e këmishës, të jelekut dhe të prehrit (shih faqet 30, 31 dhe 33).
- ▶ **Grupi i dytë** i analizon shembujt e pjesës së sipërme, heqlat zorrnike të nuses dhe anterinë (shih në faqen 32, 38 dhe 9).

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT në orën mësimore nga Matematika

- ▶ **Grupi i tretë** i analizon shembujt e çorapeve, çullet itas (shih në faqet 34, 14 dhe 19).
- ▶ **Grupi i katërt** i analizon shembujt e kollanit dhe të lahores – mbi brez, të kësulës fes (shih në faqet 38, 12 dhe 36).

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nga një përfaqësues i grupit prezanton të dhënat e fituara dhe tregon se sa lloje dhe sa forma 2D ka në elementin e veshjeve popullore që ata hulumtojnë.
2. Krahas kësaj, mësimdhënësi çel bisedë edhe për pyetjet në vazhdim:
 - ▶ 2D-format a janë vetëm figura gjeometrike që i mësojmë në matematikë, apo janë inspirim për ndonjë disenj?
 - ▶ Kombinatorika e tyre sa kreacione bën?
 - ▶ Cilat janë karakteristikat e tyre?
 - ▶ Cilës bashkësi etnike i takojnë?
 - ▶ Cili detal nga elementi i veshjes popullore ju pëlqeu më shumë në grup?



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT nga ora mësimore nga Arsimi figurativ

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit rikujtojnë elementet dhe karakteristikat themelore të veshjeve popullore të bashkësive etnike nga rrethina e drejtpërdrejtë.
2. Bisedojnë për llojet e formave gjeometrike 2D dhe për praninë e tyre në larat e veshjeve popullore të bashkësive të ndryshme etnike.
3. Pastaj mësimdhënësi paralajmëron se do të përpiqen që me teknika dhe me materiale të ndryshme të bëjnë disenjin e elementit nga veshja popullore.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit punojnë të ndarë në tri grupe, me detyrat në vijim:
 - ▶ **Grupi i parë** ka për detyrë që me ndihmën e vegjës të thur yrnekun e *pështjellakut me ngjyra prej leshi sipas dëshirës së nxënësve*.
 - ▶ **Grupi i dytë** ka për detyrë që *çorapet e leshit* me ngjyrë të bardhë t'i ngjyros me fllomaster me lara popullore, duke aplikuar format 2D.
 - ▶ **Grupi i tretë** ka për detyrë që të bëjë kreacionin e *anterisë* së kukullës së thjeshtë gjinjal, të bërë nga materiali i leshtë.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Secili grup i prezanton punimet e veta.
2. Pastaj punimet i ekspozojnë tek etno-këndi.
3. Bisedojnë me mësimdhënësin për çështje që lidhen me punën e tyre të dorës, me përjetimet dhe përvojat:
 - ▶ Sa ishim të suksesshëm me punimet tona?
 - ▶ A patëm sukses që ta pasurojmë etno-këndin tonë me punime të reja?
 - ▶ Cilat janë arritjet e punës sonë të dorës për të kuptuar veshjet popullore dhe elementet e tyre të bashkësitë e ndryshme etnike?
 - ▶ A ju pëlqen ky lloj aktivitetesh, gjatë të cilave kujtojmë traditën, mësojmë njëri për tjetrin dhe përmes kreacioneve të punimeve me interes, kuptojmë për të kaluarën dhe veshjet popullore të të gjithëve që jetojnë në atdheun tonë?




VESHJE POPULLORE SERBE



VESHJE POPULLORE TURKE



VESHJE POPULLORE SHQIPTARE



VESHJE POPULLORE MAQEDONASE



VESHJE POPULLORE ROME



VESHJE POPULLORE VLEHE



VESHJE POPULLORE BOSHNJAKE

„UNË DHE SHOKU IM I RI – NE JEMI TË NGJASHËM DHE TË NDRYSHËM”

5



Klasa

E KATËRT

Lënda

GJUHË AMTARE

Tema nga programi mësimor

SHPREHJE ME SHKRIM

Njësia mësimore

RRËFIM ME FILLIM TË DHËNË



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë shprehjen me shkrim duke rrëfyer pas fillimit të dhënë;
- ▶ rrëfejë ndonjë ngjarje të përjetuar.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja:

- ▶ të shohë rëndësinë e komunikimit dhe të shoqërimit/bashkëpunimit me pjesëtarët e bashkësive të tjera etnike;
- ▶ të njohë se sa janë të ngjashëm ose të ndryshëm me moshatarët e tyre nga bashkësitë tjera etnike;
- ▶ të zhvillojë identitetin e vet personal dhe të hulumtojë për identitetin e të tjerëve.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.



KOHA

Deri në dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me lojë, në të cilën nxënësit grupohen sipas përgjigjeve që fillojnë me pohimin „Dua të kem shok, i cili...”
2. Nxënësve u lexohen pohimet dhe varësisht prej përgjigjeve, për secilin nga pohimet e ofruara duhet të ndalen në vendin e caktuar në klasë. Po qe se përgjigjja është JO, ata ndalen në anën e majtë të klasës; po qe se përgjigjja është PO, ata shkojnë në anën e djathtë. Po qe se nuk janë të sigurt, ata mbeten në mes të klasës.
3. Mund të shfrytëzohen disa prej pohimeve të ofruara, për të cilat nxënësit duhet të pajtohen ose jo, si për shembull:
 - ▶ Dua të kem një shok që është më i vjetër prej meje.
 - ▶ Dua të kem një shok që shikon (mësimdhënësi tregon filmin vizatimor ose filmin që është i popullarizuar te fëmijët).
 - ▶ Dua të kem një shok që i përqesh të tjerët.
 - ▶ Dua të kem një shok të cilit mund t'i besoj.
 - ▶ Dua të kem një shok nga Maqedonia që flet në gjuhë të ndryshme prej gjuhës që flas unë.
4. Pas secilës përgjigje, mësimdhënësi nxit një diskutim të shkurtër, duke i pyetur nxënësit se përse janë përcaktuar ashtu.
5. Për pohimin se a duan të kenë një shok që flet në gjuhë të ndryshme nga ajo çka e flasin, nxënësit pyeten se a kanë një shok të tillë dhe a do të kishin dashur që të njihen me një shok që flet në gjuhë të ndryshme nga ajo që flasin.
6. Prej nxënësve që kanë shok që flet në gjuhë të ndryshme nga ajo çka flasin kërkohet që ta ndajnë përvojën pozitive nga shoqërimi i përbashkët dhe të përshkruajnë se si janë njohur dhe a janë ende shokë.
(Po qe se gjatë këtij aktiviteti ka nxënës që do të ndajnë përvojë negative me shokun nga bashkësia tjetër etnike, mësimdhënësi duhet që me shkathtësi ta vë këtë përvojë në kontekst të zgjidhjeve të mundshme pozitive dhe të vazhdimet të shoqërisë.)
Mësimdhënësi e inkurajon nxënësin që ta paraqet dhe ta njohë shokun me nxënësit tjerë.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit paralajmërohen se do të shkruajnë hartim me fillim të dhënë në temën: “Unë dhe shoku im i ri – ne jemi të ngjashëm dhe të ndryshëm”.
2. Pastaj mësimdhënësi u shpjegon se secili nxënës duhet të paramendojë se ka qenë në një udhëtim nëpër Maqedoni dhe se është njohur dhe është miqësuar me bashkënxënësin e vet që flet në gjuhë të ndryshme nga ajo në të cilën flet nxënësi.
3. Nxënësve u jepet teksti hyrës nga Fleta e punës. Më tej, u jepen pyetjet e dhëna në fletën e punës, që duhet të shërbejnë si kahe për shkrimin e hartimit. Për secilën pikë jepet një shpjegim i shkurtër për atë se çka duhet të shkruhet.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Caktohen çifte dhe prej tyre kërkohet që ndërmjet vete t'i lexojnë hartimet dhe të ndajnë mendimet dhe ndjenjat e tyre derisa e kanë shkruar hartimin.
2. Nxiten nxënësit që duan t'i lexojnë hartimet e veta para tërë paraleles.
3. Mësimdhënësi iniciacion bisedë refleksioni për aktivitetet përmes pyetjeve, si për shembull:
 - ▶ Si ndiheshe derisa e shkruaje hartimin me fillim të dhënë?
 - ▶ A ballafaqoheshe me vështirësi kur shkruaje për udhëtimin tënd të menduar dhe për shokun e ri?
 - ▶ Cilat janë ngjashmëritë, e cilat janë dallimet mes teje dhe shokut tënd të ri?
 - ▶ A njih fjalë të gjuhëve të tjera që fliten në Maqedoni dhe cilat janë ato fjalë?
 - ▶ Përshkruaje se si do të kishe dashur të zhvillohet komunikimi dhe shoqërimi kur do të kishe mundur që të kesh mundësi që me të vërtetë të kesh shok që flet në gjuhë të ndryshme prej asaj në të cilën ti flet?
 - ▶ Çka do të kishe dashur të mësoje për lojërat dhe zakonet e moshatarëve tu që flasin në gjuhë të ndryshme prej asaj të cilën e flet ti?
4. Hartimet nga të gjithë nxënësit ekspozohen në vend të dukshëm në klasë.



Mësimdhënësi i plotëson fushat e zbrazëta në fillim të tregimit varësisht nga gjuha në të cilën zhvillohet mësimi në paralele – shoku i paramenduar duhet të flasë në gjuhën që është e ndryshme nga gjuha në të cilën zhvillohet mësimi në paralele. Mësimdhënësi është i lirë të formojë grupin e nxënësve në varësi të gjuhës në të cilën flet shoku i menduar

Shoku im i ri ka 10 vjet, jeton në dhe mëson në shkollën fillore
..... në gjuhën Ai/ajo është nxënës/e i/e cili/a shumë do që të shkojë në shkollë, të shoqërohet me shokët e vet nga shkolla dhe të njohë të rinj. Ai/ajo jeton në shtëpi, bashkë me nënën, me babain, gjyshen, gjyshin dhe dy motra. Shoku i ri ka kafshë shtëpiake – qenin Aron. Motrat e tij dhe ai/ajo shpesh luajnë me Aronin në afërsi të shtëpisë së tyre.

Nxënësve u jepen udhëzimet në vazhdim, të cilat do t’u ndihmojnë në shkrimin e tregimit:

1. Shkruaj se si quhet shoku i ri.
2. Përshkruaje se si duket vendi dhe shtëpia në të cilën jeton shoku i ri.
3. Përshkruaje se si duket dhe si sillet shoku i ri në raport me ty.
4. Përshkruaji gjërat tua më të dashura (ushqimin, pijet ose ndonjë hobi, siç janë: muzika, filmi, lojërat, sporti ose tjetër) dhe gjërat e dashura të shokut të ri.
5. Përshkruaje se me çfarë jeni të ngjashëm e me çfarë dalloni me shokun e ri.
6. Përshkruaje se si u kuptuat dhe si komunikuat në gjuhë të ndryshme me shokun e ri.



TEATRI – ARTI I JETESËS SONË



Klasa

E PESTË

Lënda

GJUHË
MAQEDONASE

Tema nga programi
mësimor

KULTURA
MEDIALE

Njësia mësimore

SHFAQJE
TEATRORE



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me nocionet skenografi dhe kostumografi në shfaqjen teatrore (a përputhen me tematikën, me zhvillimet, me personazhet e të ngjashme);
- ▶ të njohë renditjen e ngjarjeve në film dhe në shfaqjen teatrore.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me zakonet popullore, me traditat dhe me folklorin e bashkësive etnike në rrethinën e vet të drejtpërdrejtë;
- ▶ njihet me vlerat e kulturës së vet dhe me veçoritë e kulturave nga rrethina jonë e drejtpërdrejtë;
- ▶ njohë ngjashmëritë dhe dallimet midis njerëzve nga kultura të ndryshme dhe në këtë mënyrë të ballafaqojë dhe të zvogëlojë stereotipet dhe paragjykimet ekzistuese në raportet e ndërsjella.



RESURSE

- ▶ Etno-kënde.
- ▶ Projektor.
- ▶ Pëlthurë për projektim.
- ▶ Projektion filmik i shfaqjes teatrore „Çorbaxhi Teodosi“.
- ▶ Fletë pune 1, 2 dhe 3.



KOHA

Dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Mbi bazë të përgatitjes së mëparshme mbi aktivitetin, mësimdhënësi dhe nxënësit bëjnë kreacion të etno-këndit, ku ka sende që janë pjesë e traditës dhe e kulturës rome dhe maqedonase.
2. Aktiviteti fillon ashtu që bëhet shikimi i sendeve, i veshjeve, i fotografive, i posterave ose elementeve të tjera në etno-kënd, karakteristike për kulturën e romëve dhe të maqedonasve.
3. Pastaj mësimdhënësi i pyet nxënësit se cilin prej këtyre sendeve e ka në shtëpinë e vet, ose se a i kanë parë në ndonjë vend tjetër dhe ku.
4. I inkurajon nxënësit të bëjnë përshkrimin e sendeve që i kanë parë drejtpërdrejt dhe të japin mendimin e tyre se cilës kulturë i takojnë.
5. Me nxënësit bisedohet për radhën e ngjarjeve dhe të zhvillimeve në film dhe në shfaqen teatrore.
6. Përmes shumë idesh definohej nocionet skenografi dhe kostumografi në shfaqen teatrore.
7. Pastaj mësimdhënësi paralajmëron se një numër specifikash të zakonit popullore, traditat dhe folklori i bashkësive etnike mund të vërehen edhe përmes analizës së kostumografisë dhe të skenografisë të shfaqes teatrore, marrë si shembull, „Çorbaxhi Teodosi“.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

Nxënësve u paraqitet sekuenca gjegjëse (zgjedhur nga mësimdhënësi) nga projekcioni i filmit i shfaqes teatrore: „Çorbaxhi Teodosi“ (shih në linkun vijues: <https://www.youtube.com/watch?v=YYdwS9wW3AA>)

Mësimdhënësi e drejton vëmendjen e nxënësve gjatë projekcionit të shfaqes teatrore drejt tri aspekteve:

- ▶ analiza e skenografisë dhe e të gjitha elementeve të saj përbërëse në shtëpi nga aspekti i dy kulturave të përfshira në shfaqje, rome dhe maqedonase;
 - ▶ gjithashtu, analizohet edhe kostumografia përmes veshjeve nga aspekti i dy kulturave të përfshira në shfaqje, rome dhe maqedonase, me të gjitha elementet e saj plotësuese;
 - ▶ zakonet, si pjesë e kulturës maqedonase dhe rome, gjithashtu duhet të jenë lëndë interesimi dhe analize nga ana e nxënësve.
1. Pastaj nxënësit ndahen në tri grupe, me detyrë që në hamer t'i përshkruajnë elementet më të përfshira dhe më karakteristike në lidhje me:
 - ▶ **grupi i parë:** skenografinë (shih Fletën e punës 1);
 - ▶ **grupi i dytë:** kostumografinë (shih Fletën e punës 2);
 - ▶ **grupi i tretë:** zakonet (shih Fletën e punës 3).
 2. Mësimdhënësi i drejton nxënësit drejt potencimit të përparimit dhe të tolerancës në raporte të ndërsjella. Jep propozim në grupin e tretë nxënësit ta kenë parasysh distancën kohore prej një shekulli dhe të bëjnë krahasimin në zhvillimin dhe ndryshimin e zakoneve midis këtyre bashkësive etnike. Të japin mendimin e tyre se a janë ato të njëjta apo mos ka përparim në raportet e tyre të ndërsjella.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Caktohet nga një prezantues në secilin grup dhe pastaj ata bëjnë elaborimin e aktiviteteve projektuese të tyre para tërë grupit dhe në këtë mënyrë grupet ndërmjet vete i shkëmbejnë arritjet dhe përshtypjet e tyre.
2. Mësimdhënësi inicon bisedë për refleksionin e aktiviteteve përmes pyetjeve, si për shembull:
 - ▶ Si e përjetuat projeksionin e filmit të shfaqes teatrore „Çorbaxhi Teodosi“?
 - ▶ Çka ju la më shumë përshtypje në lidhje me kostumografinë, me skenografinë, zakonet dhe tekstin?
 - ▶ Ku shihet më së miri dallimi i këtyre pjesëve midis dy kulturave?

FLETË PUNE

GRUPI 1 – Skenografia

1

1. Aktivitetin projektues e bëni në kuadër të grupit tuaj, me detyrë që në hamer t'i caktoni, t'i renditni dhe t'i përshkruani elementet më të shpeshta dhe më karakteristike në lidhje me skenografinë: Skenografia definohet si disiplinë e artit për krijimin e ambienteve të caktuara për shfaqen. Paraqet mendimin e përbashkët, të harmonizuar edhe të regjisorit edhe të artistit viziv në lidhje me një shfaqe skenike ose film të caktuar.
2. Analizojeni skenografinë dhe të gjitha elementet e saj përbërëse karakteristike për kulturën maqedonase dhe rreth nga aspekti i:
 - ▶ veshjes;
 - ▶ rregullimit hapësinor;
 - ▶ etno-elementeve;
 - ▶ muzikës, tingullit karakteristik;
 - ▶ interpretimit;
 - ▶ konstruksioneve.

1. Aktivitetin projektues e bëni në kuadër të grupit tuaj, me detyrë që në hamer t'i caktoni, t'i renditni dhe t'i përshkruani elementet më të shpeshta dhe më karakteristike në lidhje me kostumografinë. Kostumografia është disiplinë vizatimi dhe kreacioni e kostumeve për nevojat e filmit, shfaqeve teatrore dhe të arteve të tjera skenike.
2. Analizojeni kostumografinë përmes veshjeve karakteristike për kulturën maqedonase dhe rome nga aspekti i:
 - ▶ stilit të veshjes;
 - ▶ mënyrës së veshjes;
 - ▶ elementeve specifike kulturore;
 - ▶ elementeve specifike etnike;
 - ▶ specifikave të veshjes në kontekstin historik dhe social.

1. Aktivitetin projektues e bëni në kuadër të grupit tuaj, me detyrë që në hamer t'i caktoni, t'i renditni dhe t'i përshkruani elementet më të shpeshta dhe më karakteristike në lidhje me zakonet. Zakonet paraqiten si rezultat i përsëritjes për një kohë të gjatë në shoqëri dhe përbëjnë mënyrën e ngulitur të sjelljes, që është karakteristike për pjesëtarët e një bashkësie etnike ose kulture. Fuqia dhe përhershmëria e tyre mbështeten tek tradita. Secila kulturë e ka sistemin e vet të zakoneve.
2. Analizoni zakonet maqedonase dhe rome, me këtë rast merreni parasysh distancën kohore prej një shekulli dhe bëni krahasimin në zhvillimin dhe ndryshimin e zakoneve ndërmjet këtyre bashkësive etnike. Cili është mendimi juaj, a janë ato të njëjta apo ka përparim në raportet e tyre të ndërsjella? Analizën e bëni në raport me:
 - ▶ shprehitë kulturore;
 - ▶ normat morale;
 - ▶ zakonet gjatë kurorëzimit;
 - ▶ zakonet gjatë pagëzimit.

FESTAT TONA



PLANIFIKIMI DITOR I INTEGRUAR

Klasa	Lënda	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
E PESTË	SHOQËRI	ATDHEU YNË, REPUBLIKA E MAQEDONISË	ATDHEU YNË, REPUBLIKA E MAQEDONISË
	ARSIM MUZIKOR	DËGJIM I MUZIKËS	VEPRA MUZIKORE VOKALE, INSTRUMENTALE DHE VOKALE-INSTRUMENTALE ME LLOJET THEMELORE TË DINAMIKËS DHE TË NDRYSHIMIT TË DINAMIKËS
	ARSIM FIGURATIV	DISENJI DHE KOMUNIKIMET VIZIVE	ELEMENTET FIGURATIVE TE DISENJI



QËLLIMET E PROGRAMIT MËSIMOR NGA:

Nxënësi/nxënësja të:

Shoqëria

- ▶ njihet me karakteristikat e Republikës së Maqedonisë si shtet në lidhje me himin, flamurin dhe festat shtetërore;
- ▶ njohë ndryshimet fetare të popullsisë në Republikën e Maqedonisë.

Arsimi muzikor

- ▶ zhvillojë aftësinë për të dalluar dhe emëruar llojet themelore të dinamikës dhe ndryshimet shkallë-shkallë të dinamikës në veprat muzikore.

Arsimi figurativ

- ▶ dallojë llojet e kompozicionit
- ▶ zhvillojë shkathtësinë për të punuar pllakatin.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ forcojë qasjen e hapur drejt njohjes së veçorive të kulturave nga rrethina e drejtpërdrejtë;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të tjera;
- ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në një shoqëri multikulturore;
- ▶ zhvillojë shkathtësitë për komunikim dhe bashkëpunim, që janë të nevojshme për interaksion me nxënës të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Fotografi nga festat shtetërore dhe fetare në R. e Maqedonisë.
- ▶ Kalendarin e festave në R. Maqedonisë, me versionin elektronik në linkun vijues: http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/Programa_nerabotni_2016.pdf
- ▶ Himnet e Maqedonisë, të Shqipërisë, Serbisë, Turqisë dhe të Bosnjë dhe Hercegovinës (Shtojca).
- ▶ Gazeta me motive nga kremtimi i festave religjioze.
- ▶ Kolazh, Gërshërë, Ngjitëse, Hamer, Zarf x 4, Flip-letër.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT në orën mësimore nga shoqëria

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secilit grup mësimdhënësi i jep nga një zarf me fotografi që simbolizojnë një festë të caktuar shtetërore ose fetare (fotografi të: vezëve të Pashkëve, bredhit të Vitit të Ri, bakllavasë së Bajramit, qytetit të stolisur me flamuj me rastin e 8 Shtatorit, degëve të gjelbra për Shëngjergj, për ditën e pranverës etj.).
2. Nxënësve u jepen instruksione që t'i shikojnë fotografitë, t'i njohin dhe t'i veçojnë ato që kanë të bëjnë me festat që i dinë (fetare ose shtetërore).
3. Nga një anëtar i secilit grup prezanton nga një fotografi dhe me këtë rast jep shpjegime në pyetjet vijuese:
 - ▶ Si quhet festa?
 - ▶ Kur, në cilën periudhë kohore festohet?
 - ▶ Si dhe në çfarë mënyre, me çfarë karakteristikash festohet festa?

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit janë të ndarë në dy grupe të mëdha dhe punojnë në detyra të caktuara për *Kalendarin e festave në R. e Maqedonisë*, versionin elektronik i të cilit mund të gjendet në linkun vijues:
http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/Programa_nerabotni_2016.pdf
 - ▶ **Grupi i parë** ka për detyrë që nga Kalendarin e festave në R. të Maqedonisë t'i veçojë festat shtetërore të cilat i festojnë qytetarët e RM.
 - ▶ **Grupi i dytë** i kërkon dhe i veçon festat kombëtare dhe fetare të të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në RM.
2. Në kuadër të dy grupeve, nxënësit punojnë në çifte dhe bëjnë përmbledhjen e të dhënave. Pasi të ketë mbaruar aktiviteti, nga një përfaqësues i grupit i shpërndan informatat e fituara në grupin tjetër.
3. Të dhënat e fituara nga të dy grupet mësimdhënësi i shënon në flip-letër.

**PËRSHKRIMI
I AKTIVITETIT
në orën
mësimore nga
shoqëria**



**PËRSHKRIMI
I AKTIVITETIT
në orën
mësimore nga
Arsimi muzikor**

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Prezantohen të dhënat nga të dy grupet para të gjithë nxënësve dhe hapet diskutimi në lidhje me këto pyetje:

- ▶ Sa ditë jopune kanë të gjithë qytetarët e RM gjatë këtij viti?
- ▶ Përse i festojmë këto festa?
- ▶ A e dini që i festojmë festat edhe të bashkësive të tjera etnike?
- ▶ Çka mësuam të re sot?

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me diskutimin për njohuritë e mëparshme për tempin muzikor.
2. Pastaj mësimdhënësi jep informata të shkurtra për nocionin dinamikë në muzikë, për llojet dhe ndryshimet shkallë-shkallë në dinamikën e veprave muzikore.
3. Në vazhdim paralajmërohet se në pjesën vijuese të orës do të dëgjoen himnet dhe do të caktohen tempi dhe dinamika.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimdhënësi e nis bisedën me nxënësit përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ A ka secili shtet himnin e vet?
 - ▶ A e dimë himnin e RM?
 - ▶ Në çfarë ngjarjesh këndohet himni?
 - ▶ Rëndom, çfarë këndohet në himnin e ndonjë shteti?
 - ▶ Përse gjatë emetimit të himnit të ndonjë shteti të gjithë rrinë drejt në këmbë dhe sillen me respekt?
 - ▶ A e dini se si tingëllon himni i RM?
 - ▶ A e keni dëgjuar himnin e ndonjë shteti tjetër?
2. Mësimdhënësi ua bën të ditur nxënësve se në pjesën e mëtejshme të orës do të dëgjojnë himne të shteteve nga rrethina e drejtpërdrejtë e RM. U shpjegon se këto shtete nuk janë zgjedhur rastësisht, por gjatë zgjedhjes e ka pasur parasysh përbërjen etnike të popullsisë në Republikën e Maqedonisë dhe lidhjen e bashkësive të caktuara etnike me ndonjërin prej këtyre shteteve. Me këtë u potencohet se përveç përkatësisë ndaj shtetit tonë të përbashkët, bashkësitë etnike janë të lidhura edhe me shtetet ku jeton popullsia shumicë me të cilën kanë prejardhje të përbashkët.
3. Nxënësit i dëgjojnë himnet e Maqedonisë, të Shqipërisë, Serbisë, Turqisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës (shih Shtojcën) dhe bashkë me mësimdhënësin përpiqen që të t'i definojnë dallimet dhe ngjashmëritë e tempit dhe të dinamikës së këtyre himneve. Këtë e bëjnë ashtu që pasi që kanë ndjekur secilin prej himneve, shkruajnë në fletoret e tyre dhe bëjnë krahasimin me tempin dhe dinamikën e himnit të mëparshëm.
4. Mësimdhënësi e ka për detyrë që t'i kthejë e t'ua kujtojë që mos ndodh që nxënësit ta humbin koncentrimin në interpretimet e fundit të himneve.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Me të gjithë nxënësit nis diskutimi përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Çfarë tempi dhe dinamike kishin veprat që i përcollëm?
 - ▶ A vërejtët ndonjë ngjashmëri?
 - ▶ Çfarë është karakteristike për të gjitha himnet?
 - ▶ Si duhet të sillemi kur dëgjojmë himnin e shtetit tonë dhe të ndonjë shteti tjetër?



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT në orën mësimore nga Arsimi figurativ

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit përkujtohen për llojet e festave që festohen në R. të Maqedonisë.
2. Pastaj, bashkë me mësimdhënësin i definojnë festat religjioze, si Pashkët, Kurban-Bajramin, Shëngjergjin.
3. Mësimdhënësi paralajmëron se në aktivitetin e radhës nxënësit do të punojnë motive me elemente të festimit të këtyre festave.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit punojnë në gjashtë grupe, me ç'rast secili grup merr kompletin e materialeve për punë (gazeta me motive nga kremtimi i festave religjioze, kolazh, gërshërë, ngjitëse, hamer).
2. Secili grup duhet ta tregojë kreativitetin e vet në punën e përbashkët, në të cilën kanë për detyrë që në hamer të krijojnë kompozicionin e motiveve me elemente të festimit të të tri festave në një vend, edhe atë:
 - ▶ **grupi i parë dhe i dytë** do të punojnë në temën ushqim;
 - ▶ **grupi i tretë dhe i katërt** do të punojnë në temën veshje;
 - ▶ **grupi i pestë dhe i gjashtë** do të punojnë në temën ceremoni dhe rituale.
3. Gjatë kohës së punës në grupe në prapavijë dëgjohen himnet e Maqedonisë, të Shqipërisë, Serbisë, Turqisë dhe të Bosnjë dhe Hercegovinës.

AKTIVITETE/REFLEKSIONE EVALUATIVE

1. Nga një përfaqësues i grupit e prezanton punimin e përbashkët dhe të gjitha gjashtë punimet i ekspozojnë në vend të dukshëm në hollin e shkollës.
2. Pas mbarimit të orëve, nxënësit e këtyre klasave do të përpiqen që përmbajtjen e punimeve të tyre ta prezantojnë dhe ta bëjnë më të afërt para bashkënxënësve të tyre nga shkolla e njëjtë.

SHTOJCA

Linqe deri te himnet e Maqedonisë, Shqipërisë, Serbisë, Turqisë dhe të Bosnjë dhe Hercegovinës

Himi i R. së MAQEDONISË

https://en.wikipedia.org/wiki/Denes_nad_Makedonija

Himni i SHQIPËRISË

https://bs.wikipedia.org/wiki/Himni_i_Flamurit

Himni i SERBISË

https://en.wikipedia.org/wiki/Bo%C5%BEE_pravde

Himni i TURQISË

https://en.wikipedia.org/wiki/%C4%B0stikl%C3%A2l_Mar%C5%9F%C4%B1

Himni i BOSNJË DHE HERCEGOVINËS

https://en.wikipedia.org/wiki/National_Anthem_of_Bosnia_and_Herzegovina

QILIMAT NË KRIJIMTARINË POPULLORE



Klasa

E GJASHTË

Lënda

ARSIM
FIGURATIV

Tema nga programi
mësimor

VIZATIM

Njësia mësimore

ELEMENTET FIGURATIVE,
MJETET PËR VIZATIM
DHE PËRDORIMI I TYRE



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me nocionet e simetrisë dhe të asimetrisë përmes motiveve dekorative të qilimave;
- ▶ aftësohet për realizim kreativ të simetrisë dhe të asimetrisë me aplikimin e shkallëzimit tonal;
- ▶ realizojë shkallëzimin tonal me ngjyra kromatike dhe akromatike, të përputhshme me ngjyrat që paraqiten në qilimat e krijuar nga përfaqësuesit e bashkësive që jetojnë në R. të Maqedonisë.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ forcojë ndjesinë për vlerën e kulturës së vet dhe të zhvillojë Identitetin kulturor pozitiv;
- ▶ forcojë ndjesinë e transparencës ndaj njohjes së veçorive të kulturave që gjenden në hapësira të ndryshme dhe që kanë veçori të ndryshme;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të tjera që nuk gjenden në R. të Maqedonisë, duke i theksuar arritjet prej tyre.



RESURSE

- ▶ Fotografi ku janë të paraqitur qilimat (Shtojca).
- ▶ Ngjyra temperale.
- ▶ Ngjyra të ujit.
- ▶ Laps dhe letër për vizatim.



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Ora fillon me diskutimin në lidhje me punimin e krijimeve artistike me dorë, që në të kaluarën ka qenë pjesë e veprimtarisë së grave, përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ A e dini se si janë punuar krijimet artistike me dorë në të kaluarën?
 - ▶ Kush ka qenë i angazhuar për t'i punuar ato në familje?
 - ▶ A mund të numëroni disa prej tyre?
2. Po qe se nxënësit nuk kujtohen për qilimat, atëherë mësimdhënësi thekson se krahas funksionit praktik të qilimave, ato janë shprehje edhe të frymës artistike të grave që i kanë thurur. Ato kanë futur në to elemente dekorative gjegjëse, motivet dhe ngjyrat e të cilave thellë kanë qenë të lidhura me mënyrën e jetesës së bashkësisë së cilës i kanë takuar. Përmes këtij shpjegimi mësimdhënësi e paralajmëron aktivitetin që vijon.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësve u prezantohen fotografi (shih Shtojcën) ku janë të paraqitur qilimat, tradicionalisht të punuar nga përfaqësues të bashkësisë shqiptare, vllehe, turke dhe maqedonase.
2. Gjatë prezantimit, mësimdhënësi shtron pyetje:
 - ▶ Cilat janë motivet dominante në qilima?
 - ▶ A janë këto forma, figura natyrale, apo janë pjesë e imagjinatës së autorit?
 - ▶ Cilat janë motivet që janë karakteristike, përkatësisht që janë më dominante për secilën bashkësi veç e veç?
3. Pastaj i drejton nxënësit që ta shikojnë organikën e elementeve dekorative në lidhje me atë se a kanë shtrirje qendrore, a dominon një element dhe në çfarë raportesh janë elementet tjera në lidhje me elementin që dominon. Nxënësit duhet të njohin boshtin e simetrisë ose pikën që krijon balancën në lidhje me elementet.
4. Pastaj ua shtron pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Cilat prej ngjyrave janë përdorur te secila bashkësi etnike e theksuar?
 - ▶ Cilat janë motivet dominante te qilimat te secila bashkësi e përmendur?
 - ▶ A mund të bëjmë krahasimin se cilat ngjyra përsëriten te qilimat te të gjitha bashkësitë? A është ngjyra e njëjtë apo nuancat janë të ndryshme të së njëjtës ngjyrë?
5. Nxënësit kanë për detyrë që individualisht të bëjnë vizatimin, me kreacionin e vet të qilimit, që do të jetë kombinim i motiveve dhe i ngjyrave dominante nga shembujt e treguar të qilimave nga të gjitha bashkësitë në Republikën e Maqedonisë. Kjo detyrë synon që nxënësit t'i nxjerrin karakteristikat e përbashkëta të krijimtarisë popullore të bashkësive etnike që jetojnë në R. të Maqedonisë.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Kur do të kryejnë me vizatimin, një pjesë e nxënësve, të cilët do të paraqiten vullnetarisht, i prezantojnë vizatimet e tyre dhe me këtë rast japin përgjigje në pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Cilat elemente janë zgjedhur për vetë vizatimin?
 - ▶ Cilat janë ngjyrat dominante në vizatim?
 - ▶ Te cilat bashkësi takohen elementet dhe ngjyrat?
 - ▶ Cilat janë dallimet në lidhje me bashkësitë e ndryshme etnike?
 - ▶ Nxënësi/nxënësja a ka bërë diçka më ndryshe (ka përdorur tjetër nuancë, i ka ndryshuar pamjen motivit)?
 - ▶ Në çfarë mënyre janë vënë elementet dekorative – a ka simetri?
 - ▶ Me cilat lloje të qilimave nga bashkësitë etnike ngjasojnë qilimat nga shtëpia juaj?





QILIMI MAQEDONAS



QILIMI SHQIPTARË



QILIMI TURK



QILIMI VLLEH

ARKITEKTURA E VJETËR QYTETARE



Klasa

E GJASHTË

Lënda

ARSIM
FIGURATIV

Tema nga programi
mësimor

VIZATIM

Njësia mësimore

ELEMENTE FIGURATIVE,
MJETET PËR VIZATIM
DHE PËRDORIMI I TYRE



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ kuptojë dhe zbatojnë karakteristikat e vizatimit si skicë dhe si shprehje figurative e mëvetësishme;
- ▶ njihet me mënyrat e paraqitjes së iluzionit në hapësirë tredimensionale, në madhësinë relative të objekteve, në vijë ajrore.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me elementet e arkitekturës së vjetër qytetare maqedonase, specifike për qytetet: Veles, Tetovë, Krushevë, Ohër dhe Manastir, të cilat e shprehin multikulturalizmin, bashkëjetesën dhe traditën e përbashkët në shtetin tonë;
- ▶ dallojë elemente të banimit që janë karakteristike për bashkësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë;
- ▶ zhvillojë qasjen e lirë për njohjen e veçorive të kulturave nga rrethina e drejtpërdrejtë;
- ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore.



RESURSE

- ▶ Fotografi në të cilat është paraqitur arkitektura e vjetër qytetare (Shtojca).
- ▶ Laps.
- ▶ Letër për vizatim.



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Mësimdhënësi i pyet nxënësit se cilat janë asociacionet e tyre të para kur do ta dëgjojnë fjalën arkitekturë e vjetër qytetare.
2. Nga asociacionet e fituara nxirret rezymeja se ky nocion lidhet me praktikën e veçantë të ndërtimit në shekullin e 19-të në Maqedoni.
3. Në lidhje me llojet e ndërtimeve që janë paraqitur në atë periudhë, në orë theksi bie te ndërtimet e banimit.
4. Jepet shpjegimi se çdo ndërtim në vetvete e ruan vulën individuale të familjes që jeton, përkatësisht që banon, por në mënyrën e ndërtimit, si dhe në renditjen e hapësirave, lexohen shprehitë që bashkësia së cilës i takon familja i ka futur në identitetin e vet kulturor.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit punojnë në pesë grupe.
2. Secili grup merr materiale/fotografi gjegjëse (shih Shtojcën), ku është paraqitur arkitektura e vjetër qytetare për qytetet: Veles, Tetovë, Krushevë, Ohër dhe Manastir.
3. Nxënësit në kuadër të grupit të tyre kanë për detyrë që ta shikojnë formën e shtëpive, bazamentin, madhësinë, pamjen, ngjyrat, etno-elementet dhe shtrirjen e tyre në raport me objektet tjera të rrugës.
4. Informatat e fituara nga analiza e realizuar nxënësit duhet t'i shfrytëzojnë për detyrën vijuese.
5. Në kuadër të grupeve të tyre, nxënësit duhet të bëjnë një seri vizatimesh (reproduksion), duke e paraqitur shtëpinë me shtrirje si në hapësirën reale.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Pason prezantimi i vizatimeve në grupe.
2. Nxënësit i paraqesin vizatimet, i theksojnë informatat që i kanë ndërmarrë nga materialet. Pastaj i krahasojnë vizatimet nga grupet tjera dhe i definojnë ngjashmëritë që dalin nga jeta e përbashkët në hapësirë të njëjtë.
3. Pastaj i krahasojnë edhe dallimet që paraqiten në ndërtimin e banesave të bashkësi të ndryshme etnike që jetojnë në R. të Maqedonisë.
4. Me këtë rast, me ndihmën e mësimdhënësit marrin informata se zgjidhjet arkitektonike janë rezultat i pozitës sociale të familjeve dhe të qyteteve, të cilat në të kaluarën kanë pasur pikëpjekje me tendencat evropiane, që i kanë bartur në R. të Maqedonisë.



ARKITEKTURË QYTETARE E VJETËR E VELESIT



ARKITEKTURË QYTETARE E VJETËR E TETOVËS



ARKITEKTURË QYTETARE E VJETËR E KRUSHEVËS



ARKITEKTURË QYTETARE E VJETËR E OHRIT



ARKITEKTURË QYTETARE E VJETËR E MANASTIRIT

NJOHJA E KARAKTERISTIKAVE ARKITEKTONIKE TË OBJEKTEVE RELIGJIOZE

10



Klasa

E GJASHTË

Lënda

ARSIM
TEKNIK

Tema nga programi
mësimor

PUNË ME MATERIAL
DHE KONSTRUKTIM

Njësia mësimore

ARKITEKTURA
NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësjat të:

- ▶ dijë arkitekturën maqedonase, karakteristikat, rëndësinë e saj;
- ▶ njohë punët e ndryshme në objekte (religjioze), karakteristike për bashkësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësjat të:

- ▶ forcojë ndjesinë e çiltërsisë për njohjen e veçorive të objekteve religjioze të përfaqësuesve të religjioneve të ndryshme në rrethinën e drejtpërdrejtë;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit dhe të empatisë ndaj objekteve religjioze, që janë shprehje e traditës që ekziston me shekuj në këto hapësira;
- ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore, ku religjioni është element i rëndësishëm në kulturë.



RESURSE

- ▶ Fotografi nga arkitektura e objekteve fetare në R. të Maqedonisë (Shtojca).
- ▶ Kompjutera.
- ▶ Internet.
- ▶ Literaturë profesionale.



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS


1. Duke e shfrytëzuar teknikën rrush, mësime dhënësi çel diskutim me atë se çka nënkuptojnë nxënësit me nocionin kulturë.
2. Me këtë rast, mësime dhënësi i nxit nxënësit që ta shikojnë nocionin në kuptimin më të gjerë, si mënyrë të jetës. Në këtë drejtim, mësime dhënësi shpjegon se çdo bashkësi i bën kreacion mënyrës së vet të jetës me karakteristikat e veta specifike. Karakteristikë e rëndësishme e një bashkësie është edhe mënyra se si praktikohet religjioni.
3. Më tej, mësime dhënësi shpjegon se për realizimin e mënyrës specifike të jetës bashkësitë ndërtojnë objekte të cilat e paraqesin kulturën dhe me pyetje i nxit nxënësit që të përmendin bashkësi të ndryshme kulturore në Republikën e Maqedonisë dhe t'i lidhin me përkatësinë religjioze. Secili prej religjioneve të definuara lidhet me objektin gjegjësisht përmes fotografive (shih Shtojcën) nga objektet e njohura religjioze në Maqedoni.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit ndahen në tre grupe, sipas religjioneve që janë më të pranishme në Republikën e Maqedonisë dhe punojnë sipas kaheve në vazhdim:
 - ▶ Grupi i parë drejtohet në hulumtimin e manastireve dhe të kishave në Maqedoni, me ç'rast theksohet nevoja për të bërë periodizimin e ndërtimit të objekteve (udhëzohet që hulumtimi të bëhet për kishat që janë bazilika të Krishterimit të hershëm, si dhe për kishat që janë ndërtuar në shekujt 20 dhe 21) në krahasim me elementet themelore, bazamentin e kishës, shtrirjen e oltarit, kupolat, freskat.
 - ▶ Grupi i dytë punon në krahasimin e kishës katolike në Shkup me kishat katolike në botë, me theksin e vënë në bazamentin e kishës, realizimet e kryera në tavan, shtrirjen e oltarit dhe të organove, dhe të vitrazheve.
 - ▶ Grupi i tretë hulumton për xhamitë në Maqedoni. Bën periodizimin sipas kohës së ndërtimit dhe i nxjerr në pah elementet themelore, bazamentin e ndërtimit, kiblen, dekorimet dhe shtrirjen e minareve. Gjithashtu, nxënësit udhëzohen që të bëjnë dallimin mes Xhamisë së Larmë dhe xhamive që janë ndërtuar në kohën më të re.
2. Të gjitha grupet me ndihmën e kërkuesit të internetit kërkojnë të dhëna për temën që kanë marrë në kuadër të grupit.
3. Nxënësit punojnë në grupet e tyre, hulumtojnë, i ruajnë informatat e gjetura në një folder të veçantë elektronik, i analizojnë, i selektojnë informatat e nevojshme dhe përgatiten për prezantim.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nxënësit prezantojnë dhe pastaj me ndihmën e mësime dhënësit bisedojnë për ngjashmëritë dhe dallimet në lidhje me karakteristikat arkitektonike të objekteve sipas pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Cilat karakteristika janë të ngjashme, e cilat janë të ndryshme për objektet që i analizuam?
 - ▶ A keni hasur objekte të këtylla në rrethinën tuaj dhe a keni vizituar ndonjë prej tyre?
 - ▶ Si ndiheshit derisa i analizuam fotografitë?



TEMPULLI KUVENDOR ARKIPESHKOPAL I KISHËS ORTODOKSE
MAQEDONASE "SHËN KLIMENTI I OHRIT" - SHKUP



XHAMIA E LARME – TETOVË



KISHA KATEDRALE „ZEMRA TEJET E SHENJTË E JUEZUSIT“ - SHKUP



NGA IDEJA NË REALIZIM



Klasa

E GJASHTË

Lënda

ARSIM
TEKNIK

Tema nga programi
mësimor

PUNË ME
MATERIALE DHE
KONSTRUKTIM

Njësia mësimore

NGA IDEJA NË
REALIZIM (DISENJI I
PRODUKTIT TEK I CILI
KA QËNDISJE)



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ hulumtojnë zgjidhje bashkëkohore për disenjim përmes aplikacioneve kompjuterike;
- ▶ mund që në mënyrë estetike të formësojnë dhe të disenojnë;
- ▶ zhvillojnë shkathtësi për krijimtari teknike.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ thellojnë njohuritë për karakteristikat e qëndismave tradicionale (motivet dominante, larat, ngjyrat) të bashkësitë e ndryshme që jetojnë në Maqedoni;
- ▶ zhvillojnë qasjen e lirë për njohjen e specifikave historike dhe kulturologjike të bashkësive etnike nga rrethina e vet;
- ▶ forcojnë ndjesinë për vlerën e kulturës së vet dhe të zhvillojnë qëndrime pozitive ndaj identitetit kulturor të bashkësive etnike në R. të Maqedonisë.



RESURSE

- ▶ Kompjutera dhe aplikacion kompjuterik gjegjës.
- ▶ Fotografi nga qëndismat tradicionale (Shtojca).



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Ora fillon duke paralajmëruar temën – veprimin e qëndisjes si mënyrë e krijimit të kreacioneve artistike. Pastaj mësimitdhënësi i pyet nxënësit se a kanë provuar ndonjëherë që të bëjnë qëndisma, ose a kanë parë ndonjë që qëndis.
2. Përmes bisedës i nxit nxënësit që ta definojnë qëndismën tradicionale të bashkësisë së tyre etnike dhe t'i definojnë ngjyrat e saj dominante.
3. Më tej, mësimitdhënësi shpjegon se qëndismat me motive, me lara dhe ngjyra dominante është e lidhur me identitetin e bashkësive dhe me funksionin dekorativ. Në të vërtetë, kur ajo aplikohet në materiale, e shton vlerën e produktit, përkatësisht e bën që të jetë origjinal dhe autentik.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit punojnë në çifte.
2. Çdo çift shfrytëzon materiale me fotografi me ngjyra (shih Shojcën), ku veç e veç janë paraqitur qëndisma tradicionale të bashkësive në Maqedoni.
3. Prej nxënësve kërkohet që t'i studiojnë motivet, larat dhe ngjyrat karakteristike dominante për secilën bashkësi.
4. Çdo çift me ndihmën e veglave kompjuterike bën disenjin e vet të qëndismës, e cila në vete do të përmbajë elemente prej secilës qëndismë tradicionale veç e veç.
5. Çiftet marrin detyrë që qëndismën e disenjuar ta aplikojnë në mënyrë elektronike te produkti (sipas zgjedhjes personale, kjo mund të jetë çantë, këmishë, maramë, stoli...) të cilën do ta brendojnë si produkt maqedonas.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Çiftet e prezantojnë produktin e tyre, duke i theksuar materialet prej të cilit është bërë dhe duke i shpjeguar elementet që janë përfshirë në disenjin e qëndismës.
2. Pastaj mësimitdhënësi nis diskutimin në lidhje me çështjet:
 - ▶ Çka mësuat për karakteristikat e qëndismave tradicionale të bashkësive në Maqedoni?
 - ▶ Cilat janë elementet karakteristike të secilës prej tyre?
 - ▶ Si e përjetuat procesin e kuptimësimin të produktit?
 - ▶ Cila fazë ju duk më interesante?
 - ▶ Cilat ishin problemet me të cilat u ballafaquat?
3. Të gjithë bashkë nxjerrin përfundimin nga diskutimi se ngjashmëritë që hasen te qëndismat e definojnë lidhshmërinë e bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Prandaj, çdo kombinim i elementeve specifike në një disenj të integruar zhvillohet në një produkt specifik, i cili gjithnjë mund të quhet – produkt i vërtetë maqedonas.

SHTOJCA

Shembuj fotografish me qëndisma tradicionale karakteristike për bashkësitë etnike



QËNDISMË
MAQEDONASE



QËNDISMË
SHQIPTARE



QËNDISMË
TURKE







QËNDISMË
SERBE

SI TË KOMUNIKOJMË MË MIRË?



Klasa	Lënda	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
E GJASHTË	GJUHË AMTARE	LETËRSIA DHE LEKTYRA – PROZË TË SHPREHURIT DHE KRIJIMI – SHPREHJE ME GOJË	BISEDA SI NJË LLOJ KOMUNIKIMI

	QËLLIMET E MËSIMIT	Nxënësi/nxënësja të: <ul style="list-style-type: none"> ▶ marrë pjesë në diskutime si dialog komunikativ; ▶ përdorë fjalë gjegjëse për komunikim kulturor.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	Nxënësi/nxënësja të: <ul style="list-style-type: none"> ▶ zhvillojë shkathtësi për komunikim dhe për bashkëpunim, që janë të nevojshme për interaksion me nxënësit nga kulturat tjera; ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore.
	RESURSE	▶ Fletë pune.
	KOHA	Dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Mësimdhënësi i nxit nxënësit të mendojnë dhe ta ndajnë përvojën e tyre kur kanë mbrojtur mendimin e vet të mospajtimit ose të mospranimi të ideve në një temë të caktuar (për shembull, ku të shkohet në ekskursion; zgjedhja e temës për një projekt të ri e të ngjashme). I pyet se si janë ndier në një situatë të tillë.
2. Prej nxënësve kërkohet që të japin ide për rregulla që i kontribuojnë respektimit të ndërsjellë gjatë kohës së dialogut, kur secili mund ta thotë mendimin e vet e me këtë rast të shmangen ofendimi, përqeshja dhe kritika (për shembull, emërimi me emra ofendues, përshkrimi i vetive negative e të ngjashme).
3. Propozim-idetë e nxënësve shkruhen në dërrasë të zezë.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësve u jepet Fleta e punës, ku janë dhënë rregullat themelore të dialogut. Mësimdhënësi i lexon rregullat themelore me zë. Prej nxënësve kërkohet që t'i krahasojnë rregullat me ide që vetë i kanë propozuar dhe nëse ka nevojë, mund të shtojnë të reja ose t'i ndryshojnë ato ekzistueset.
2. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe u jepet Fleta e punës 2. Nxënësve u prezantohet Fleta e punës, ku janë të dhëna udhëzimet se si të punohet në skenarët me dialog, në të cilët ka situata mospajtimi me idetë nga ana e të tjerëve, ofendime ose nënçmime që shkaktojnë ndjesi të pakëndëshme te tjetri. Nxënësve u jepen kahe se duhet t'i shfrytëzojnë rregullat e dialogut, të cilat bashkë i harmonizuan në aktivitetin hyrës.
3. Prej nxënësve nga secili grup kërkohet që ta lexojnë skenarin e vet, të përgjigjen në pyetjet nga Fleta e punës, edhe atë, së pari ta identifikojnë problemin gjatë sjelljes, e pastaj ta shkruajnë rregullën themelore, e cila do ta parandalojë problemin gjatë sjelljes. Nxënësit kanë 10 minuta kohë për punë.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV


1. Pas përfundimit të detyrës, secili grup me zë e lexon skenarin, përgjigjet në pyetjet dhe në rregullën themelore që kanë shkruar.
2. Pas leximit të skenarëve nga të gjitha grupet, mësimdhënësi hap diskutim për përdorimin dhe nevojën e shfrytëzimit të rregullave për vazhdimin e dialogut, kur bëhet fjalë për temë kritike.

Nxënësve u shtrohen këto pyetje për refleksion:

1. A konsideroni se mund t'i përdorni këto rregulla themelore në komunikimin e përditshëm? Përse po, ose përse jo?
2. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që me sukses të zhvilloni diskutim verbal në klasë dhe në komunikimin me të tjerët? Përse po, ose përse jo?
3. Cilat janë arritjet për tërë paralelen nga shfrytëzimi i rregullave themelore në komunikimin e përditshëm me bashkënxënësit e tyre?

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

4. A duhet të keni komunikim dhe sjellje të mirë me të gjithë, qoftë edhe atëherë kur ndonjë person nuk e keni bash për qejfi?
5. Çfarë komunikimi duhet të keni me pjesëtarët e bashkësisë tjetër etnike dhe me kulturë të ndryshme nga e juaja (shembulli me situatën 5)?
6. A keni qenë në situatë të keni mendim të ndryshëm nga moshatarët tuaj rreth respektimit dhe pranimit të të tjerëve, pa marrë parasysh kulturën ose përkatësinë e tyre etnike?
7. Si do t'ia dilnit në situatën kur shoku juaj më i mirë do t'ju kishte sulmuar/ gjykuar për shkak se shoqëroheni me bashkënxënës nga kultura ose përkatësia tjetër etnike?



1. Respekto të drejtën e të tjerëve të kenë mendimin dhe qëndrimet e veta, që janë të ndryshme prej tuave!
2. Kritiko idetë, jo njerëzit!
3. Me kujdes dëgjoje atë çka të tjerët flasin, qoftë edhe atëherë kur nuk pajtohesh me të! Komentet që i jep (pyetjet e shtruara për shpjegim, shikim kritik të gjërave, zgjerim të temës e të ngjashme) duhet të jenë refleksi i asaj se me kujdes i ke ndjekur komentet e të tjerëve.
4. Jij gjentil – mos ndërhyjë me fjalë dhe shmang çdo lloj bisede derisa të tjerët flasin!
5. Respektoji mendimet e njerëzve të tjerë (në vend se të japësh gjykime), kur ato ndryshojnë prej tuave!

GRUPI 1

Lexojeni skenarin me situatë problemore dhe pyetjet në të cilat duhet të jepni përgjigje. Me këtë rast duhet t'i keni parasysh rregullat për dialog/diskutim verbal të dhëna në Fletën e punës 1. Keni 10 minuta kohë për punë, e pastaj secili grup do ta lexojë skenarin dhe do ta prezantojë punën e vet.

Skenar – Në orën klasore nxënësit propozojnë tema për projektin e ri. Propozimit të Sarës, që tema të jetë „Respektimi i të tjerëve dhe mosdiskriminimi“, si rezultat i shembujve të shpeshtuar të trajtimit të pabarabartë dhe të sjelljes jo fer ndërmjet nxënësve në shkollë, Maria i drejtohet: „Si mund të propozosh një ide të tillë, e cila është vetëm humbje kohe?! Kjo është një ide e ndërlikuar, për të cilat ne si nxënës nuk do të kishim mundur diçka të ndryshojmë.“ Sara nuk ndjehet mirë dhe e tërheq idenë.

Problemi – Ajo çka foli Maria a është e përshtatshme? Përse po, ose përse jo? A konsideroni se ajo e ka kuptuar se i ka lënduar ndjenjat e Sarës?

Në çfarë mënyre Maria mund ta shprehte mendimin e vet për propozimin e Sarës, pa e nënçmuar dhe pa e hedhur propozimin e saj? Shkruani se çka mund të thoshte ajo...

Rregulla – Shpjegojeni rregullën për respektimin e mendimit të tjerit...

PYETJE PËR DISKUTIM NË GRUPET E VOGLA

1. A konsideroni se mund t'u përmbaheni këtyre rregullave themelore? Përse po, ose përse jo?
2. Çka duhet të bëjmë, po qe se ndonjëri i shkel rregullat themelore?
3. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që më lirisht të shprehni me moshatarët tuaj? Përse po, ose përse jo?

GRUPI 2

Lexojeni skenarin me situatë problemore dhe pyetjet në të cilat duhet të jepni përgjigje. Me këtë rast duhet t'i keni parasysh rregullat për dialog/diskutim verbal, të dhëna në Fletën e punës 1. Keni 10 minuta kohë për të punuar, e pastaj secili grup do ta lexojë skenarin e vet dhe do ta prezantojë punën që ka bërë.

Skenar – Derisa grupi punon në shumësinë e ideve në lidhje me aksionin për rregullimin e oborrit të shkollës, që bëhet në bashkëpunim me bashkësinë lokale, Bojani propozon: „Mund të bëjmë fontanë.” Terezës nuk i pëlqen ideja dhe ajo me nënqeshje i përgjigjet: „Aq je i marrë Bojan, sa që nuk sheh se nuk mund të gjejmë vegla për punë dhe të sigurojmë fidanë, e ti propozon fontanë.”

Problem – Përse Tereza e përqesh Bojanin? A konsideroni se ajo e kuptoi se i lëndoi ndjenjat e tij? Si mund të jepte koment kritik Tereza në propozim-idenë e Bojanit, pa e ofenduar personalisht? Shkruani se çka mund të thoshte ajo...

Rregull – Shpjegojeni rregullën për **të kritikuar idetë**, e jo njerëzit...

PYETJE PËR DISKUTIM NË GRUPET E VOGLA

1. A konsideroni se mund të bashkoheni rreth këtyre rregullave themelore? Përse po, ose përse jo?
2. Çfarë duhet të bëjmë po qe se ndonjëri i shkel rregullat themelore?
3. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që më lirisht të shprehni me moshatarët tuaj? Përse po, ose përse jo?

GRUPI 3

Lexojeni skenarin me situatë problemore dhe pyetjet në të cilat duhet të jepni përgjigje. Me këtë rast duhet të keni parasysh rregullat për dialog/diskutim verbal, të dhëna në Fletën e punës 1. Keni 10 minuta kohë për të punuar, e pastaj secili grup do ta lexojë skenarin e vet dhe do ta prezantojë punën që ka bërë.

Skenar – Ashela shpjegon se familja e saj më së miri e mëson gjuhën maqedonase duke shikuar televizion dhe duke u shoqëruar me fqinjët. Ajo shpjegon se ata rregullisht mblidhen me disa familje të tjera boshnjake dhe atëherë flasin në gjuhën e tyre. Stefani e ndërpret dhe i thotë: „Asnjëherë nuk do të mësoni maqedonisht nëse në shtëpi flisni vetëm në gjuhën boshnjake.”

Problem – Stefani, cilën pjesë nga tregimi i Ashelës e injoroi ose nuk e kuptoi? Përse ai supozoi se familja e saj në shtëpi nuk flet maqedonisht?

Me cilën pyetje Stefani mund t'i drejtohej Ashelës për ta pasur më të qartë situatën e familjes së saj, sesa të supozonte se ata në shtëpi nuk flasin maqedonisht? Shkruaj se çka mund të thoshte ai...

Rregull – Shpjegojeni rregullën për dëgjim të kujdesshëm të bashkëfolësit dhe pyetje me kujdes, po qe se ndonjë tregim nuk e ke të qartë...

PYETJE PËR DISKUTIM NË GRUPE TË VOGLA

1. A konsideroni se mund t'u përmbaheni këtyre rregullave themelore? Përse po, ose përse jo?
2. Çfarë duhet të bëjmë po qe se ndokush i shkel rregullat themelore?
3. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që më lirisht të shprehni me moshatarët tuaj? Përse po, ose përse jo?

GRUPI 4

Lexojeni skenarin me situatë problemore dhe pyetjet në të cilat duhet të jepni përgjigje. Me këtë rast duhet t'i keni parasysh rregullat për dialog/diskutim verbal, të dhëna në Fletën e punës 1. Keni 10 minuta kohë për të punuar, e pastaj secili grup do ta lexojë skenarin e vet dhe do ta prezantojë punën që ka bërë.

Skenar – Derisa nxënësi i ri e shpjegon mënyrën se si ka ardhur deri te zgjidhja e detyrës problemore nga matematika, të cilën e ka mësuar në shkollën e mëparshme, Petari dhe Ivani pëshpërisin ngadalë për ndeshjen e futbollit. Kur nxënësi i ri del para dërrasës së zezë që ta zgjidh detyrën, Petari klith: „Kjo nuk është mënyra sipas së cilës zgjidhet një detyrë e këtillë; në çfarë shkollë vallë ke shkuar?“, ndërsa Ivani qeshet.

Problem – A mendon se nxënësi i ri ka vërejtur se bashkënxënësit e tij pëshpërisnin derisa ai fliste? Pas kësaj ndodhie nxënësi i ri a do të dojë të shoqërohet me Petarin dhe me Ivanin? Si do ta përshkruani sjelljen e Petarit dhe të Ivanit?

Cilat rregulla themelore Petari dhe Ivani nuk i respektojnë?...

Rregull – Shpjegojeni rregullën e mosndërrhyrjes në fjalë dhe të shmangies së çfarëdo bisede derisa të tjerët flasin...

PYETJE PËR DISKUTIM NË GRUPET E VOGLA

1. A konsideroni se mund t'u përmbaheni këtyre rregullave themelore? Përse po, ose përse jo?
2. Çfarë duhet të bëjmë nëse ndonjë i shkel rregullat themelore?
3. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që më lirisht të shprehni me moshatarët tuaj? Përse po, ose përse jo?

GRUPI 5

Lexojeni skenarin me situatë problemore dhe pyetjet në të cilat duhet të jepni përgjigje. Me këtë rast duhet të keni parasysh rregullat për dialog/diskutim verbal, të dhëna në Fletën e punës 1. Keni 10 minuta kohë për të punuar, e pastaj secili grup do ta lexojë skenarin e vet dhe do ta prezantojë punën që ka bërë.

Skenar – Vllatkoja dhe Edisi përgatiten për të promovuar videofilmin për Çarshinë e Vjetër, që do të mbahet në Teatrin Turk. Tema është gjallërimi i Çarshisë së Vjetër dhe shtimi i vizitorëve. Shokëve të Vllatkos nuk u pëlqen tema, për shkak se ka të bëjë me Çarshinë e Vjetër, ndërsa Filipi i komenton Vllatkos para të gjithëve: „Askush prej shokëve nuk do të vijë në promovim, për shkak se tema është për Çarshinë e Vjetër, por edhe shokët e Edisit mendojnë se maqedonasi nuk mund ta kapë jetën e zejtarëve dhe të tregtarëve, të cilët kryesisht janë turq dhe shqiptarë.“

Problem – Përse Filipi e nënçmon idenë me videofilmin? Cilat janë supozimet e Filipit? A janë të sakta supozimet e tij?

Si mund të reagoje Filipi pa e nënçmuar idenë për videofilmin? Shkruaj se çka mund të thoshte ai...

Rregull – Shpjegojeni rregullën për mosgjykimin e ideve të njerëzve të tjerë, të cilat dallohen prej tuave...

PYETJE PËR DISKUTIM NË GRUPE TË VOGLA

1. A konsideroni se mund t'u përmbaheni këtyre rregullave themelore? Përse po, ose përse jo?
2. Çka duhet të bëjmë nëse ndonjë i shkel rregullat themelore?
3. Këto rregulla themelore a mund t'ju ndihmojnë që më lirisht të shprehni me moshatarët tuaj? Përse po, ose përse jo?

KUSH JEMI NE NË MAQEDONI?



Klasa

E SHTATË

Lënda

GJEOGRAFI

Tema nga programi
mësimor

KARAKTERISTIKAT
SOCIO-GJEOGRAFIKE
TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË

Njësia mësimore

KARAKTERISTIKAT
DEMOGRAFIKE TË
POPULLSISË NË
R. E MAQEDONISË



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me dinamikën e shtimit të popullsisë në R. të Maqedonisë gjatë regjistrimeve;
- ▶ dallojë rajonet me dendësi më të madhe dhe më të vogël të popullsisë, si dhe shtimin natyror dhe shkaqet;
- ▶ klasifikojë popullsinë përmes gjinisë, moshës, arsimit, strukturës ekonomike, etnike etj.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me numrin dhe llojin e karakteristikave demografike, si t'i dallojë ato të bashkësitë etnike në R. të Maqedonisë;
- ▶ njohë dhe të zhvillojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.
- ▶ Teknologji kompjuterike.
- ▶ Rrjet interneti.
- ▶ Projektor LCD.
- ▶ Përmbajtje digjitale.



KOHA

Dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Mësimdhënësi e fillon diskutimin përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Cilat bashkësi etnike jetojnë në Maqedoni?
 - ▶ Cilat gjuhë fliten në R. të Maqedonisë?
 - ▶ Si është shteti ynë, a është monokulturor apo multikulturor?
2. Përmes prezantimit të përmbajtjes së shkurtër digjitale, përgatitur nga mësimdhënësi, nxënësit njihen me dinamikën e shtimit të popullsisë në Republikën e Maqedonisë gjatë regjistrimeve, me ç'rast e klasifikojnë popullsinë përmes gjinisë, moshës, arsimit, strukturës ekonomike, etnike e tjetër. Demonstrohen rajonet me dendësi më të madhe dhe më të vogël të popullsisë, si dhe shtimi natyror dhe shkaqet, e, njëkohësisht, paraqiten rajonet me homogenitet të theksuar të popullsisë nga një bashkësi etnike dhe rajonet me popullim multi-etnik.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit ndahen në shtatë grupe të vogla.
2. Secili grup merr nga një ekzemplar prej Fletës së punës, ku ka tabelë me tri kolona: Di, Dua të di dhe Mësoj (DDM) dhe shtatë rreshta, ku janë shënuar bashkësitë më të pranishme etnike në Republikën e Maqedonisë.
3. Në këtë pjesë të orës grupet i plotësojnë dy kolonat e para dhe të gjitha rreshtat. Njëkohësisht, mësimdhënësi vizaton një tabelë të njëjtë në dërrasë të zezë, që të mund ta bëjë përmbledhjen dhe evidentimin e njohurive dhe të nevojave të nxënësve për dituri në lidhje me bashkësitë etnike në Republikën e Maqedonisë.
4. Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të aktivitetit grupet marrin detyrë të hulumtojnë për një bashkësi etnike konkrete dhe me këtë rast të udhëhiqen nga të dhënat e grupit në kolonën e dytë dhe udhëzimet konkrete të dhëna nga mësimdhënësi, e që kanë të bëjnë me çështjet në vazhdim:
 - ▶ Si janë karakteristikat demografike sipas: numrit, vendit të banimit, strukturës së moshës, gjinisë, arsimit dhe fuqisë ekonomike në bashkësinë etnike për të cilën hulumton grupi juaj?
 - ▶ A ka dinamikë të rritjes së popullsisë te bashkësia etnike për të cilën hulumton grupi juaj?
 - ▶ Çfarë dendësie të popullsisë ka bashkësia etnike për të cilën hulumton grupi juaj?
 - » **Grupi i parë** hulumton për shqiptarët.
 - » **Grupi i dytë** hulumton për turqit.
 - » **Grupi i tretë** hulumton për romët.
 - » **Grupi i katërt** hulumton për maqedonasit.
 - » **Grupi i pestë** hulumton për vllahët.
 - » **Grupi i gjashtë** hulumton për serbët.
 - » **Grupi i shtatë** hulumton për boshnjakët.
5. Mësimdhënësi u tregon ueb-lokacionet ose literaturën profesionale gjegjëse, ku nxënësit mund t'i gjejnë të dhënat:
 - ▶ www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strategija_demografaska.doc
 - ▶ www.igeografija.mk/Portal/?p=3093
 - ▶ www.stat.gov.mk
 - ▶ https://mk.wikipedia.org/wiki/Географија_на_Македонија
6. Po qe se nuk ka kohë që në orën e parë të realizohet hulumtimi, mësimdhënësi këtë e jep si detyrë shtëpie, ndërsa nxënësit në orën në vazhdim e prezantojnë.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Grupet e plotësojnë kolonën e fundit nga tabela e tyre.
2. I prezantojnë njohuritë deri te të cilat kanë ardhur gjatë hulumtimit për bashkësinë etnike konkrete dhe i përndajnë sfidat me të cilat janë ballafaquar gjatë hulumtimit.
3. Diskutojnë rreth çështjeve në vazhdim:
 - ▶ Cilat bashkësi etnike e përbëjnë shoqërinë multikulturore maqedonase?
 - ▶ Si janë karakteristikat e tyre demografike?
 - ▶ Sipas të dhënave të fituara, a mund të marrim informacione për interaksion në rajone demografike të caktuara?
 - ▶ Çka mësuam për shoqërinë multikulturore?
 - ▶ Cila bashkësi etnike ka dendësi më të madhe, e cila ka dendësi më të vogël të popullsisë dhe prej çfarë varet ky proces?
 - ▶ Cilat janë përshtypjet tuaja nga hulumtimi? A thua tash jeni më të hapur për njohje më të mirë të bashkësive etnike që jetojnë në shtetin tonë?



<u>Tabela</u> <u>DDM</u>	<u>DI</u> <u>Çka mendojmë</u> <u>se dimë?</u>	<u>DUA TË DI</u> <u>Çka duam</u> <u>të dimë?</u>	<u>MËSOJ</u> <u>Çka mësuam?</u>
1. Gjatë plotësimit të tabelës udhëhiquni sipas pyetjeve të theksuara: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Cilat janë karakteristikat demografike sipas: numrit, vendit të banimit, strukturës së moshës, gjinisë, arsimit dhe fuqisë ekonomike në bashkësinë etnike për të cilën hulumton grupi juaj? ▶ A ka dinamikë të rritjes së popullsisë në bashkësinë etnike për të cilën hulumton grupi juaj? ▶ Çfarë dendësie të popullsisë ka bashkësia etnike për të cilën hulumton grupi juaj? 			
2. Që ta plotësoni kolonën e tretë, shfrytëzoni ueb-lokacionet në vazhdim: <ul style="list-style-type: none"> ▶ www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strategija_demografiska.doc ▶ www.igeografija.mk/Portal/?p=3093 ▶ www.stat.gov.mk ▶ https://mk.wikipedia.org/wiki/Географија_на_Македонија 			
<u>Shqiptarë</u>			
<u>Turq</u>			
<u>Romë</u>			
<u>Maqedonas</u>			
<u>Vlleh</u>			
<u>Serbë</u>			
<u>Boshnjakë</u>			

ISLAMI DHE KRISHTERIMI



Klasa

E SHTATË

Lënda

HISTORI

Tema nga programi
mësimor

**BOTA DHE EVROPA NË
MESJETËN E HERSHME**

Njësia mësimore

**PARAQITJA E ISLAMIT –
ORË PËR PËRSËRITJE**



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zbatojë njohuritë e fituara më parë për Krishterimin dhe Islamin, me qëllim që t'i krahasojë dy religjionet më të mëdha botërore;
- ▶ mund ta paraqet bazën e religjioneve dominante në shtetin tonë;
- ▶ përmirësojë komunikimin në grup dhe të sillt në mënyrë konstruktive ndaj atyre që janë të ndryshëm prej vetvetes;
- ▶ pranojë dallimet dhe të praktikojë sjellje pa paragjykime.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë qasje të hapur për njohjen e veçorive të kulturave nga rrethina jonë e drejtpërdrejtë sipas përkatësisë religjioze;
- ▶ të zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave tjera, duke i theksuar karakteristikat e përbashkëta, të cilat ndikojnë pozitivisht ndaj vlerave të tyre morale;
- ▶ të ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore, ku diversiteti është vlerë, e jo hendikep/pengesë në bashkëjetesë.



RESURSE

- ▶ Shtojca 1 dhe 2, me përmbajtje për Islamin dhe Krishterimin, nga libri shkollor „Etika e religjioneve” (Етика на религиите) nga mr. Petko Zlatevski. http://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Etika_vo_religiite_5_mak.pdf



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Përmes pyetjeve të shkurtra mësimdhënësi nxit diskutim për të dy religjionet më dominante në R. të Maqedonisë për çështjet në vazhdim:
 - ▶ Çka dimë për myslimanët, e çka për të krishterët?
 - ▶ Çka propagon Islami, e çka Krishterimi?
 - ▶ Çka mendoni, Krishterimi dhe Islami sa janë të ngjashëm/të ndryshëm?

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit ndahen në më shumë/disa grupe të vogla. Secili grup merr nga dy tekste (shih Shtojcën 1 dhe 2) për Krishterimin dhe për Islamin. Detyra e tyre është që t'i nxjerrin karakteristikat kryesore nga të dy religjionet dhe t'i paraqesin në Diagramin e Venit, ku do t'i krahasojnë ngjashmëritë dhe dallimet e tyre.
2. Nga një përfaqësues i grupit i prezanton të dhënat e fituara. Po qe se në grupe ka dallim në trajtimin e ngjashmërive dhe të dallimeve të karakterisitkave themelore të religjioneve, mësimdhënësi intervenon me argumente dhe me shembuj në drejtim të shpjegimit dhe të theksimit të ngjashmërive dhe të dallimeve.
3. Në dërrasë të zezë vizatohet Diagrami i Venit, ku përmbliidhen dhe prezantohen të dhënat nga puna në grupe.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Mësimdhënësi inicion diskutim përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Çka mësuat të re për religjionet sot?
 - ▶ Sa ngjashmëri dhe sa dallime zbuluat ndërmjet religjioneve?
 - ▶ A prisnit ngjashmëri kaq të madhe ndërmjet dy religjioneve?
 - ▶ Për çfarë vlerash etike dhe morale angazhohen këto dy religjione?
 - ▶ Përse religjioni është aq i rëndësishëm në jetën e njeriut?
 - ▶ Çfarë është ajo që ka mundësuar që religjionet të ekzistojnë kaq gjatë gjatë shekujve?
 - ▶ Njohja e religjioneve a nxit më shumë respekt ndaj të gjitha religjioneve dhe ndaj besimtarëve të tyre?

Islami është mbështetur mbi **gjashtë parimet e rëndësishme të besimit**: Besimi në Allah, në melaqet (engjëjt) e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit dhe në besimin se jeta pas vdekjes është e vërtetë. Myslimanët besojnë në një Zot, të cilin e quajnë Allah, i cili është Krijues i gjithçkasë – i natyrës dhe i gjithë asaj që shihet e që nuk shihet. Ai është një. Nuk ka prindër, grua, as fëmijë. Ai është pa fillim dhe pa fund. Gjithçka di, gjithçka sheh dhe është i gjithëfuqishëm. Allahu është i përshkruar me të gjitha vetitë pozitive. Jezu Krishtin myslimanët e konsiderojnë si të dërguar të Zotit.

Islami mëson se Allahu u ka dërguar disa libra të dërguarve në tokë, edhe atë: 1. Teuratin (Torën), që i është shpallur Musës (Mojsiut); 2. Zeburin (Psalmet), shpallur Davudit (Davidit); 3. Inxhilin (Ungjillin), shpallur Isës (Jezusit) dhe 4. Kuranin, shpallur Muhamedit. Sipas Islamit, Allahu ka çuar shumë të dërguar në tokë, mes të cilëve 25 janë përmendur në Kuran. Më të njohur janë: Ademi (Adam), Nuhi (Noe), Ibrahim (Avram), Musa (Mojsel), Isa (Jezusi) dhe Muhamedi.

Islami përmban rregulla të cilat besimtarët duhet t'i zbatojnë, ndërsa zbatimi i atyre rregullave është kthyer në **pesë shtylla të Islamit**: **1. Dëshmimi (shehadeti)**; **2. Lutja (namazi)**; **3. Dhënia e bamirësisë (zeqati)**; **4. Agjërimi gjatë muajit të Ramazanit** dhe **5. Haxhillëku (Haxhi)**. Në Islam çdo mysliman është i obliguar që pesë herë gjatë ditës dhe natës t'i lutet Allahut. Një herë në javë, të premtën, në lutjen (namazin) e obligueshme, bashkë duhet të falet në **xhami (tempullin e shenjtë)**. Besimtarët e pasur janë të obliguar që gjatë vitit të ndajnë një pjesë nga pasuria e tyre (2,5%) për ata që janë të varfër dhe që kanë nevojë për ndihmë (zeqat). Myslimanët janë të obliguar që gjatë vitit të agjërojnë gjatë muajit të Ramazanit. Agjërimi fillon nga agimi dhe zgjat deri në perëndimin e diellit, kur myslimanët nuk hanë dhe nuk pinë kurrjë. Pas përfundimit të muajit të Ramazanit kremtohet **kremtja e Ramazan-Bajramit**. Myslimanët e pasur dhe të shëndoshë janë të obliguar që një herë në jetën e tyre të shkojnë në Haxh (haxhillëk). Haxhillëku kryhet duke vizituar shtëpinë e shenjtë të Zotit, Qabenë. Pas haxhillëkut kremtohet **kremtja e Kurban-Bajramit**.

Gjatë muajit të agjërit Ramazan ka filluar shpallja e **Kuranit – librit të shenjtë për myslimanët**. Fjala e parë e zbritur nga Kurani është: „Lexo!“. Njeriu e ka për obligim që të marrë njohuri të çdo lloji, ndërsa kërkimi pas njohurisë duhet të zgjasë gjatë tërë jetës. Vetëm i mësuari mund të jetë i dobishëm për vete, për familjen, për shoqërinë dhe përgjithësisht për njerëzimin. Islami mëson se myslimanët duhet të çlirohen nga të gjitha vetitë e këqija, siç janë: urrejtja, arroganca, lakmia, dyfytërsia e të ngjashme. Në të njëjtën kohë, duhet të kultivohet ndjenja e dashurisë dhe e respektit ndaj të gjithë njerëzve. Disa prej veprave të ndaluara janë: gënjeshtria, jomoraliteti, vjedhja, konsumimi, shitja dhe shërbimi i alkoolit dhe i narkotikëve, konsumimi i mishit të derrit, ofendimi i prindërve, mosrespektimi dhe moskujdesi ndaj tyre, vrasja e njeriut të pafajshëm, vetëvrasja, etj.

Muhamedi është i dërguar i Zotit ose peygamber, të cilit Allahu ia ka dorëzuar fjalët e Zotit përmes engjëllit Xhibril (Gabriel). Ato fjalë të Zotit janë shkruar në Kuran. Muhamedi ka qenë i lindur në vitin 571 në Mekë, Arabia Saudite e sotme. Ai ka jetuar një jetë modeste dhe të thjeshtë dhe ka qenë sidomos i besueshëm dhe i ndershëm. Të sëmurët i ka vizituar rregullisht, pa marrë parasysh se a kanë qenë ata myslimanë ose jo. Shumë i ka dashur dhe i ka respektuar fqinjët e vet. Muhamedi u ka dhuruar njerëzve dëshirë të madhe për shkencë, duke u folur: „Mësimi është obligim fetar për çdo mysliman dhe mysli-manë!“ Të inspiruar nga njohuri të këtilla, myslimanët e parë kanë mësuar me kujdes, janë kujdesur për të varfrit, për gratë dhe për fëmijët, e sidomos për bonjakët.

Të krishterët besojnë në një Zot, i cili ekziston në tre veta – tek Ati, i Biri (Zoti Jezu Krisht) dhe Shpirti i Shenjtë. Si simbol i këtij besimi, të krishterët ortodoksë bëjnë kryq me tre gishtat e bërë bashkë të dorës së djathtë dhe thonë: „Në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë. Amin.“ Themelet e religjionit të krishterë janë vënë rreth 2000 vjet para erës sonë. Lindja e Zotit Jezu Krisht në Tokë paraqet fillimin e erës së re dhe të llogaritjes së re të kohës. Krishti është personalitet historik. Kur ka mbushur 30 vjet është pagëzuar në lumin Jordan dhe publikisht ka filluar ta mësojë popullin. E ka bërë këtë në dy mënyra: me fjalë (predikim dhe mësim) dhe me vepra (ka bërë çudira dhe ka shëruar të sëmurë). Ka zgjedhur dymbëdhjetë apostuj, të cilët vazhdimisht kanë qenë me Të dhe kanë dëshmuar për veprat e Tij. Përveç prej apostujve, gjithkund është përcjellë edhe nga shumë popull, që donte të dëgjonte për mësimet e Tij ose të shërohet. **Jezusi predikonte për shenjtëritë, për dashurinë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmeve, për agjërimin, për lutjen, për bamirësinë, për drejtësinë dhe për shumë gjëra të tjera.**

Bibla është libër i shenjtë, Fjalë e Zotit, me të cilën Zoti u drejtohet të gjithë njerëzve në të gjitha kohët. E kanë shkruar shumë shkrimtarë, të cilët kanë jetuar në vende të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe kanë pasur profesione të ndryshme. Të gjithë ata kanë qenë të mësuar nga Shpirti i Shenjtë se si t'i shkruajnë fjalët e Zotit drejtuar njerëzve. Bibla është e ndarë në Dhiatë të Vjetër dhe në Dhiatë të Re. Në Bibël janë shënuar ligje dhe rregulla për jetën. Zoti ua ka dhënë njerëzve që të udhëhiqen sipas tyre dhe të kenë raport të drejtë ndaj Krijuesit të tyre dhe ndaj gjithë njerëzve në tokë. Këto ligje janë quajtur Dhjetë Urdhrat e Zotit dhe ato janë:

Fjala „**kishë**“ (në gjuhën e vjetër greke: εκκλησία, siç është e shkruar në Bibël) do të thotë „tubim i atyre që janë të thirrur“. Së këndejmi, mund të themi se kisha është tubim i besimtarëve në një vend që T'i luten dhe Ta kremtojnë Zotin.

- | | | |
|---|--|--|
| 1. Unë jam Hyji, Zoti yt; të mos kesh zota të tjerë përveç Meje! | Hyjit, Zotit tënd! | 6. Mos vra! |
| 2. Mos bëj idol ose përfytyrim të asaj që është lart në qiell, që është poshtë në tokë dhe që është në ujë dhe nën tokë. Mos iu nënshtro dhe mos iu shërbe! | 4. Kujto ditën e pushimit që ta festosh. Gjashtë ditë puno dhe kryeji të gjitha punët, ndërsa ditën e shtatë kushtoja Hyjit, Zotit tënd! | 7. Mos e shkel kurorën! |
| 3. Mos e shqipto për kot emrin e | 5. Respektoje babain tënd dhe nënën tënde, që ta kesh mirë dhe që të jetosh gjatë në tokë! | 8. Mos vidh! |
| | | 9. Mos dëshmo rrejshëm kundër të afërmit tënd! |
| | | 10. Mos dëshiro asgjë që është e huaj! |

Agjërimi është një ndër karakteristikat themelore të Krishterimit. Ai është heqje dorë nga ushqimi që është me prejardhje shtazore (mish, vezë, qumësht dhe produkte të qumështit). E këtillë është ana trupore e agjërimit, por agjërimi e ka edhe anën shpirtërore: heqje dorë nga mendimet, nga dëshirat dhe veprat e këqija; agjërimi është shtim i lutjeve dhe i kryerjes së veprave të mira.

Lutja është bisedë e njeriut me Zotin. Krishterimi mëson se Zotit mund t'i lutemi çdokund, edhe në shtëpi, edhe në kishë, edhe në rrugë, për shkak se Zoti gjendet gjithkund. Çdo i krishterë duhet të lutet çdo ditë, në mëngjes, në mbrëmje, para- dhe pas buke, para se të ketë filluar- ose pasi të ketë mbaruar me mësimin ose me punën...

Pagëzimi quhet edhe lindje shpirtërore. Me pagëzim bëhesh kalama i Zotit. Këtë sekret të shenjtë e ka institucionalizuar Zoti Jezu Krisht, duke u pagëzuar në lumin Jordan.

Festat e krishtera më të njohura janë Krishlindjet, që kremtohet në nderim të lindjes së Zotit Jezu Krisht dhe Pashkët – kremtohet në nderim të ringjalljes së Krishtit.

ZBULIMI I BOTËS SË RE



Klasa

E SHTATË

Lënda

HISTORI

Tema nga programi
mësimor

**BOTA DHE EVROPA NË
MESJETËN E HERSHME
(TË ZHVILLUAR) DHE TË
VONSHME**

Njësia mësimore

**ZBULIMET E MËDHA
GJEOGRAFIKE**



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:




- ▶ njihet me zbulimet e reja teknike, të cilat i mundësuan zbulimet e mëdha gjeografike;
- ▶ përshkruajë zbulimin e Amerikës;
- ▶ përshkruajë zbulimin e rrugës detare për në Indi dhe udhëtimin e parë rreth botës;
- ▶ kuptojë për rëndësinë e zbulimeve të mëdha gjeografike dhe ndikimin e ndërsjellë të kulturave në kontinentin evropian, aziatik dhe amerikan.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ forcojë qasjen e lirë drejt njohjes së veçorive të kulturave që jetojnë në hapësira të ndryshme dhe kanë karakteristika të ndryshme;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave që nuk gjenden në R. të Maqedonisë, duke i theksuar arritjet prej tyre;
- ▶ zhvillojë shkathtësi për komunikim dhe bashkëpunim, që janë të nevojshme për interaksion me nxënësit nga kulturat tjera;
- ▶ zhvillojë shkathtësitë për njohjen e stereotipeve dhe të paragjytimeve të vetja dhe të tjerët në lidhje me përkatësinë racore, etnike dhe religjioze;
- ▶ zhvillojë shkathtësi për uljen e stereotipeve dhe paragjytimeve për grupet tjera etnike përmes njohjes së vlerave të tyre njerëzore;
- ▶ zhvillojë shkathtësi se si t'ia dalë me sfidat e diskriminimit.

	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Hartë historike – zbulimet e mëdha gjeografike. ▶ Përmbajtje digjitale gjegjëse. ▶ Fletë pune.
	KOHA	Dy orë mësimore prej 40 minutash.
	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	<p>AKTIVITET HYRËS</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përmes pyetjeve të shkurtra i fut nxënësit në njësinë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Mendoni se jeni gjendur në një vend të cilin gjer më atëherë nuk e keni vizituar dhe në të nuk keni të njohur. Si do të ndiheshit? ▶ Çfarë prisni prej njerëzve që do t'i njihni? ▶ Cilin aspekt të kulturës mund ta shohim gjatë takimit të parë me njerëzit? <p>AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mësimdhënësi jep shpjegime hyrëse për shkaqet e zbulimeve të mëdha gjeografike, zbulimin e Amerikës, zbulimin e rrugës detare deri në Indi dhe udhëtimin e parë rreth botës, si dhe për pasojat nga zbulimet e mëdha gjeografike. Me këtë rast shfrytëzon përmbajtje digjitale dhe hartë historike për zbulimet e mëdha gjeografike. Gjithashtu i thekson takimet me kulturat e reja. 2. Si hyrje në aktivitetin që pason, mësimdhënësi shtron pyetje me kuptim të fshehtë, në të cilat nxënësit duhet të japin përgjigje pas hulumtimit në pikën 3. Pyetjet janë të lidhura me historinë e Maqedonisë, por edhe me kohën e zbulimeve të mëdha gjeografike, si për shembull: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Qemal Ataturku a ka pirë kafe? Përse mendoni ashtu? ▶ Krali Marko a ka ngrënë pomfrit? Përse mendoni ashtu? ▶ Sa ka të vërtetë në shprehjen „Pi duhan si turk“? ▶ Turqit e kanë sjellë duhanin në këto hapësira, apo ndokush tjetër? 3. Nxënësit punojnë në çifte dhe bëjnë hulumtim të shkurtër (Fletë pune) për arritjet nga zbulimet e mëdha gjeografike dhe për shkëmbimin e produkteve në të dy kontinentet, duke i shfrytëzuar ueb-lokacionet në vazhdim: <ul style="list-style-type: none"> ▶ https://quizlet.com/25663238/message-creation-flash-cards/ ▶ http://bit.ly/2eFpu64 (Википедија-Големите географски откритија) <p>Qëllimi i hulumtimit është që nxënësit të mësojnë se një numër i madh produktesh dhe diturish që ne sot i shfrytëzojmë nuk kanë qenë të njohura për evropianët para zbulimeve të mëdha gjeografike.</p> 4. Pas marrjes së njohurive nga hulumtimi, nxënësit japin përgjigjet e tyre në pyetjet e fshehta, të shtruara nga mësimdhënësi në hyrje të aktivitetit.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

5. Pason diskutimi, ndërsa mësimitdhënësi i nxit nxënësit që t'i tregojnë qëndrimet e veta në lidhje me pyetjet në vazhdim:
 1. Si ka qenë ndikimi i ndërsjellë i kulturave në kontinentin evropian, aziatik dhe amerikan, si rezultat i zbulimeve të mëdha gjeografike?
 2. Njohja e veçorive të kulturave të tjera sa ndikon në zhvillimin e ndjesisë për respekt, besim dhe empati të njërit ndaj tjetrit?
 3. Interaksioni midis kulturave a kontribuon në uljen e stereotipeve dhe paragjykimëve të ndërsjella?
 4. Si aktivitet përmbyllës, bëhet përpjekje që në mënyrë praktike (nxënësve) t'u tregohen aspektet negative nga zbulimet gjeografike, përkatësisht diskriminimi ndaj popullsisë indigjene në Amerikë pas pushtimeve nga ana e evropianëve.
5. Për këtë qëllim mësimitdhënësi shënon një hapësirë të ngushtë në klasë në formë të drejtkëndëshit, ose të rrethit (varësisht nga madhësia e grupeve dhe e hapësirës së lirë), pastaj i ndan nxënësit në dy grupe të mëdha:
 - ▶ **Grupi i parë** – indigjenët, merr udhëzimin se nuk guxon të dalë nga hapësira e shënuar, nuk guxon të lëvizë, as të flasë.
 - ▶ **Grupi i dytë** – detarët, thirret në skajin tjetër të klasës, fshehtas dhe pa u dëgjuar nga nxënësit e grupit të parë i jepin instruksione që lirisht të lëvizin nëpër klasë, të flasin, të këndojnë, të qeshin dhe verbalisht t'i provokojnë nxënësit nga grupi që qëndron në hapësirën e shënuar.
6. Pas disa minutave, grupet i ndërrojnë vendet dhe rolet.
7. Mësimitdhënësi i pyet nxënësit:
8. Si u ndjetë derisa ishit të kufizuar me hapësirën e ngushtë?
9. Si u ndjetë kur mundët të lëviznit pa kufizim dhe të bëni çka të doni?
10. Çka mendoni, ata që ishin në hapësirën e kufizuar ishin indigjenë, apo detarë?

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Mësimitdhënësi hap diskutim të strukturuar përmes pyetjeve:

1. Cilat ishin nevojat dhe parakushtet për zbulimet e mëdha gjeografike?
2. Sa është ndikimi i zbulimeve të mëdha gjeografike për zhvillimin e sotëm të botës?
3. Cilat janë arritjet për njerëzit nga komunikimi i ndërsjellë, nga përzierja e kulturave dhe shkëmbimi i ideve?
4. Cilat janë pasojat negative nga zbulimet e mëdha gjeografike?
5. Përse ka ardhur deri te pasojat e këtitilla?
6. Cilat të drejta ishin rrezikuar gjatë kohës së globalizimit të botës?
7. Si do të vepronit ju për t'i ulur pasojat negative nga zbulimet e mëdha gjeografike?
8. Në kohën e sotme, si të luftojmë me sfidat e diskriminimit që i imponon shumica ndaj grupeve pakicë?

Formohen çifte me nxënës, të cilat kanë për detyrë që të hulumtojnë dhe të përgatisin dokument në programin OpenOffice Writer, që do t'u shërbejë si bazë për diskutim.

1. Detyra juaj është që t'i shfrytëzoni ueb-lokacionet në vazhdim:
 - ▶ <https://quizlet.com/25663238/message-creation-flash-cards/>
 - ▶ <http://bit.ly/2eFpu64> (Википедија-Големите географски откритија)dhe të përgatitni raport duke shfrytëzuar programin Open Office Writer.
2. Bashkë hulumtoni për:
 - ▶ përfitimet nga zbulimet e mëdha gjeografike që kanë të bëjnë me aspektet pozitive, me njohjen e kulturave dhe të popujve të rinj, të rrugëve të reja, të shkëmbimit të diturive dhe të shkathtësive, të shpërnguljes së popullsisë në botën e re, et.;
 - ▶ shkëmbimin e produkteve të të dy kontinenteve nga aspekti i asaj se cilat produkte evropianët i kanë sjellë nga kontinenti i ri, e cilat i kanë çuar nga vendet e tyre.
3. Pas marrjes së njohurive nga hulumtimi, përpiquni që të jepni përgjigje në pyetjet e fshehta në vazhdim, që janë të lidhura me historinë e Maqedonisë, por edhe me kohën e zbulimeve të mëdha gjeografike, për shembull:
 - ▶ Qemal Ataturku a ka pirë kafe? Përse mendoni ashtu?
 - ▶ Krali Marko a ka ngrënë pomfrit? Përse mendoni ashtu?
 - ▶ Sa ka të vërtetë në shprehjen „Pi duhan si turk“?
 - ▶ Turqit e kanë sjellë duhanin në këto hapësira, apo ndokush tjetër?



TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E FËMIJËVE

16



Klasa

E TETË

Lënda





EDUKIM QYTETARË

Tema nga programi mësimor

NJERIU, TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJERIUT

Njësia mësimore

TË DREJTAT E FËMIJËS

	QËLLIMET E MËSIMIT	Nxënësi/nxënësja të: <ul style="list-style-type: none">▶ kuptojë se të drejtat nënkuptojnë edhe përgjegjësi;▶ mund të shpjegojë se përse të drejtat e fëmijës janë specifike.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	Nxënësi/nxënësja të: <ul style="list-style-type: none">▶ zhvillojë shkathtësi për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në jetën shkollore.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none">▶ Fletë pune.
	KOHA	Dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit përmes shumë ideve theksojnë shembuj të të drejtave të fëmijëve që i njohin.
2. Përgjigjet i shkruajnë në dërrasë të zezë.
3. Prej nxënësve kërkohet që të japin shembuj të respektimit të të drejtave në shkollë dhe në rrethinën e tyre, e pastaj shembuj për shkeljen e të drejtave. Nxënësve u shtrohen pyetje se cilat janë mendimet e tyre në lidhje me shkeljen e të drejtave.
4. Pastaj shtrohet pyetja në vazhdim: „Çfarë masash konkrete ndërmerr shkolla jonë që të respektohen/promovohen të drejtat e fëmijëve?” Po qe se nuk ka përgjigje, nxënësve u shtrohet pyetja: „Çfarë mendoni, çka duhet të ndërmarrë shkolla që të promovohen të drejtat e fëmijës?”

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Në dërrasë të zezë (nxënësit) i shkruajnë 4 të drejtat në vazhdim nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës:
 - ▶ *Sjellje fer dhe mosdiskriminim – neni 2.*
 - ▶ *Mundësi për shprehje të lirë të mendimit – neni 12.*
 - ▶ *Mbrojtje nga dhuna dhe keqpërdorimi – neni 19.*
 - ▶ *Mundësi që të praktikohet kultura, gjuha dhe religjioni – neni 31.*
2. Nxënësve, të cilët janë të ndarë në çifte, u ndahet Fleta e punës, ku çdo e drejtë është shpjeguar në mënyrë të detajuar. Nxënësit i lexojnë dhe bisedojnë për çdo të drejtë të theksuar, që t'i kuptojnë më mirë.
3. Pastaj nga nxënësit kërkohet që të bëjnë vlerësimin e gjendjes në shkollën e tyre, me theksimin e shembujve konkretë se cilat prej këtyre të drejtave respektohen, e cilat nuk respektohen.
4. Secili grup e prezanton vlerësimin e gjendjes së të drejtave në shkollë. Nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Çka e kishit më vështirë në vlerësimin e gjendjes për të drejtat e fëmijës – gjetjen e shembujve të të drejtave që respektohen, apo të të drejtave që thyhen?
 - ▶ Çfarë ndikimi ka thyerja e të drejtave ndaj nxënësve që mësojnë në shkollën tuaj?
 - ▶ Në shkollë a ndërmerren masa kur thyhen të drejtat e fëmijës?
 - ▶ A keni menduar se çka mund të bëni që t'u ndihmoni të gjithë nxënësve që këto të drejta të jenë të plotësuara?
5. Nxënësit vazhdojnë në të njëjtat grupe, ndërsa mësimdhënësi ua lexon skenarin në vazhdim:

Jeni zgjedhur që të përgatisni dokument/broshurë për zbatimin praktik të të drejtave të fëmijës (neni 2, 12, 19 dhe 31) për shkollë krejtësisht të re. Dokumenti/broshura duhet të shërbejë si udhëzues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, që duhet të kontribuojë në krijimin e një klime më të mirë në shkollë. Për çdo të drejtë duhet të theksohen edhe përgjegjësitë (shembull: „Secili ka të drejtë të jetë i trajtuar me respekt” dhe „Secili ka përgjegjësi që të tjerët t'i trajtojë me respekt”). Secili grup vetë vendos për formën e dokumentit/të broshurës.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Në fund duhet të propozoni ide se si duhet ta promovoni dokumentin/ broshurën dhe të jeni të sigurt se të drejtat dhe përgjegjësitë e theksuara do të realizohen/zbatohen në mënyrë praktike në shkollën e re. Pjesa për promovim duhet të jetë pjesë përbërëse e dokumentit.

6. Nxënësit në grupet e tyre punojnë në pjesën e parë të dokumentit/ broshurës sipas skenarit. Me këtë rast mund të shfrytëzojnë ide nga interneti. Mësimdhënësi vazhdimisht e përcjell dhe e udhëzon punën e tyre.
7. Grupet e prezantojnë dokumentin para tërë klasës.
8. Pas prezantimit bëhet lista e përbashkët, e cila i përfshin të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që i prezantuan grupet, kështu që bëhet kombinimi i të drejtave dhe i përgjegjësisë të ngjashme.
9. Nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Si do të dukej jeta në shkollën e re, po qe se këto të drejta nuk do të respektoheshin?
 - ▶ Çka mund të ndërmerrni që me sukses të realizohen këto të drejta dhe përgjegjësi?
10. Nxënësve u jepen kahe që të punojnë në pjesën e dytë të skenarit – Promovim dhe ndërmarrje të aksioneve konkrete për realizim/zbatim me sukses dhe për respektim të të drejtave dhe të përgjegjësisë në shkollën e re (1. Çka duhet të bëhet? 2. Në çfarë mënyre? 3. Kush do të jetë përgjegjës (delegim i përgjegjësisë)? Çfarë mbështetje plotësuese është e nevojshme? Si do të ndiqet se a respektohen të drejtat?).

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nxënësit e prezantojnë pjesën e dytë të skenarit, që ka të bëjë me promovimin dhe ndërmarrjen e aksioneve konkrete.
2. Me nxënësit bisedohet për çështjet në vazhdim:
 - ▶ Çka mësuat të re nga ky aktivitet?
 - ▶ Çka do të thotë që çdo e drejtë e ka edhe përgjegjësinë e vet?
 - ▶ Kush është përgjegjës për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë?
 - ▶ A besoni se vetë nxënësit mund të luftojnë për respektimin më të madh të të drejtave të fëmijëve në shkollat e tyre?
 - ▶ Cilat janë arritjet nga ndërmarrja e përgjegjësisë së nxënësve për praktikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre?
 - ▶ Për çfarë mbështetje kanë nevojë nxënësit në mbrojtjen e të drejtave të tyre?
 - ▶ Përse është i rëndësishëm roli i tyre për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në momentin kur ato janë rrezikuar? (prindër, mësimdhënë, bashkësia lokale, qeveria etj.)

NENI 2 SJELLJE FER DHE MOSDISKRIMINIM

Shtetet anëtare të kësaj Konvente i respektojnë dhe i sigurojnë të drejtat të cilat i përmban Konventa për çdo fëmijë nën juridiksionin e tyre, pa kurrfarë diskriminimi dhe pa marrë parasysh racën, ngjyrën e lëkurës, gjininë, gjuhën, besimin fetar, bindjen politike ose tjetër, prejardhjen nacionale, etnike ose sociale, gjendjen pronësore, mosaftësinë, prejardhjen ose statusin tjetër të fëmijës ose të prindit të tij apo të kujdestarit ligjor.

Shtetet anëtare i ndërmarrin të gjitha masat që të sigurohet mbrojtja e fëmijës nga të gjitha format e diskriminimit ose të dënimit bazuar mbi statusin, aktivitetin, mendimin e shprehur ose bindjen e prindërve, të kujdestarëve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së fëmijës.

NENI 12 MUNDËSI PËR SHPREHJEN E LIRË TË MENDIMIT

Shtetet anëtare i sigurojnë fëmijës, që është i aftë të formojë mendimin e vet, të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të, ashtu që mendimit të fëmijës i kushtohet vëmendja e nevojshme në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.

Për këtë qëllim fëmijës veçmas i jepet rasti që të dëgjohet në të gjitha procedurat gjyqësore dhe administrative që kanë të bëjnë me të ose drejtpërdrejt, ose përmes përfaqësuesit ose organit gjegjë, në mënyrën e cila është në pajtim me të drejtat procedurale të legjislationit nacional.

NENI 19 MBROJTJA NGA DHUNA DHE KEQPËRDORIMI

Shtetet anëtare i ndërmarrin të gjitha masat adekuate legjislative, administrative, sociale dhe arsimore për të mbrojtur fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike ose mentale, lëndimet ose keqpërdorimet, lënia pasdore ose e raporteve të shkujdesura, maltretimit ose eksplotimit, përfshi keqpërdorimin seksual, derisa është nën përkujdesje të prindit, të kujdestarëve ligjorë ose të ndonjë personi tjetër të cilit i është besuar përkujdesja për fëmijën.

Masat e këtilla mbrojtëse duhet të përfshijnë sipas nevojës procedura efikase për hapjen e programeve sociale për sigurimin e mbështetjes, e domosdoshme për fëmijën dhe për ata të cilëve u është besuar përkujdesja për fëmijën, si dhe e formave të tjera të pengimit, përcaktimit, paraqitjes, ndjekjes, hetimit, veprimit dhe përcjelljes së rasteve të maltretimit këtu të theksuar të fëmijës dhe sipas nevojës t'i drejtohen gjyqit.

NENI 31 MUNDËSI QË TË PRAKTIKOHET KULTURA, GJUHA DHE RELIGJIONI





Shtetet anëtare e njohin të drejtën e fëmijës për pushim dhe kohë të lirë për lojë dhe rekreacion, që i përgjigjet moshës së fëmijës dhe për pjesëmarrje të lirë në jetën kulturore dhe në art.

Shtetet anëtare e respektojnë dhe e përparojnë të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje të plotë në jetën kulturore dhe artistike dhe e nxisin dhënien e mundësive gjegjëse dhe të barabarta për aktivitete kulturore, artistike, rekreative dhe të lira.

DITARI – DËSHMITARI I HISTORISË...



Klasa	Lënda	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
E TETË	GJUHË AMËTARE	LLOJET LETRARE DHE SHKENCORE	ANALIZË E FRAGMENTEVE NGA „DITARI I ANA FRANKUT”

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ vërejnë pjesë të jashtme dhe të brendshme të ditarit. ▶ analizojë dhe të interpretojë pjesë nga ditari.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ zhvillojë shkathtësi për njohjen e stereotipeve dhe paragjyqimeve të vetvetja në raport me të tjerët si pjesëtarë të religjioneve, kulturave dhe grupeve etnike të ndryshme; ▶ zhvillojë shkathtësi për uljen e stereotipeve dhe paragjyqimeve për grupet tjera etnike, me këtë rast duke shfrytëzuar shembullin negativ të holokaustit dhe pasojat nga Lufta e Dytë Botërore; ▶ zhvillojë shkathtësi se si t’ia dalë me sfidat e diskriminimit, sidomos në situatën kur ndokujt i rrezikohet jeta dhe dinjiteti.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ „Ditari i Ana Frankut”. ▶ Fletë pune.
	KOHA	Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Përmes pyetjeve të shkurtra mësimdhënësi i fut nxënësit në njësinë mësimore:
 - ▶ A mban ditar ndonjëri prej jush?
 - ▶ Çfarë përmban ditari?
 - ▶ Çfarë ngjarjesh, mendimesh dhe ndjenjash rëndom shkruhen në ditar?
 - ▶ A mund të më thoni se cili është varianti modern i ditarit të shkruar?
 - ▶ A keni dëgjuar ndonjë që të mbajë ditar në internet; për shembull, në formën e bllogut?
 - ▶ Çfarë mendoni, ditari si lloj letrar a mund të shfrytëzohet edhe në shkencë si burim i të dhënave historike ose shkencore?
2. Paralajmërohet aktiviteti përmes të cilit nxënësit do të njihen në mënyrë më të detajuar me përmbajtjen, me strukturën dhe rëndësinë e ditarit si lloj letrar.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE


1. Nxënësit në çifte lexojnë fragment nga „Ditari i Ana Frankut”, me detyrë që t’i vërejnë pjesët e brendshme dhe të jashtme të ditarit si lloj letrar.
2. Mësimdhënësi përpiket që ta zbulojë rëndësinë dhe vlerën e ditarit, përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Çfarë vlere kanë këto lloje letrare?
 - ▶ A e keni ditur se disa prej tyre paraqesin vlerë të madhe historike?
 - ▶ Lexuam një fragment nga „Ditari i Ana Frankut”. A e dini se kur dhe në çfarë rrethanash u krijua ky ditar?
3. Mësimdhënësi i nxjerr të dhënat themelore për ditarin, i cili është krijuar gjatë kohës së holokaustit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.
4. Nxënësit ndahen në 5 grupe. Secili grup bën analizën e tekstit dhe përgjigjet në pyetjet që janë shtruar në Fletën e punës.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Prezantimi organizohet ashtu që secili grup i nxjerr analizat dhe qëndrimet e veta në lidhje me pyetjen e parë dhe bashkë nxirren përfundimet. Pastaj kalohet në pyetjen e dytë dhe mbi bazë të të njëjtit parim analizohen të gjitha pyetjet dhe nxirren përfundimet.
2. Për refleksionin e tërë orës nxënësit i tregojnë përshtypjet e tyre në lidhje me pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Çfarë ndjenjash u paraqitën te ju duke lexuar fragmentin nga „Ditari i Ana Frankut”?
 - ▶ A do të kishit mbajtur ditarin tuaj?
 - ▶ Çfarë mësimi mund të nxirret nga tregimi i vërtetë i Ana Frankut?
 - ▶ Cila është porosia që Ana Franku e dërgon përmes ditarit te moshatarët e vet?



ANA FRANK



DITARI I ANA FRANKUT

Lexoni me kujdes pyetjet dhe jepni përgjigje, me të cilat do të pajtohen pjesa më e madhe e anëtarëve të grupit.

1. Kur dhe ku jeton Ana Franku?
2. Në çfarë atmosfere dhe situatë Ana Franku e shkruan ditarin e vet?
3. Për cilat dukuri negative flet kjo vajzë e vogël, jeta dhe dinjteti i së cilës kanë qenë të rrezikuara në mënyrën më të vrazhdë?
4. Cilat të drejta i janë rrezikuar Ana Frankut?
5. Çka do të kishit bërë ju për të penguar holokaustin dhe vuajtjen e miliona fëmijëve gjatë Luftës së Dytë Botërore?



DIVERSITET DHE EMPATI



Klasa

E TETË

Lënda

GJUHË AMTARE

Tema nga programi
mësimor

SHPREHJE
DHE KRIJIM

Njësia mësimore

RRËFIM PAS
FILLIMIT TË DHËNË



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ dijë që drejt ta përdor gjuhën letrare;
- ▶ rrëfejë sipas fillimit të dhënë dhe të gjejë zgjidhje sipas skenarit të dhënë.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe pranimit të kulturave të tjera;
- ▶ ushtrojë, të tregojë empati dhe të ndërtojë relacione më të mira me të tjerët;
- ▶ bëjë refleksionin e efekteve nga sjellja empatike;
- ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqërinë multikulturore;
- ▶ zhvillojë shkathtësi për njohjen e stereotipeve dhe paragjytimeve të vetvetja dhe të tjerët.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.



KOHA

Dy orë nga 40 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësve u ndahet Fleta e punës 1, me fjalë që tregojnë ndjenjat e këndshme dhe të pakëndshme (mund të jenë të shkruara në dërrasë të zezë ose të tregohen në sllajd).
2. Nxënësit ndahen në çifte dhe prej tyre kërkohet që të kujtojnë përvojat e përjetuara që kanë shkaktuar disa prej ndjenjave që janë theksuar në Fletën e punës 1. Së pari një nxënës çiftit të vet i tregon për përvojën me ndjenja të këndshme, e pastaj nxënësi tjetër e përshkruan përvojën me ndjenjat e pakëndshme të përjetuara, dhe pastaj e kundërta. (Nxënësit mund të nxiten të mendojnë përmes shembujve në vazhdim: E kuptoni që jeni fitues i udhëtimit shpërblyes. Fitoni modelin më të ri të telefonit celular për ditëlindje. Nuk jeni të ftuar në zbatimje. Nuk jeni të zgjedhur në ekipin për garën sportive shkollore.)
3. Pas ushtrimit nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Si ndiheni kur i përshkruani ndjenjat tuaja?
 - ▶ Si ndiheshit kur dëgjonit për ndjenjat e të tjerëve? A mund të viheni në rolin e tyre dhe të mendoni se si janë ndier? Ftohen nxënës që dëshirojnë ta ndajnë përvojën!
 - ▶ A mund ta kujtoni situatën kur keni qenë të lënduar, ndërsa ndonjëri ka treguar mirëkuptim për atë se si jeni ndier?

Nxënësit paralajmërohen se në aktivitetin vijues do të kenë mundësi të luajnë role në të cilat do të ushtrojnë se si t'i kuptojnë ndjenjat e njerëzve të tjerë. Nxënësve u shpjegohet se kur i kuptojmë ndjenjat e njerëzve të tjerë, me këtë tregojmë empati ndaj tyre – kjo do të thotë se vetveten e vëmë në këpucët e tjetrit. Të treguarit e empatisë do të thotë se mendojmë për ndjenjat e njerëzve të tjerë, që ndihmon ta ndryshojmë sjelljen tonë dhe të ndërtojmë relacione të ndërsjella më të mira.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit grupohen në çifte ose në grupe varësisht prej numrit të personazheve në skenarë. Secili grup e merr Fletën e punës 2, ku janë të dhëna udhëzimet për punë, rregullat e luajtjes së roleve dhe skenari me fillimin e ndonjë situatë të caktuar, që nuk është e mbaruar. Nxënësit duhet ta gjejnë FUNDIN e tyre dhe skenarin e përmbyllur ta dramatizojnë përmes luajtjes së roleve.
2. Mësimdhënësi i rikujton nxënësit se së pari duhet t'i lexojnë udhëzimet për punë dhe skenarin nga Fleta e punës dhe të mendojnë se si ta gjejnë zgjidhjen për situatën nga skenari, që duhet të luhet përmes dramatizimit.
3. Nxënësit nxiten që në mënyrë aktive të marrin pjesë në dhënien e ideve në grupet e tyre, nxiten që ndërmjet vete të komunikojnë dhe ta plotësojnë njëri-tjetrin.
4. Puna e nxënësve përcillet dhe sipas nevojës u jepen shpjegime plotësuese për të bërë kreacionin e zgjidhjes dhe për dramatizimin.
5. Pasi që grupi të harmonizohet bashkërisht, ndahen rolet dhe ushtrohet dramatizimi.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

6. Secili grup e interpreton dramatizimin. Më parë lexohen rregullat gjatë luajtjes së roleve.
7. Grupet në rolin e publikut i përcjellin me vëmendje dramatizimet.
8. Pas secilit dramatizim, të gjithë marrin pjesë aktive në diskutim. Së pari grupi që merr pjesë në dramatizim i jep komentet, e pastaj prej grupeve të tjera kërkohet që të japin komente.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim:

1. Si u ndjetë kur treguat për përvojat tuaja të përjetuara që kanë shkaktuar ndjenja të këndshme ose të pakëndshme?
2. Si u ndjetë kur i dëgjuat të tjerët se si tregojnë për përvojat e tyre?
3. Si u ndjetë gjatë interpretimit të roleve?
4. A e kishit të vështirë që të viheni në rolin e personazhit, sjellja e të cilit është e ndryshme prej asaj tuajës?
5. Çka kishit më lehtë, e çka kishit më vështirë gjatë dramatizimit?
6. Interpretimi i roleve a shkaktoi ndonjë ndjenjë te ju për të cilat ishit befasuar?
7. Kur mendoni për ndjenjat e njerëzve të tjerë, a mund ta ndryshoni sjelljen tuaj dhe të ndërtoni relacione më të mira me të tjerët?
8. A mendoni se duke shprehur ngushëllim, mund të ndryshojë njëra prej këtyre sjelljeve: përhapja e zërave, ofendimi, diskriminimi mbi bazë etnike, sjellja e dhunshme ndaj ndonjërit që është i ndryshëm prej jush, bezdisja e të ngjashme dhe përse?



TË KËNDSHME

FAT
KËNAQËSI
DASHURI
GËZIM
KRENARI
BUZËQESHJE
SUKSES
SHPRESË

TË KËNDSHME

ZBAVITJE
TRIMËRI
QETËSIM
GËZIM
BASHKËPUNIM
ENTUZIAZËM
MIQËSI

TË PAKËNDSHME

URREJTJE
FRIKË
HIDHËRIM
VUAJTJE
MLLEF
BRENGË/BRENGOSJE
SHQETËSIM
HABI
OFENDIM
KEQARDHJE

TË PAKËNDSHME

TURP/TURPËRIM
LAKMI
DËSHPËRIM
XHELOZI
FAJ
VETMI
PANIK
VETJAKËSI
PËRJASHTIM
TËRBIM

- ▶ Lexojeni skenarin dhe përpiquni që të jepni ide kreative për ta përfunduar situatën e dhënë në skenarë. Zgjidhja mund të ketë fund pozitiv ose negativ.
- ▶ Përpiquni që t'i kuptoni ndjenjat e personazheve në skenar, që të mund t'i interpretoni rolet sa më mirë. Që të mund sa më mirë t'i kuptoni ndjenjat e të tjerëve, duhet t'i veshni këpucët e tjetrit dhe të pyeteni: „Si do të ndihesha unë në këtë situatë?”
- ▶ Keni 25 – 30 minuta për të përgatitur dramatizimin, për të ndarë rolet dhe për të ushtruar interpretimin e roleve.

RREGULLAT GJATË INTERPRETIMIT TË ROLEVE

- ▶ Secili grup ka 2 minuta për të bërë interpretimin e roleve.
- ▶ Gjatë interpretimit të roleve, pjesëmarrësit në rolet e tyre përpiqen që të jenë sa më të bindshëm.
- ▶ Grupet që janë në rolin e publikut nuk guxojnë të ndërhyjnë gjatë dramatizimit të grupeve të tjera.
- ▶ Secili grup që është në rolin e publikut i përcjell dhe i dëgjon me vëmendje dramatizimet e të tjerëve.
- ▶ Pas secilit dramatizim, të gjithë marrin pjesë në mënyrë aktive në dhënien e informatave kthyesë për to.

SKENARI 1 – STEREOTIPE

Erolli është fëmija i ri i shpërngulur tash shpejt në ndërtesën e re. Shokët nga mëhalla e vjetër e tij i thonë se fëmijët nga ndërtesa e re nuk do të duan të luajnë me të, për shkak se është turk. Erolli fëmijëve të ndërtesës së re u prezantohet si maqedonas, me emrin Emill. Erolli ka frikë se ndonjëri prej fëmijëve do ta zbulojë mashtrimin e tij para prindërve.

PËRFUNDOJENI SE ÇKA NDODH MË TEJ!

SKENARI 2 – MOSPRANIMI I DIVERSITETEVE

Nxënësi 1 është zgjedhur që të punojë në projekt me tre nxënës – nxënësin 2, nxënësin 3 dhe nxënësin 4, të cilët janë me përkatësi të ndryshme etnike prej të tijës.

Nxënësi 1 ndjen se nuk është i mirëseardhur në ekip, idetë që i propozon jo gjithnjë pranohen, e ndonjëherë sikur vëren të përqeshet. Për këtë shkak nxënësi 1 i shmanget shoqërimit me anëtarët tjerë të ekipit dhe kur e thërrasin që të blejnë diçka për të ngrënë, ai nuk don që t'u bashkohet. Mendon të tërhiqet nga projekti.

PËRFUNDOJENI SE ÇKA NDODH MË TEJ!

SKENARI 3 – BEZDISJE DHE PËRQESHJE

Danieli tashmë që një kohë të gjatë e bezdis Petarin, që është një prej nxënësve më të urtë në klasë. Në fillim dukej zbavitëse, por bezdisja nga Danieli po merr dimension gjithnjë e më të madh. Petari bën përpjekje sa është e mundur më shumë që t'i shmanget Danielit, por Danieli assesi të ndalet. Petari gjithnjë e më shumë bëhet i zymtë. Fëmijët tjerë në klasë ende mendojnë se e gjithë kjo është zbavitëse.

PËRFUNDOJENI SE ÇKA NDODH MË TEJ!

SKENARI 4 – STEREOTIPE

Bertani është ftuar në zbavitjen e ditëlindjes të Zorani. Babai i Bertanit nuk i lejon të shkojë, për shkak se mendon se është ftuar jo për shkak se është shok i Zoranit, por vetëm për t'u bërë muzikë në ditëlindje, ku do të ketë vetëm maqedonas. Bertanit i vjen rëndë, për shkak se e di që babai gjithnjë ia mendon të mirën, e në të njëjtën kohë ndjen se Zoranin e ka shok të vërtetë.

PËRFUNDOJENI SE ÇKA NDODH MË TEJ!

SKENARI 5 – DISKRIMINIMI GJINOR

Para orës së klasës, në të cilën do të bisedohet për atë se çka do të bëhet në të ardhmen, Gorjani thotë se qëkur di për vete, gjithnjë ka dashur që të bëhet avokat. Gjyshin e ka pasur avokat, por edhe babain e ka avokat.

Igori ndërlihet se kjo nuk do të thotë se ai patjetër të bëhet shofer, për shkak se babain e ka shofer të kamionëve, i cili me ditë të tëra është nëpër autostrada.

Sashoja tregon se ende nuk ka ide se çka dëshiron të bëhet, por e di me siguri që dëshiron të shkojë në fakultet.

Në fund mbeti Zorani, i cili pasi ngulën këmbë të tjerët, tha se dëshiron të bëhet frizer dhe të ketë sallonin e vet. Të gjithë iu gërvallën menjëherë me komente: Ajo është punë për gra! Ti e di se çka flitet për frizerët burra! Ti luan shumë mirë futboll me ne – thjesht, nuk mund të bëhesh frizer! Ta lëmë ty! Por, vetëm të jesh i vetëdijshëm se çka mund të mendojnë të tjerët për ty!

PËRFUNDOJENI SE ÇKA NDODH MË TEJ!

SI TË ZGJIDHET KONFLIKTI NË MËNYRË PAQËSORE

19



Klasa

E TETË

Lënda

GJUHË AMTARE

Tema nga programi
mësimor

SHPREHJE
DHE KRIJIM

Njësia mësimore

TË FOLURIT E
MËVETËSISHËM NË NJË
TEMË TË DHËNË



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ dijë që drejt ta përdorë gjuhën letrare;
- ▶ mund ta paraqesë qëndrimin e vet personal.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ mësojë shkathtësitë për të analizuar situatat konfliktuozë;
- ▶ bëjë zgjedhjen përkatëse për zgjidhjen paqësore të problemit;
- ▶ praktikojë shkathtësi për komunikim, për zgjidhjen e problemeve.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.



KOHA

Dy orë prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit paralajmërohen se pas përpunimit të romanit „Marta“, vazhdojnë të punojnë në temën konflikte dhe se përmes kësaj teme do të ushtrojnë përdorimin e drejtë të gjuhës letrare dhe dramatizimin përmes interpretimit të roleve sipas skenarëve të dhënë.
2. Prej nxënësve kërkohet që ta ngrenë dorën, po që se kanë marrë pjesë në situata konfliktuozë (për shembull, mospajtime ose rrahje).
3. Përmes shumë ideve jepet përgjigjja për shkaqet e situatave konfliktuozë (për shembull, ofendimi, mbushja e mendjes, zilia, sjellja e dhunshme, bezdisja, shikimi i ndryshëm i gjërave).

Prej nxënësve kërkohet të theksojnë se çfarë ndjenjash shkaktojnë situatat konfliktuozë (për shembull, hidhërimi, lakmia, brengosja, habia, etj.) dhe ato shkruhen në dërrasë të zezë. Nxënësve u shpjegohet se në situatën e mospajtimeve ose të ndonjë situatë konfliktuozë ka mundësi për zgjidhje të ndryshme veprimi dhe reagimi. U shpjegohet se me rëndësi është që të mësojmë të reagojmë në mënyrë gjegjëse në situata konfliktuozë. Kjo ndihmon që të shmangen situatat e pakëndshme ose dhuna, të mbrojmë vetveten, të mësojmë t'i respektojmë të tjerët dhe se me këtë mënyrë e forcojmë ndjenjën pozitive për vete.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit paralajmërohen se do të pasojë aktiviteti i interpretimit të roleve. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secilit grup i jepet Fleta e punës 1, me të katër skenarët.
2. Nxënësve u prezantohet se si do të zhvillohet aktiviteti për interpretimin e roleve dhe u shpjegohen hapat për gjetjen e zgjidhjeve në skenarët e dhënë në Fletën e punës.
3. Prej nxënësve kërkohet që të marrin pjesë, me dhënien e ideve, në grupet e tyre se si të zgjidhen konfliktet e dhëna në skenarë, të mendojnë se cilat do të kishin qenë pasojat nga ato zgjidhje dhe bashkë të arrihet te zgjidhja pozitive/paqësore e tyre.
4. Gjatë punës, nxënësit në grupet e tyre nxiten që të komunikojnë ndërmjet vete, të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë ide.
5. Përcillet puna në grupe dhe po që se është e nevojshme, u jepen udhëzime ose sugjerime plotësuese.
6. Pas përfundimit të detyrës, secili grup interpreton një skenar dhe e prezanton opsionin me zgjidhje paqësore të konfliktit. Më parë e përgatisin skenën sipas skenarit (vihen karrige).
7. Pas çdo interpretimi zhvillohet diskutim për zgjidhjen e interpretuar dhe për pasojat nga zgjidhja.
8. Kërkohet nga grupet tjera që t'i përndajnë shembujt e tyre me zgjidhje pozitive të konflikteve.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nxënësve u ndahet Fleta e punës 2, për të bërë krahasimin e pasojave dhe të zgjidhjes së problemeve të dhëna në Fletën e punës për skenarët 1, 2 dhe 3 me zgjidhjet e interpretuara të tyre. Për skenarin 4 të gjithë bashkë e formulojnë zgjidhjen e problemit.
2. Me nxënësit bisedohet se a e kanë pasur vështirë që të gjejnë zgjidhje pozitive për problemin në skenar dhe si ka rrjedhë procesi i zgjidhjes së problemit në grupin e tyre.
3. Aktiviteti mbaron ashtu që prej nxënësve kërkohet të mendojnë situatën që u ka ndodhur kohë më parë e në të cilën problemi është zgjidhur në mënyrë pozitive dhe paqësore dhe problemi që nuk është zgjidhur në mënyrë pozitive.
4. Pyetni që të propozojnë se si do ta kishin zgjidhur problemin në mënyrë pozitive.
 - ▶ Në skenarë a janë dhënë situatat e realta jetësore?
 - ▶ Çka mësuat për zgjidhjen e konflikteve nga ushtrimi me skenarët?
 - ▶ Pse është e rëndësishme që të analizohen opsionet për zgjidhjen e problemit?
 - ▶ Me cilat sfida u ballafaquat gjatë përcaktimit të pasojave nga opsionet e ofruara për zgjidhje?
 - ▶ Përse është e rëndësishme që situatat konfliktuoze të zgjidhen në mënyrë pozitive dhe paqësore?
 - ▶ Praktikimi i shembujve të skenarëve a ju ndihmoi që t'i përmirësoni shkathtësitë komunikuese?
 - ▶ Në cilat shkathtësi për zgjidhjen e problemeve do të duhej që të punoni ende?



SKENARI 1: „DETYRA E PAKRYER“

Fisniku, Sara dhe Ana punojnë në një projekt të përbashkët, për të cilin duhet të përgatitin prezantimin. Fisniku dhe Ana e kanë me vete pjesën e tyre të përgatitur të detyrës, përveç Sarës, e cila nuk e ka përgatitur pjesën e vet të prezantimit. I tërë grupi mund të marrë notë të dobët për projektin.

SKENARI 2: „KU JANË ATLETET“

Vitani erdhi në shkollë me atlete të reja. Pas orës nga edukata fizike, ai nuk i gjen atletet në sallën e zhveshjes. Shokët i thonë se Kosta ia ka lidhur për koshin e basketit në fushën e sportit. Vitani nuk mund t'i mbërrijë vetë e t'i zbrisë atletet dhe është zemëruar shumë me Kostën.

SKENARI 3 „JU DËGJOVA KUR FLISNI SE NUK MË DONI“

Stefania ka dëgjuar se grupi i vajzave ka bërë shaka rreth asaj se si është veshur sot. Ajo vëren se Lora, e cila edhe më parë e ka bezdisur rreth teshave të saj, është pjesë e atij grupi. Stefanies nuk i vjen mirë dhe ndihet e lënduar.

SKENARI 4: „MENDOVA SE ISHIM MIQ“

Jeta dhe Mirlinda janë shoqe të mira. Ato çdo ditë gjatë kohës së pushimit bashkëshoqërohen dhe ndonjëherë flejnë te njëra-tjetra. Gjatë kohës së pushimeve verore kushërira e jetës – Valbona u shpërngul në qytetin e tyre dhe jeton në shtëpinë e Jetës. Qëkur filloi viti i ri shkollor Jeta dhe kushërira e saj Valbona filluan të shoqëroheshin gjatë kohës së pushimeve dhe Jeta ndërpreu thirrjet për fjetje që ia bënte Mirlindës. Një ditë Mirlinda gjatë kohës së pushimit deshi t'i bashkohej Jetës dhe Valbonës, por ato i ikën. Ditën tjetër gjatë kohës së pushimit Mirlinda përsëri iu afrua dhe i përshëndeti. Këtë herë Jeta dhe Valbona në vend që të ikin, qetë-qetë ia kthyen përshëndetjen.

HAPA PËR GJETJEN E ZGJIDHJES SIPAS SKENARËVE

1. Shihni skenarin, identifikojeni problemin dhe mendoni se si është ndier secili prej personazheve në skenar kur i ka dalë problemi.
2. Bisedoni për zgjidhjet e mundshme të problemit.
3. Shihni opsionin gjatë të cilit incidenti mund të eskalojë dhe të krijojë situatë më të keqe për të gjithë.
4. Mendoni për mënyrat se si do të mund të zgjidhej konflikti në mënyrë paqësore/pozitive dhe të shmangët çfarëdo incidenti.
5. Mendoni se prej kujt do të kishit mundur të kërkonit ndihmë që ta zgjidhni problemin më lehtë (mësimdhënësi, prindi, shoku, ndonjë i rritur tek i cili keni besim).

1. ZGJIDHJA E PROBLEMIT TE SKENARI 1 (detyra e pakryer)

OPSIONI 1 – ZGJIDHJE JOKONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Fisniku dhe Ana e ofendojnë Sarën para tërë paraleles dhe kërkojnë nga mësimdhënësi që ta dënojë.

PASOJA – Sara është e lënduar dhe më nuk don të shkojë në shkollë. Tashmë askush në paralele nuk e pranon Sarën.

OPSIONI 2 – ZGJIDHJE KONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Grupi kërkon shpjegim nga Sara se përse nuk e ka punuar pjesën e vet të punës. Sara shpjegon se ka pasur probleme në familjen e vet. Grupi merret vesh që të kërkojë vazhdimin e afatit për dorëzimin e detyrës, që Sara të mbarojë me pjesën e vet.

PASOJË – e kësaj zgjidhje është që grupi i ndihmon Sarës ta kryejë pjesën e vet të detyrës, që ta prezantojnë bashkë para tërë paraleles.

2. ZGJIDHJA E PROBLEMIT TE SKENARI 2 (ku janë atletet)

OPSIONI 1 – ZGJIDHJA JOKONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Vitani fillon të rrihet me Kostën. Nxënësit tjerë shikojnë dhe bëjnë tifo.

PASOJA – Të dy kanë lëndime fizike dhe qortohen prej drejtorit.

OPSIONI 2 – ZGJIDHJA KONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Nxënësit i thonë Vitanit që të mos merakoset dhe shikojnë te Kosta, duke i kërkuar që t'i zbresë poshtë dhe t'ia kthejë atletet Vitanit dhe t'i kërkojë falje.

PASOJË – e kësaj zgjidhje është se Vitani i merr prapa atletet, merr falje të sinqertë prej Kostës dhe ata dy vazhdojnë të jenë miq.

3. ZGJIDHJA E PROBLEMIT TE SKENARI 3 (problemi i përgojimit dhe i bezdisjes)

OPSIONI 1 – ZGJIDHJA JOKONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Stefania shkon dhe i bërtet grupit për shkak se është e lënduar nga shakatë e tyre, i bie Lorës, ik dhe shpreson se nuk do të ndodhë përsëri.

PASOJË – e kësaj sjellje është të bëhet rrahje edhe më e madhe dhe ndonjëra prej tyre të lëndohet. Lora vazhdon edhe më tej ta bezdis, ndërsa Stefania vazhdon të jetë e zymtë dhe të mos ndihet mirë.

OPSIONI 2 – ZGJIDHJA KONSTRUKTIVE E PROBLEMIT – Stefania i afrohet grupit, u thotë vajzave se komentet e tyre kanë bërë që mos të ndihet mirë. Po që se Stefania nuk mund ta bëjë këtë, kërkon ndihmë nga mësimitdhënësi.

PASOJË – e kësaj është që Lora dhe grupi i kërkojnë falje Stefanies. Lora dhe grupi më nuk e bezdisin Stefanien.

Për **SKENARIN 4** përpuni që të gjeni zgjidhje mbi bazë të përvojës nga tre skenarët e mëparshëm.

KËNGË POPULLORE TË DASHURISË

20



Klasa

E TETË

Lënda

ARSIM
MUZIKOR

Tema nga programi
mësimor

DËGJIM I MUZIKËS

Njësia mësimore

DËGJIMI I VEPRAVE
MUZIKORE VOKALE-
INSTRUMENTALE TË
AUTORËVE TË VENDIT



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë aftësinë për dëgjimin e plotë të veprës muzikore;
- ▶ thellojë njohuritë për elementet dhe karakteristikat e muzikës popullore.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë aftësinë për detektimin e instrumenteve dhe për njohjen e të rejave, karakteristike për bashkësitë në Maqedoni (fyelli, sazet, tamburaja, qestet, uti, lahuta);
- ▶ bëjë për vete këngë me linjë të llojllojshme të melodisë, të ndryshme për nga karakteri dhe përmbajtja, për nga veshi, që janë karakteristike për bashkësitë që jetojnë në Maqedoni;
- ▶ zhvillojë ndjesinë për të vlerësuar kulturën e vet dhe të ndërtojë identitetin kulturor pozitiv;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave nga rrethina e drejtpërdrejtë.



RESURSE

- ▶ Kompjuter dhe internet.



KOHA

Një orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Ora fillon me diskutimin ndërmjet nxënësve rreth asaj se cila është kënga e pëlqyer e dashurisë për ta dhe pse.
2. Pastaj mësimdhënësi i pyet se a e dinë se cili instrument e shoqëron këngën e tyre të dashur.
3. Vijnë pyetjet rreth asaj se nxënësit a kanë dëgjuar ndonjë këngë popullore të ngjashme të dashurisë nga bashkësitë në Maqedoni dhe a e dinë se cilat instrumente janë karakteristike për secilën bashkësi veç e veç.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit punojnë të ndarë në shtatë grupe.
2. Secili grup e ka për detyrë që të gjejë këngë popullore të dashurisë nga bashkësitë që jetojnë në R. të Maqedonisë (shqiptare, vllehe, serbe, turke, rome, maqedonase dhe boshnjake).
3. Të gjitha grupet i marrin instruksionet e njëjta – duhet ta dëgjojnë këngën, të gjejnë përkthimin më të përafërt, që të mund t'i kënaqen për nga aspekti përmbajtësor, të njohin ritmin dhe instrumentet që e krijojnë melosin.
4. Gjithashtu, nxënësit duhet t'i njohin instrumentet dominante dhe të definojnë se cili element (teksti, ritmi, instrumenti) më së miri i kap ndjenjat në këngë.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Lideri i grupit e prezanton punën e grupit të vet. Gjatë prezantimit, nxënësit duhet të fokusohen tek ngjashmëritë dhe dallimet që paraqiten te secila bashkësi kur këndojnë për ndjenjën e përgjithshme të dashurisë.
2. Fillon diskutimi në lidhje me pyetjet:
 - ▶ Çfarë mësuat për karakteristikat e muzikës popullore dhe muzikën e kulturave të tjera në Maqedoni?
 - ▶ Cilat janë elementet karakteristike të secilës prej tyre?
 - ▶ Cili është ritmi specifik për secilën bashkësi?
 - ▶ Cilat instrumente theksohen si specifike për to?



KULTURA TË NDRYSHME DHE PASURIA E TYRE



Klasa

E TETË

Lënda

PROJEKTE NGA
INFORMATIKA

Tema nga programi
mësimor

PROGRAM PËR
PREZANTIME
MULTIMEDIALE

Njësia mësimore

PËRGATITJA E
PREZANTIMIT PËR NJË
TEMË TË CAKTUAR



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ aftësohet që në mënyrë të mëvetësishme të bëjë kreacionin e prezantimit në një temë të dhënë;
- ▶ bëjë kërkimin e informatave të nevojshme në internet;
- ▶ bëjë memorizimin e informatave të nevojshme në folderin e vet elektronik;
- ▶ vë informatat e gjetura në sllajd dhe t'i rregullojë sllajdet;
- ▶ shtojë efekte prezantimit;
- ▶ paraqet kreacionin e prezantimit multimedial.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ thellojë njohuritë për aspektet kulturore themelore dhe për karakteristikat e kulturave të ndryshme;
- ▶ kuptojë se diversiteti i kulturave është një gjë pozitive;
- ▶ interpretojë aspektet kulturore dhe ta shohë tërësinë e të gjitha aspekteve në një shoqëri.



RESURSE

- ▶ Kompjuter.
- ▶ Aplikacioni Impress.
- ▶ LCD-projektor.
- ▶ Internet.
- ▶ Fletë pune.



KOHA

Dy orë mësimore nga 40 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Mësimdhënësi nxit diskutim për programet që mundësojnë prezantime multimediale. Shfrytëzohet përvoja e nxënësve me PowerPoint dhe bëhet krahasimi me Impress. Një kohësisht, mësimdhënësi i nxit nxënësit të mendojnë për mundësitë që i ofrojnë këto programe dhe për zbatimin e tyre për qëllime të ndryshme.
2. Paralajmërohet aktiviteti i orës, me atë që nxënësve u bëhet me dije se në këtë rast do të përpiqen që programin për prezantime multimediale ta përdorin për t'u njohur më thellësisht me kulturat e ndryshme që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.
3. Duke shfrytëzuar metodën Web quest, mësimdhënësi i motivon nxënësit për temën në të cilën do të përgatitet prezantimi, përmes hyrjes në vazhdim:
 - ▶ „Gjatë muajit të ardhshëm është paraparë një vizitë e nxënësve prej një shteti tjetër, me të cilët do të flitet në temën e arsimit multikulturor. Ata nuk janë të njohur me kulturat e ndryshme që jetojnë në Maqedoni, si dhe me bashkëjetesën e tyre në këto hapësira. Prandaj, do t'ju kisha lutur që të më ndihmoni që të paraqitemi në një dritë sa më të mirë.“

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësve u thuhet se do të punojnë në detyrën në të cilën roli i tyre është që t'i gjejnë të dhënat e nevojshme të folderit elektronik më parë të përgatitur nga ana e mësimdhënësit (që tashmë është shpërndarë në kompjuterat e nxënësve) dhe mbi bazë të kreacionit dhe imagjinatës së tyre të bëjnë kreacionin e prezantimit multimedial që do ta paraqesin para nxënësve të tjerë.
2. Nxënësit ndahen në pesë grupe dhe u jepet Fleta e punës, me instruksione të detajuara se si të punohet detyra.
3. Nxënësve u thuhet se të gjitha grupet hulumtojnë për njërin prej karakteristikave kulturore të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, romëve, serbëve, boshnjakëve dhe vlllehëve, edhe atë:
 - ▶ **grupi i parë** hulumton për gjuhët që përdorin dhe për aspektet e përbashkëta nga ndikimi i ndërsjellë gjatë komunikimit shumëvjeçar në këto hapësira;
 - ▶ **grupi i dytë** hulumton për religjionet që janë të pranishme te shtatë bashkësitë e përmendura etnike dhe bën krahasimin ndërmjet tyre;
 - ▶ **grupi i tretë** hulumton për ushqimin tradicional, ashtu që i ndan ushqimet e përbashkëta që përgatiten te të gjitha bashkësitë etnike;
 - ▶ **grupi i katërt** hulumton për festat kombëtare dhe me këtë rast i veçon ato që janë të përbashkëta, që lidhen me përkatësinë ndaj R. së Maqedonisë;
 - ▶ **grupi i pestë** hulumton për personalitetet e njohura nga këto bashkësi etnike, që janë të rëndësishme për historinë tonë të përbashkët.
4. Karakteristikat kulturore mund të paraqiten me fjalë, me fotografi ose me simbole, të cilat gjithashtu kërkohen në internet.
5. Përveç paraqitjes grafike dhe vizive të aspekteve të ktheksuara në sllajdet në prezantim, për secilin aspekt nxënësit përgatisin tekst të shkurtër, ku jepen karakteristikat kryesore për atë aspekt (paraqitja grafike kthehet në fjalë).
6. Nxënësit punojnë në rregullimin final të sllajdeve dhe shtojnë efekte.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Grupet i prezantojnë punimet e tyre.
2. Me nxënësit bisedohet për:
 - ▶ kualitetin dhe kracionin e disenjit të prezantimit nga aspekti teknik;
 - ▶ pjesën përmbajtësore, që ka të bëjë me aspektet kulturore (a ka numër të mjaftueshëm informacionesh për aspektet e kërkuara dhe për kreacionin gjatë përshkrimit të kulturave dhe interaksionit të tyre).
3. Bëhet refleksioni përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Çka kishit më sfiduese gjatë disenjimit të prezantimit nga aspekti teknik? Cilat vegla të reja i përdorët?
 - ▶ Përse është e rëndësishme që të respektohen vlerat e kulturës së vet?
 - ▶ Përse është e rëndësishme që të respektohen vlerat e kulturave të tjera?
 - ▶ Cilat janë gjërat pozitive që dalin nga diversiteti i kulturave?
 - ▶ Cilat janë arritjet për një shoqëri nga interaksioni i ndërsjellë i kulturave në të?







Shfrytëzoni udhëzimet në vazhdim, të cilat do t'ju ndihmojnë gjatë kreacionit të prezantimit multimedial që do të bëni:

1. Roli juaj është që t'i gjeni të dhënat e nevojshme në folderin elektronik më parë të përgatitur nga ana e mësimdhënësit (që është shpërndarë në kompjuterët tuaj), të hulumtoni në lokacionet e theksuara dhe mbi bazë të kreacionit dhe imagjinatës suaj të bëni kreacionin e prezantimit multimedial, të cilin do ta prezantoni para bashkënxënësve të tjerë.
2. Karakteristikat kulturore mund t'i paraqitni me fjalë, me fotografi ose me simbole, të cilat po ashtu do t'i kërkonin nga interneti.
3. Përveç paraqitjes grafike dhe vizive të aspekteve të theksuara në sllajdet e prezantimit, për secilin aspekt përgatisni tekst të shkurtër, tek i cili do t'i jepni karakteristikat kryesore të atij aspekti (paraqitja grafike kthehet në fjalë).
4. Për të bërë kreacionin e prezantimeve punoni në pesë grupe, sipas kaheve në vazhdim: hulumtoni për karakteristikat kulturore të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, romëve, serbëve, boshnjakëve dhe vlllehëve, me ç'rast:
 - ▶ **grupi i parë** hulumton për gjuhët që i shfrytëzojnë dhe për aspektet e përbashkëta nga ndikimi i ndërsjellë në komunikimin shumëvjeçar në këto hapësira;
 - ▶ **grupi i dytë** hulumton për religjionet që janë të pranishme te shtatë bashkësitë etnike të përmendura dhe bën krahasimin ndërmjet tyre;
 - ▶ **grupi i tretë** hulumton për ushqimin tradicional, duke ndarë ushqimet e përbashkëta që përgatiten nga të gjitha bashkësitë etnike;
 - ▶ **grupi i katërt** hulumton për festat kombëtare dhe me këtë rast i veçon ato që janë të përbashkëta, që lidhen me përkatësinë ndaj R. së Maqedonisë;
 - ▶ **grupi i pestë** hulumton për personalitete të njohura nga këto bashkësi etnike, të cilat janë të rëndësishme për historinë tonë të përbashkët.
5. Ruani informatat e gjetura në folderin tuaj elektronik! Pasi t'i keni analizuar, selektoni informatat e nevojshme dhe gjithë atë vendoseni në sllajdet në prezantim! Sugjerime të reja, me të dhëna nga faqet e internetit, të ndryshme nga ato që janë ofruar, janë të mirëseardhura!
6. Rregullojeni më tej prezantimin në kuptim të ujdísjes së sllajdeve dhe të shtimit të efekteve!
7. Secili grup do t'i prezantojë informatat e veta, pas së cilës pritet diskutimi prej grupeve të tjera jo vetëm në pikëpamje të kualitetit të kreacionit të prezantuar nga aspekti teknik, por edhe në pikëpamje të përmbajtjes së tij (nxënësit a kanë vënë informata të mjaftueshme, a janë përfshirë aspektet e kërkuara, çka kanë mësuar për kulturat e ndryshme në Maqedoni, e të ngjashme).

A ËSHTË KY KONFLIKT?



Klasa	Lënda	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
E NËNTË	EDUKIM QYTETARË	KONFLIKTI	Ç'ËSHTË KONFLIKTI, SHKAQET E LINDJES SË KONFLIKTEVE

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ dijë se çka është konflikti dhe si krijohet; ▶ njohë pasojat e mundshme të konfliktit; ▶ identifikojë situatat konfliktuozë në jetën e përditshme.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ thellojë njohuritë për shkaqet që kontribuojnë në krijimin e konflikteve; ▶ njihet me parimet për zgjidhjen e konflikteve dhe të mësojë për shkathtësitë e analizimit të situatave konfliktuozë; ▶ zhvillojë shkathtësitë për të analizuar situatat konfliktuozë.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Letër. ▶ A4. ▶ Fletë pune.
	KOHA	Një orë mësimor prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit ndahen në katër ose pesë grupe me nga gjashtë nxënës, varësisht se sa e madhe është klasa.
2. Secilit grup i jepet nga një ekzemplar i Fletës së punës 1, ku janë të vizatuara gjashtë rrethe të zbrazëta dhe një në mes, në të cilin shkruan konflikt. Ata kanë për detyrë që në çdo rreth të shkruajnë nga një fjalë (asociacion) se si ata e kuptojnë fjalën konflikt.
3. Secili grup i prezanton rezultatet e veta.
4. Zhvillohet bisedë me nxënësit për prezantimet e tyre dhe me këtë rast nxirren këto përfundime:
 - ▶ Konfliktet mund të jenë më të vogla, siç janë mospajtimet, më të mëdha, siç janë qortimet dhe rrahjet dhe më të mëdha, siç janë luftërat.
 - ▶ Deri në konflikte arrihet gjithkund ku njerëzit jetojnë, punojnë, luajnë bashkë.
 - ▶ Konfliktet janë pjesë e pashmangshme e jetës sonë.
 - ▶ Në çdo konflikt së paku ka dy palë – secila mendon se ajo është në të drejtë, e tjetra jo.
 - ▶ Lëndimet mund të jenë jo vetëm të jashtme, por edhe të brendshme (mund të lëndohen ndjenjat dhe dinjiteti).

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE


1. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në të njëjtat grupe. Ata kanë për detyrë që t'i japin fund fjalisë: „Konflikti është...”, përkatësisht secili grup duhet të mendojë definicionin për kuptimin e fjalës konflikt, duke i shfrytëzuar kuptimet që i kanë shkruar në të gjashtë rrethet e zbrazëta nga Fleta e punës 1. Secili grup e përndan definicionin e vet me nxënësit tjerë.
2. Diskutohet rreth asaj se cili definicion për konfliktin është më i qartë dhe më preciz.
3. Kjo shërben si bazë për të përpiluar një definicion për konfliktin, me të cilin pajtohen të gjithë nxënësit.
4. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në të njëjtat grupe edhe në detyrën vijuese.
5. Grupet marrin nga një ekzemplar nga Fleta e punës 2, ku janë të theksuara tri situata të ndryshme.
6. Nxënësit kanë për detyrë që t'i analizojnë situatat mbi bazë të definicionit mbi konfliktin, të miratuar bashkërisht dhe për secilën situatë veç e veç të vlerësojnë se a është fjala për konflikt ose jo. Po që se është fjala për konflikt, ata duhet të japin idenë për zgjidhjen prej tyre të situatës konfliktuoze.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Prezantimi zhvillohet situatë pas situatë. Një nxënës, që paraqitet vullnetarisht, e lexon situatën konkrete e pastaj nga secili grup prezantuesi i përndan qëndrimet e grupit dhe zgjidhjet konkrete të situatës për të cilën bëhet fjalë. Po qe se grupet kanë qëndrime të paharmonizuara për ndonjërin prej tri situatave, diskutohet që të arrihet deri te zgjidhja e vërtetë e situatës.
2. Pas prezantimit hapet diskutim, për të kontrolluar arritjet e qëllimit të orës:
 - ▶ Çfarë pamje keni kur ndokush do ta përmend nocionin konflikt?
 - ▶ Tregoni ndonjë ngjashmëri, të cilat shtrihen në bazën e tipave të ndryshëm të konfliktit!
 - ▶ Cilat janë shkaqet e krijimit të konflikteve?
 - ▶ Konfliktet a i ndihmojnë apo i pengojnë njerëzit? Përse?
 - ▶ A ndiheni të aftësuar për të analizuar situatat konfliktuoze dhe për zgjidhjen e tyre konstruktive?





Në kuadër të grupit që i takoni lexoni tri situatat në vazhdim.

Analizoni situatat në lidhje me karakteristikat e konfliktit dhe jepni vlerësimin për çdo situatë veç e veç, se a bëhet fjalë për konflikt ose jo.

Për situatat që do t'i përcaktoni si konfliktuoze, ofroni zgjidhje konkrete.

1. Jovana, Aldini dhe Xhemilja gjithnjë bisedojnë në orën e historisë. Pëshpërisin dhe shkruajnë porosi. Një ditë mësimdhënësi i lëndës u hidhërua, filloi t'u bërtasë dhe i dëboi prej orës. Ai i dënoi – një muaj për çdo ditë patjetër ta fshijnë dërrasën e zezë.
2. Dejani dhe Shabani janë shokë të mire. Javën e kaluar të dy iu nënshtruan testit nga biologjia dhe morën nota solide. Dejani mendon se Shabani mori notë të mirë për shkak se është nxënës i pëlqyer nga mësimdhënësjja. Shabani thotë se ka mësuar dhe se me nder e ka merituar notën. Tani që të dy bëjnë debat dhe i bërtasin njëri-tjetrit.
3. Besniku e do shumë radioprogramin e natës. Ai pikërisht tani emetohet dhe ai don që ta dëgjojë. Por, nëna konsideron se Besniku duhet të flejë. E urdhëron që ta fik radion, ndërsa Besniku refuzon. Nëna i hidhërohet shumë, e fik radion dhe ia ndalon Besnikut që të dëgjojë radio gjatë kohës së uikendit.

PUNIM GAZETARESK PËR BASHKËSITË KULTURORE

23



Klasa

E NËNTË

Lënda

GJUHË
AMTARE

Tema nga programi
mësimor

SHPREHJE DHE KRIJIM –
SHPREHJE ME GOJË
DHE ME SHKRIM

Njësia mësimore

RAPORTIMI:
PUNIM GAZETARESK



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ mund të tregojë ngjarje, dukuri, probleme nga përditshmëria;
- ▶ marrë qëndrim dhe ta shpreh qëndrimin e vet për çështje të caktuara nga përditshmëria.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ shpjegojë për pasurinë kulturore të familjes së vet;
- ▶ shpjegojë se cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet pasurive kulturore të familjeve nga grupe të ndryshme etnike;
- ▶ rrit vetëdijen për vlerat e kulturës së vet dhe për vlerat e kulturave të ndryshme;
- ▶ dallojë nevojën e paraqitjes dhe të respektimit të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.
- ▶ Fotografi shtëpish nga rajone të ndryshme në Republikën e Maqedonisë (Shtojca).
- ▶ Interneti.



KOHA

Dy orë mësimore prej 40 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Nxënësit në çifte tregojnë për familjet e tyre sipas pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Cilët anëtarë e përbëjnë familjen tënde – prindërit, gjyshet, gjyshërit, paraardhësit (si quhen, ku kanë lindur)?
 - ▶ Cila është prejardhja kulturore e familjes tënde (gjuha në të cilën flet, përkatësia etnike)?
 - ▶ Cilat festa festohen?
 - ▶ Cila traditë respektohet në familjen tënde?
 - ▶ Cilat janë momentet më të dashura në familjen tënde?
2. Prej nxënësve kërkohet që në mënyrë individuale ta bëjnë listën e gjërave për të cilat janë të sigurt se janë të përbashkëta me familjet tjera, pa marrë parasysh se cilave kultura iu takon dhe listën e gjërave për të cilat konsideron se familjet e tyre i bën më të veçanta dhe më të ndryshme prej familjeve të tjera.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit paralajmërohen se do të hulumtojnë për kulturat e familjeve nga bashkësi të ndryshme etnike që jetojnë në R. e Maqedonisë. Nxënësit ndahen në grupe më të vogla dhe prej tyre kërkohet që të bëjnë tërheqjen e një fotografie nga shtëpia familjare. Për këtë qëllim mësimdhënësi përgatit fotografi nga dhjetëra shtëpi, të cilat përfaqësojnë jetën e ndërtuar sipas standardit të njëjtë. Pastaj secili grup tërheq fletëzën ku është shënuar përkatësia etnike e familjes për të cilën duhet hulumtuar (te shtëpia janë shënuar fletëza me familjet në vazhdim: maqedonase, shqiptare, boshnjake, turke, rome, serbe, vllahe). Nxënësve u shpjegohet se duhet ta mendojnë familjen nga bashkësia etnike që kanë tërhequr, se ajo jeton në shtëpinë nga fotografia e tyre. *(Mësimdhënësi përpunon që secili grup të punojë në fotografinë me shtëpi në të cilën jeton familja me përkatësi tjetër etnike/kulturore nga ç'kanë ata.)*
2. Nxënësit bashkë në grup, duke shfrytëzuar internetin, hulumtojnë për kulturën që e kanë tërhequr. Pas hulumtimit dhe diskutimit të ndërsjellë për të dhënat e tubuara, nxënësve u jepen udhëzime që secili në mënyrë individuale të bëjë raportin/reportazhin gazetaresk për familjen nga shtëpia në fotografi mbi bazë të të dhënave të tubuara dhe pyetjeve nga Fleta e punës dhe të përfshijnë ndodhi me interes për familjen.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Pas leximit të disa raportimeve gazetareske, me nxënësit bisedohet për këto pyetje:

1. Çka mësuat nga aktivitetet në këtë temë?
2. Në cilat pyetje e kishit më lehtë të përgjigjeni, e në cilat më vështirë?
3. Cila ishte befasia më e madhe gjatë hulumtimit në internet për jetën e bashkësisë kulturore nga fotografia që punuat?
4. Cilat ngjashmëri ose dallime i zbuluat midis familjes tuaj dhe familjes nga fotografia?
5. Si mund t'i zhvillonit vlerat e kulturës suaj dhe t'i respektoni kulturat tjera?

FAMILJE MAQEDONASE

FAMILJE SHQIPTARE

FAMILJE BOSHNJAKE

FAMILJE TURKE

FAMILJE ROME

FAMILJE SERBE

FAMILJE VLLAHE

Hulumtoni në internet për bashkësinë kulturore së cilës i takon shtëpia nga fotografia e tërhequr nga grupi juaj. Mendoni se dritaret e shtëpisë nga fotografia janë të hapura dhe mund ta shikoni familjen që jeton në të. Përpiquni që bashkë në grup të jepni përgjigjet në pyetjet në vazhdim:

1. Sa anëtarë numëron familja që jeton në këtë shtëpi?
2. Cilët janë anëtarët e familjes?
3. Në cilën gjuhë flasin?
4. Theksoni se çka punon secili prej tyre?
5. Cilës kulturë/cilit grup etnik i takon familja?
6. Cilat janë traditat dhe zakonet e tyre kryesore?
7. Cilat festa janë të rëndësishme për këtë familje dhe si festohen?
8. Si vishen?
9. Cilat lojëra i luajnë fëmijët?
10. Sa është mikpritëse kjo familje? Si e shpreh mikpritjen kjo familje?
11. Cilat janë gjërat më të dashura që bëhen në këtë familje?

Mbi bazë të përgjigjeve në pyetjet, secili në mënyrë individuale duhet të bëjë shënimin gazetaresk për familjen e menduar nga shtëpia në fotografi, duke i shfrytëzuar përgjigjet e pyetjeve të theksuara më lart. Në shënim përfshini edhe ndonjë ndodhi interesante për familjen.



ALL READY AND PACKED



Klasa

E NËNTË

Lënda

GJUHË
ANGLEZE

Tema nga programi
mësimor

ALL READY
AND PACKED

Njësia mësimore

SI TË SHKRUHET
KARTOLINA



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ pasurojë fjalorin;
- ▶ mësojë të analizojë, të selektojë dhe të prezantojë të dhënat;
- ▶ sensibilizoj për gjetjen e ngjashmërive dhe të dallimeve kulturologjike



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ zhvillojë qasjen e lirë për njohjen e veçorive të kulturave të ndryshme;
- ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.
- ▶ Faqe të internetit të treguara nga ana e mësimdhënësit.
- ▶ Kompjuter.
- ▶ LCD-projektor.
- ▶ Kompjuterat e nxënësve, lidhje stabile të internetit.



KOHA

Një deri në dy orë mësimore nga 40 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me prezantimin e metodës webquest, të dhënë në Fletën e punës 1 kushtuar të gjitha grupeve. Me këtë rast mësuesi shpjegon se për të punuar detyrën që pason do të mblidhen informata vetëm nga interneti. Pastaj nxënësve ua shtron pyetjet në vazhdim:
 - ▶ A do të kishit dashur që të jeni pjesë e ndonjë aventure interesante udhëtimi?
 - ▶ A dëshironi ta ndjeni magjinë e së resë, së panjohurës, së ndryshmes?
 - ▶ A mund ta mendoni në këtë orë se i vizitohet shtetet si: Shqipëri, Turqi, Serbi, Bosnjë e Hercegovinë?
2. Paralajmërohet se nxënësit do të hulumtojnë për katër shtetet e përmendura më parë dhe pastaj u jepet Fleta e punës 1 për webquest dhe u tregohen udhëzimet për punë.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup duhet të punojë kartolinën në formë elektronike, edhe atë:
 - ▶ grupi i parë nga Shqipëria;
 - ▶ grupi i parë nga Turqia;
 - ▶ grupi i parë nga Serbia;
 - ▶ grupi i parë nga Bosnja dhe Hercegovina.
2. Nxënësit duhet të hulumtojnë në internet dhe duhet të japin përshkrimin adekuat (fotografi, tekste) për karakteristikat vijuese të shtetit për të cilin e bëjnë hulumtimin:
 - ▶ vendet që janë me interes dhe të rëndësishme,
 - ▶ popullin,
 - ▶ zakonet,
 - ▶ ushqimin,
 - ▶ gjuhën dhe religjionin,
 - ▶ gjëra të tjera me interes për vendin.
3. Secili grup bën hulumtim në internet për të gjitha karakteristikat e theksuara më lart dhe me këtë rast përgatit tekste dhe fotografi gjegjëse.
4. Nxënësit në grupet e tyre i analizojnë dhe i selektojnë të dhënat e tubuara dhe i hynë punës të punojnë kartolinën duke përdorur programin Openoffice Writer.
5. Mësuesi e përcjell punën e nxënësve dhe po qe se ka nevojë, u ndihmon.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Secili grup e prezanton kartolinën e vet. Të gjitha grupet marrin nga një ekzemplar nga Fleta e punës 2 – Tabela për ngjashmëritë.
2. Derisa njëri grup e bën prezantimin, grupet tjera e plotësojnë Tabelën sipas udhëzimeve të dhëna në Fletën e punës
3. Pas secilit prezantim, nxënësve të grupeve të tjera u jepet mundësia t'i shtrojnë pyetje grupit që bën prezantimin.
4. Pas mbarimit të të gjitha prezantimeve dhe kompletimit të Tabelës, me nxënësit bisedohet për çështjet në vazhdim:
 - ▶ Cilat fjalë të reja i mësuat?
 - ▶ Cilin prej këtyre shteteve tashmë e keni vizituar?
 - ▶ Çka mendoni, pse vendosëm që pikërisht këto shtete t'i „vizitojmë“?
 - ▶ Çka kanë të përbashkët këto katër shtete, e çka kanë të ndryshme? (Nga një përfaqësues i secilit grup i numëron ngjashmëritë e identifikuar.)
 - ▶ A patjetër t'i vizitojmë këto vende për t'u njohur drejtpërdrejt me pjesëtarët e këtyre popujve?



Formohen katër grupe në paralele, të cilat përmes shortit marrin detyrë që të hulumtojnë dhe të përgatisin prezantimin në programin OpenOffice Writer për njërin prej katër vendeve: Shqipëri, Turqi, Serbi, Bosnjë e Hercegovinë.

DETYRË PËR NXËNËSIT

1. Detyra juaj është që përmes përgatitjes së prezantimit në programin OpenOffice Writer, që duhet të jetë në llojin e kartolinës, adresuar sipas dëshirës suaj, t'i bartni përshtypjet tuaja nga vendi të cilin në rrugë imagjinare do ta vizitoni (emri i vendit: _____).
2. Bashkë hulumtoni për:
 - ▶ vendet që u kanë lënë pa frymë,
 - ▶ popullin,
 - ▶ zakonet,
 - ▶ ushqimin,
 - ▶ gjuhën dhe religjionin
 - ▶ gjërat tjera me interes për vendin.
3. Përgatitni tekst dhe fotografi për karakteristikat e theksuara më lart.
4. Bashkë në grup analizoni fotografitë dhe tekstet e përgatitura dhe zgjidhni ato të cilat më së miri do ta paraqesin vendin në kartolinën tuaj. Përpiquni që kartolina të jetë sa më interesante dhe sa më tërheqëse.
5. Prezantoheni kartolinën tuaj para tërë klasës dhe diskutoni për kartolinën tuaj dhe për kartolinat e grupeve të tjera.
6. Derisa i përcillni prezantimet nga grupet tjera, shfrytëzoni Tabelën 1 – Ngjashmëri, në të cilën do t'i shënoni ngjashmëritë e vendit që hulumtuat me vendet e grupeve të tjera.

RESURSE

Këto janë linqet të cilat mund t'i shfrytëzoni për prezantimin tuaj, por gjithashtu, mund të shfrytëzoni edhe linqe të tjera sipas zgjedhjes suaj:

Grupi 1 – Shqipëria

<http://www.tripadvisor.com/Tourism-g294445-Albania-Vacations.html>

Grupi 2 – Turqia

<http://www.tripadvisor.com/Tourism-g293969-Turkey-Vacations.html>

Grupi 3 – Serbia

<http://www.tripadvisor.com/Tourism-g294471-Serbia-Vacations.html>

Grupi 4 – Bosnjë dhe Hercegovina


http://www.tripadvisor.com/Tourism-g294449-Bosnia_and_Herzegovina-Vacations.html

TABLE – SIMILARITIES

During other groups presentations', please write down the identified similarities between the characteristics of the country which you've explored and the countries explored by the other groups.

		ALBANIA	TURKEY	SERBIA	BOSNIA AND HERZEGOVINA
1	Breathtaking places				
2	People				
3	Customs				
4	Food				
5	Language and Religion				
6	Other interesting things about the country				

**SHEMBUJ
PËR MËSIM
MULTIKULTUROR
NË ARSIMIN
E MËSËM**

A stylized, light green graphic in the background depicts two hands, one from the left and one from the right, cupping a globe. The hands are represented by simple, rounded shapes, and the globe is a circle with a horizontal line through its center. The entire graphic is rendered in a light green color that matches the background.

„JO”, DISKRIMINIMIT

1



Klasa

VITI I DYTË

Lënda

SOCIOLOGJI

Tema nga programi
mësimor

DIFERENCIMI
DHE STRATIFIKIMI
SHOQËROR

Njësia mësimore

GRUPET ETNIKE



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësjë të:

- ▶ mund t'i përcaktojë nocionet: grup etnik, identitet etnik, antagonizëm etnik, paragjyqime, stereotipe dhe diskriminim;
- ▶ dijë t'i njohë shenjat dalluese të identitetit etnik;
- ▶ mund t'i përshkruajë raportet në një shoqëri multietnike dhe të formojë qëndrimin e vet për raportet ndëretnike.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësjë të:

- ▶ zhvillojë shkathësi për njohjen e stereotipeve të vetja dhe të tjerët;
- ▶ zhvillojë shkathësi për uljen e stereotipeve dhe të paragjyqimeve për grupet tjera etnike;
- ▶ zhvillojë shkathësi se si të dilet nga përballja me sfidat e diskriminimit etnik;
- ▶ nxitet që t'ia dalë me sfidat e padrejtësisë dhe të ndërmarrë aksione për drejtësi sociale;
- ▶ ndërtojë vlera për integrim ndëretnik në shoqëri multikulturore.



RESURSE

- ▶ Kompjuter.
- ▶ LCD-projektor.
- ▶ Enë e thellë.
- ▶ Fletë pune.



KOHA

Tri orë mësimore me nga 45 minuta (+aktivitete për në shtëpi).



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Përmes më shumë ideve përcaktohen njohjet paraprake të nxënësve për nocionet kyç për temën si: grup etnik, identitet etnik, antagonizëm etnik, paragjykime, stereotipe dhe diskriminim.
2. Me ndihmën e teknikës rrush definoohen nocionet dhe zbulohen lidhjet midis tyre në shoqërinë bashkëkohore.
3. Për përvetësimin e qëllimeve mësimore dhe multikulturore shfrytëzohet projekti hulumtues, detyra e të cilit është t'i identifikojë karakteristikat e identitetit etnik dhe t'i definojë qëndrimet të nxënësit për raportet ndëretnike në shoqërinë multikulturore bashkëkohore.
4. Për këtë qëllim paralajmërohet hulumtimi që do ta bëjnë nxënësit me temë: *Identiteti etnik dhe diskriminimi mbi bazë të përkatësisë etnike.*

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

Për zbatimin e hulumtimit shfrytëzohet metodologjia e kombinuar e shikimit të letërsisë/dokumenteve, e analizës së mediave, anketimit (ndërmjet nxënësve dhe faktorëve relevantë), si dhe paraqitja e rasteve.

1. Nxënësit sipas zgjedhjes së rastit ndahen në katër grupe dhe marrin Fletën e punës, me instruksione të detajuara për punë. Grupet i kanë këto detyra:
 - ▶ **Grupi i parë** ka për detyrë që ta japë pasqyrën e rregullores ligjore për pengimin e diskriminimit. Ai i hulumton zgjidhjet ligjore në R. të Maqedonisë dhe të gjitha konventat ndërkombëtare që kanë nxjerrë OKB, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Grupi e kontrollon dhe e konfirmon edhe ratifikimin e këtyre dokumenteve nga ana e Kuvendit të RM. Bën përzgjedhjen, analizën dhe sintezën e të dhënave të fituara dhe i interpreton në raportin grupor. Lideri i grupit në mënyrë interne i ndan detyrat për secilin anëtar.
 - ▶ **Grupi i dytë** e shikon ndikimin e mediave ndaj dukurisë së diskriminimit mbi bazë etnike. Për këtë nxënësit analizojnë masmedia të selektuara elektronike dhe të shtypura: internetin, televizionin, radion dhe gazetatat. Në zgjedhjen e mediave ndikon edhe gjuha që shfrytëzon media, popullariteti dhe lloji i programit që ajo emeton. Pasi ta ketë bërë zgjedhjen e mediave konkrete, grupi merret vesh se cilat rubrika, përkatësisht cilat edicione informative do t'i përcjellë. Lideri i grupit i ndan rolet për të gjithë anëtarët. Secili anëtar i grupit bën raportin, e pastaj analizohen dhe përmbledhen rezultatet nga të gjithë anëtarët e grupit, të cilat pastaj do të përfshihen në raportin grupor të klasës.
 - ▶ **Grupi i tretë** realizon anketa për mundësitë e ballafaqimit me sfidat e padrejtësisë dhe për ndërmarrjen e aksioneve për barazi sociale ndërmjet nxënësve dhe faktorëve relevantë për temën. Gjatë përgatitjes së anketës përfshihet edhe mësimdhënësi, i cili pyetjeve u jep kahe që të jenë të lidhura me qëllimet që duhet t'i arrijnë nxënësit (mësimore dhe multikulturore). Shkolla e siguron shtypjen dhe shumëzimin e pyetësorëve. Anketa realizohet në mesin e nxënësve të vitit të dytë dhe të mësimdhënësve, duke përfshirë edhe prindërit dhe me këtë rast mbahet llogari që ekzemplari të jetë reprezentativ. Gjithashtu, anketohen përfaqësues nga organizatat joqeveritare, të cilat merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues nga komuna së cilës i takon shkolla dhe përfaqësues

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

nga MASH-i. Lideri i grupit bën ndarjen e roleve për secilin prej anëtarëve të tij. Grupi i përpunon dhe i analizon pyetësorët, e pastaj shkruan raport, të cilin e përfshin në raportin grupor të klasës.

- ▶ **Grupi i katërt** bën paraqitjen e rasteve që janë shembuj konkretë të diskriminimit mbi bazë etnike. Rastet mund t'i paraqet përmes shfrytëzimit të literaturës profesionale, por edhe përmes intervistave të njerëzve konkretë nga rrethina e drejtpërdrejtë, të treguara nga organizatat joqeveritare që i mbrojnë të drejtat e njeriut. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit se cilën literaturë mund ta shfrytëzojnë për arritjen e qëllimit dhe ku të drejtohen që të mund ta realizojnë detyrën e tyre. Lideri i ndan detyrat, e pas realizimit të tyre shkruajnë raport, të cilin e përfshijnë në raportin e përbashkët.
- 2. Definojnë problemin, çështja dhe qëllimi, e pastaj përpilohet plani sipas të cilit do të zhvillohet hulumtimi.
- 3. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në kuadër të grupeve deri në momentin kur e përgatisin raportin final në nivel të klasës dhe bashkë e prezantojnë.
- 4. Vijon tubimi i informatave në grupe, ndjekur me udhëzimet dhe informatat kthyes nga ana e mësimdhënësit.
- 5. Që të neutralizohet pjesëmarrja e prindërve dhe nxënësve t'u sigurohet qasje e barabartë tek resurset, raporti grupor përgatitet në shkollë, në laboratorin kompjuterik. Pasi t'i kenë analizuar dhe sintetizuar të dhënat, vijon nxjerrja e përfundimeve. Kjo është me shumë rëndësi, sidomos për shkak se në hapin vijues bëhet fuzionimi i grupeve, përkatësisht nga një anëtar i secilit grup (zëdhënësi i grupit) merr pjesë në përpilimin e raportit final. Në këtë fazë, gjithashtu, me rëndësi vendimtare është bashkëpunimi i të gjithë anëtarëve të grupit.
- 6. Nxënësit përgatisin raport nga hulumtimi i realizuar – bëjnë prezantim në programin kompjuterik, ku potencohen rezultatet e arritura nga hulumtimi.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

- 1. Prezantimi i raportit nga hulumtimi zhvillohet në orë të hapur, në praninë e nxënësve, mësimdhënësve dhe të shërbimit pedagogjik të shkollës. Zgjidhet nga një prezantues prej secilit grup, të cilët ndërrohen varësisht nga rrjedha e sllajdeve.
- 2. Nxënësit përpilojnë kodin e sjelljes, i propozuar nga bashkënxënësit e tyre. Kodi është ekspozuar në hollin e shkollës, si simbol i përpjekjeve për integrim ndëretnik.
- 3. Si aktivitet plotësues, nxënësit mund të bëjnë bllog, që të njihen dhe të zgjojnë interes për temën në një rreth sa është e mundur më të gjerë nxënësish, prindërisht dhe mësimdhënësish. Nxënësit kanë për detyrë që ta mirëmbajnë bllogun dhe t'u përgjigjen reagimeve.
- 4. Bëhet evaluacioni i aktivitetit të zbatuar, përmbledhen rezultatet dhe vlerësohet projekti në tërësi. Në emër të grupeve paraqiten liderët e tyre, të cilët vetëvlerësohen në lidhje me temën e hulumtimit, të dhënat e fituara për projektin e përgatitur dhe në lidhje me mënyrën e komunikimit në grup, por edhe me grupet tjera dhe me mësimdhënësin. Në fund kontrollohet arritja e qëllimeve mësimore dhe multikulturore të aktivitetit përmes pyetjeve në vazhdim:

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

- ▶ Çfarë domethënie kanë nocionet: grup etnik, identitet etnik, antagonizëm etnik, paragjyqime, stereotipe dhe diskriminim?
- ▶ Cilat janë karakteristikat themelore të identitetit etnik?
- ▶ Në çfarë mënyre do të veprojmë në bashkësi që t'i ulim stereotipet dhe paragjykimet ndaj bashkësive të tjera etnike, që përbëjnë bazën për diskriminim?
- ▶ Çka do të ndërmarrim për t'ia dalë me situatat e padrejtësisë dhe të diskriminimit?



Roli juaj është që të analizoni hulumtimin të ndarë në katër grupe, të përgatisni raportin në kuadër të grupit, e pastaj ta përfshini në raportin e përbashkët. Raportin duhet ta prezantoni dhe për të duhet të përpiloni kodin, i cili do të jetë simbol i përpjekjeve të shkollës suaj për integrim ndëretnik.

Shfrytëzoni udhëzimet në vazhdim, që do t'ju ndihmojnë në realizimin e hulumtimit:

1. Zgjidhni kartelën që do ta caktojë grupi të cilit do t'i takoni. Numri i kartelës është numri i grupit tuaj. Uluni në vendin e caktuar për atë grup.
2. Nga fleta e punës përcillni instruksionet që kanë të bëjnë me grupin tuaj, ndërsa në situatat kur klasa funksionon si një grup, përcillni instruksionet për klasën.

DETYRA PËR GRUPET:

GRUPI I PARË E PASQYRON RREGULLOREN LIGJORE PËR PENGIMIN E DISKRIMINIMIT

- ▶ Zgjidhni liderin e grupit, i cili në mënyrë interne do t'i ndajë detyrat për secilin anëtar.
- ▶ Hulumtoni zgjidhjet ligjore në R. të Maqedonisë (Kushtetutën dhe ligjet) dhe të gjitha konventat ndërkombëtare të nxjerra nga OKB, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.
- ▶ Kontrolloni ratifikimin e këtyre dokumenteve nga ana e Kuvendit të RM.
- ▶ Bëni selektimin, analizën dhe sintezën e të dhënave të fituara dhe interpretoni ato në raportin grupor.
- ▶ Zgjidhni prezantuesin e grupit, i cili do të marrë pjesë në prezantimin grupor.

GRUPI I DYTË E ANALIZON NDIKIMIN E MEDIAVE NDAJ PARAQITJES SË DISKRIMINIMIT MBI BAZË ETNIKE.

- ▶ Selektoni masmediat elektronike dhe të shtypura: internetin, televizionin, radion dhe gazetën. Te zgjedhja e mediave ndikon edhe gjuha që shfrytëzon media, popullariteti dhe lloji i programit që emeton.
- ▶ Pasi ta keni bërë zgjedhjen e mediave konkrete, merrni vesh se cilat rubrika, përkatësisht edicione informative do t'i përcillni.
- ▶ Lideri i grupit i ndan rolet për të gjithë anëtarët.
- ▶ Secili anëtar i grupit bën raportin, e pastaj analizohen dhe përmbledhen rezultatet nga të gjithë anëtarët e grupit, të cilët pastaj do të përfshihen në raportin grupor të klasës.
- ▶ Zgjidhni prezantuesin e grupit, i cili do të marrë pjesë në prezantimin grupor.

GRUPI I TRETË BËN ANKETË PËR MUNDËSITË E BALLAFAQIMIT ME SFIDAT E PADREJTËSISË DHE PËR NDËRMARRJEN E AKSIONEVE PËR DREJTËSI SOCIALE NDËRMJET NXËNËSVE DHE FAKTORËVE RELEVANTË PËR TEMËN.

- ▶ Përgatitni pyetjet për pyetëtorin e anketës që do t'i përgjigjet temës për hulumtim dhe do të jetë i lidhur me qëllimet mësimore dhe multikulturore kyç.
- ▶ Caktoni numrin e personave që do të anketohen, duke mbajtur kujdes me këtë rast që anketimin ta bëni ndërmjet nxënësve të vitit të dytë, ndërmjet mësimdhënësve dhe prindërve, me ç'rast duhet të mbani llogari që ekzemplari të jetë reprezentativ. Gjithashtu, anketohen përfaqësues nga organizatat joqeveritare, të cilat merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues nga komunat ku hyn shkolla dhe përfaqësues nga MASH-i.

- ▶ Shtypni dhe shumëzoni pyetësorët.
- ▶ Lideri i grupit i ndan rolet për secilin anëtar të grupit.
- ▶ Grupi i realizon, i përpunon dhe i analizon pyetësorët, e me këtë rast shkruan raport, të cilin e përfshin në raportin grupor të klasës.
- ▶ Zgjidhni prezantues të grupit, i cili do të marrë pjesë në prezantimin grupor.

GRUPI I KATËRT E BËN PASQYRËN E RASTEVE QË JANË S HEMBUJ KONKRETË TË DISKRIMINIMIT MBI BAZË ETNIKE.

- ▶ Rastet mund t'i paraqisni duke shfrytëzuar literaturën profesionale, por edhe përmes intervistave të njerëzve konkretë nga rrethina e drejtpërdrejtë, të treguar nga organizatat joqeveritare të cilat i mbrojnë të drejtat e njeriut. Shfrytëzoheni literaturën udhëzuar nga ana e mësimdhënësit, por mund të bëni edhe hulumtim të mëvetësishëm.
- ▶ Drejtojuni për ndihmë organizatave joqeveritare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- ▶ Lideri i ndan detyrat, e pas realizimit të tyre shkruani raport, të cilin do ta përfshini në raportin e përbashkët të klasës.
- ▶ Të keni kujdes për integritetin e rasteve që i përshkruani.
- ▶ Zgjidhni prezantuesin e grupit, i cili do të marrë pjesë në prezantimin grupor.

Mbi bazë të detyrës së grupit tuaj, përpiloni planin sipas të cilit do ta bëni hulumtimin.

GRUPET FUNKSIONOJNË NDARAS, GJITHNJË DERI TE FAZA E PËRGATITJES SË RAPORTIT (PREZANTIMIT) FINAL.

1. Raportin final përgatiteni bashkë në orë me përfaqësuesit e të gjitha grupeve. Duhet të përgatitni prezantimin ku do t'i paraqisni rezultatet që do të arrini me ndihmën e hulumtimit.
2. Prezantoni në orë të hapur para nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve të shkollës.
3. Bëni kodin e sjelljes, të cilin do ta ekspozoni në hollin shkollor, si simbol të përpjekjeve të shkollës suaj për integrim ndëretnik.
4. Si aktivitet plotësues mund të bëni bllog për temën. Detyra juaj do të jetë që ta mirëmbani bllogun dhe të përgjigjeni pozitivisht në reagimet e lexuesve.
5. Bëni kodin e sjelljes, të cilin do ta ekspozoni në koridorin shkollor, si simbol të përpjekjeve të shkollës suaj për integrim ndëretnik.

ETNO-ORNAMENTE



Klasa	Drejtimi profesional/ profili arsimor/ programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I DYTË	TEKSTIL-LËKURË TEKNIK I KONFEKSIONIT DISENJI I VESHJEVE	VLERAT ESTETIKE NGA KRIJIMTARIA POPULLORE NË VESHJET BASHKËKOHORE	RIFORMËSIMI I ETNO-ELEMENTEVE NË ORNAMET BASHKËKOHOR



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ njihet me vlerat figurative, estetike dhe funksionale të ornamenteve nga krijimtaria popullore e kulturave dhe bashkësive etnike të ndryshme në R. të Maqedonisë;
- ▶ mësojë që t'i njohë dhe t'i dallojë veshjet popullore dhe ornamentet nga bashkësitë e ndryshme etnike;
- ▶ aplikojë elemente dhe parime figurative në disenjin e veshjeve;
- ▶ shfrytëzojë vlerat e disenjtit nga krijimtaria popullore në praktikë;
- ▶ krijojë ornamente bashkëkohore me kombinimin e etno-elementeve dhe të pjesëve të ornamenteve (zbukurimeve) nga veshje të ndryshme popullore, nga kultura dhe bashkësi etnike të ndryshme;
- ▶ riformësojë etno-elemente të ndryshme në ornamet bashkëkohor.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ nxisë interes dhe dashuri ndaj krijimtarisë popullore, të krijuar nga bashkësi etnike dhe kultura të ndryshme;
- ▶ zhvillojë raport të drejtë ndaj tërë krijimtarisë popullore në Maqedoni përmes njohjes së karakteristikave të bashkësive të ndryshme etnike;
- ▶ zhvillojë vlera estetike dhe kulturore, e me këtë edhe ndjesinë e respektit dhe të pranimit të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Fotografi me veshje popullore nga bashkësi etnike të ndryshme.
- ▶ Shembuj me ornamente, me detaje nga veshjet popullore nga grupet e ndryshme etnike (maqedonase, shqiptare, vllehe, turke etj.) nga vise të ndryshme të Maqedonisë.
- ▶ Video-prezantim me ornamente, veshje popullore, arkitekturë, muzikë të ndryshme.
- ▶ Fletë pune dhe Shtojcë.



KOHA

Dy orë mësimore me nga 45 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me shumë ide për nocionet ornament dhe etno-ornament dhe nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim:
 - ▶ Çka nënkupton nocioni ornament?
 - ▶ Cilat janë llojet e ornamenteve?
 - ▶ Cili është dallimi themelor i etno-ornamenteve në kultura të ndryshme?
 - ▶ Ku përdoren më shpesh ornamentet?
 - ▶ Cili është roli i ornamenteve të tekstit?
2. Nxënësit paralajmërohen se detyra në të cilën do të punojnë përbëhet nga dy pjesë. Në pjesën e parë do të hulumtojnë për përdorimin e ornamenteve në punimin e veshjeve popullore nga bashkësi etnike të ndryshme, ndërsa në pjesën e dytë do të bëjnë kreacionin e ornamentit bashkëkohor në disenjin e tekstit për veshje.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

- ▶ Nxënësit ndahen në grupe më të vogla. Secili grup e merr Shtojcën me shembuj të linqeve dhe publikimeve me veshje të ndryshme popullore dhe me etno-elemente të tjera nga krijimtaria popullore në R. të Maqedonisë nga grupe etnike të ndryshme nga rrethina e drejtpërdrejtë.
- ▶ Nxënësve u shpërndahet Fleta e punës me detyrat në vazhdim:

DETYRA 1 – Hulumtimi i ornamenteve

- ▶ Nxënësit në grupet e tyre i shikojnë linqet dhe publikimet nga Shtojca me veshje të ndryshme popullore dhe bëjnë analizën e ornamenteve të veshjeve popullore nga grupet e ndryshme etnike: a) bëjnë ballafaqimin e vlerave figurative; b) i njohin elementet nga veshjet popullore se cilës bashkësi etnike i takojnë; c) bëjnë krahasimin e ornamenteve dhe i përcaktojnë ngjashmëritë dhe dallimet.
- ▶ Secili grup i prezanton hulumtimet e veta dhe mësimdhënësi në dërrasë të zezë bën një listë të përbashkët nga të gjitha grupet, ku e bën përmbledhjen e karakteristikave të ornamenteve, të stolive që kanë qenë të përfshira në fotografi dhe i thekson ngjashmëritë dhe dallimet e tyre.

DETYRA 2 – Kreacioni i disenjit të ornamentit bashkëkohor për veshjen

- ▶ Nxënësit në grupet e njëjta punojnë në disenjin e ornamentit të ri, të stolisë së re bashkëkohore, me elementet e pranishme (ngjyrat, format, vijat) të ornamenteve të një bashkësie etnike të cilën vetë e zgjedhin – në një tërësi të re, bashkëkohore.
3. Nxënësit në vend të dukshëm e ekspozojnë disenjin e tyre të ornamentit bashkëkohor nga bashkësi të ndryshme etnike.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nxënësit marrin instruksione që t'i shikojnë disenjet e ekspozuara të ornamenteve bashkëkohore të përgatitura nga grupet tjera, t'i identifikojnë ngjashmëritë dhe dallimet dhe të shkruajnë pyetje dhe komente për diskutim për tërë aktivitetin.

Mësimdhënësi bën refleksionin përmes pyetjeve në vazhdim:

- ▶ Me cilat nocione të reja u takuat në këtë orë?
 - ▶ Cilat dilema i kishit gjatë hulumtimit të ornamenteve?
 - ▶ A mund të thoni se cilat janë ngjashmëritë e ornamenteve të kulturave të dhëna që i lidhin, e cilat janë dallimet e tyre?
 - ▶ Si bëhet riformësimi i etno-elementeve në ornament bashkëkohor?
2. Këto aktivitete a e nxitën interesimin tuaj për krijimtarinë popullore të krijuar nga bashkësi etnike dhe kultura të ndryshme?

FLETË PUNE

Hulumtimi dhe disenji i etno-ornamentit

DETYRA 1 – HULUMTIMI I ORNAMENTEVE

Në grupet tuaja shikoni linqet dhe publikimet me veshje të ndryshme popullore dhe bëjeni analizën e ornamenteve të veshjeve popullore të grupeve të ndryshme etnike, me ç'rast duhet: a) t'i dalloni vlerat figurative; b) t'i njihni elementet nga veshjet popullore se cilës bashkësi etnike i takojnë; c) të bëni krahasimin e ornamenteve dhe t'i caktoni ngjashmëritë dhe dallimet.

DETYRA 2 – KREACIONI I DISENJIT TË ORNAMENTIT BASHKËKOHOR

Përgatisni disenjin e ornamentit, të stolisë së re, bashkëkohore me elemente të pranishme (ngjyra, forma, vija) të ornamenteve të një bashkësie etnike që vetë e zgjidhni – në një tërësi të re, bashkëkohore.



Në shtojcë janë dhënë shembuj nga linqe dhe publikime ku janë paraqitur veshje popullore nga bashkësi të ndryshme etnike në Republikën e Maqedonisë.

LINQE PËR VESHJE POPULLORE NGA BASHKËSIA ETNIKE MAQEDONASE NGA RAJONE TË NDRYSHME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.

1. Македонски вез – Википедија. [E qëndisime maqedonase - Wikipedia]
<http://bit.ly/2i9Jy0S>
2. Народни везови и накит (Veshje popullore dhe stoli)
<http://www.zmurh.hr/category/makedonija/tradicija/narodni-vezovi-i-nakit/?lang=mk>
3. Народниот вез во Македонија (Qëndisje popullore në Maqedoni)
http://documents-mk.blogspot.mk/2013/09/blog-post_8923.html
4. Народни носии од brsjacka etnografka целина - Wiki.mk
(Veshje popullore nga etnografija e përgjithshme brsjake – Wiki.mk)
<http://bit.ly/2ij9Gnu>
5. Народни носии од mijacka etnografka целина - Wiki.mk
(Veshje popullore nga etnografija e përgjithshme e mijakëve – Wiki.mk)
<http://bit.ly/2hglWn4>
6. Носија од Прилепско-Битолско Поле - Википедија.
(Veshje popullore e fushës së Prilepit - Manastirit - Wikipedia)
<http://bit.ly/2hqHZwi>
7. Јаневски, Владимир. *Народните ора прикажани во текстилното народно творештво* (Janevski, Vladimir. *Vallet popullore të paraqitura në krijimtarinë tekstile popullore*)
<http://eprints.ugd.edu.mk/11866/1/ETNOLOG%20%2016%20Janevski%20Vladimir.pdf>
8. Ристовска Пиличкова, Јасминка. *Мотивот саан – можна манифестација на митска птица Семург – Симург* (Ristovska Piličkova, Jasminka. *Motivi saan – manifestim i mundshëm i zogut mitik Semeurs – Simura*)
<http://philologicalstudies.org/dokumenti/2013/Philosophical-Cultural%20Problems/06.tom%201.rub1.J.Ristovska%20Pilickova.pdf>
9. Крстева, Ангелина. 2001. *Македонски народни везови/Macedonian folk embroideries*. Издавачка куќа: Матица Македонска.
(Krsteva, Angelina. 2001. *Qëndisje popullore maqedonase/Macedonian folk embroideries*. Shtëpia botuese: Matica Makedonska.)

LINQE PËR VESHJE POPULLORE NGA BASHKËSIA ETNIKE SHQIPTARE NGA RAJONE TË NDRYSHME NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1. Elemente folklorike nga rajoni i Tetovës - Kontribut për ruajtjen e vlerave folklorike të rajonit të Tetovës – Publikimi është përgatitur nga Forumi i Gruas Shqiptare; Ambasada e Holandës; Organizata e Grave; Muzeu Etnologjik i Qytetit të Tetovës.
<http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-MK.pdf>
<http://www.forumi.org.mk/userfiles/file/publikime/brosh-SHQ.pdf>
2. Ekspozate të etnografisë shqiptare në Maqedoni/Експонати на албанската етнографија во Македонија/ /Exhibits of Albanian ethnography in Macedonia – Halide Palloshi. Botues: OGG Jehona-Shkup. Publikimi është mbështetur nga Ministria e Kulturës, Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Çairit.

PASURI E KULTURAVE TË NDRYSHME



Klasa

VITI I DYTË

Lënda

SOCIOLOGJI

Tema nga programi
mësimor

KULTURA

Njësia mësimore

NGJASHMËRI
KULTURORE DHE
DALLIME KULTURORE



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ numërojnë elementet që janë të përbashkëta për të gjitha kulturat, si dhe elementet që janë karakteristike për kulturat e veçanta.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësja të:

- ▶ dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet nxënësve të klasës së vet;
- ▶ vërejnë gërshetimin e kulturave;
- ▶ vërejnë karakteristikat e aspekteve të dukshme dhe të padukshme të kulturës;
- ▶ përcaktojnë karakteristikat e kulturave të ndryshme nga RM;
- ▶ shohin ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet kulturës së vet dhe kulturave të tjerëve;
- ▶ rrit vetëdijen për pranimin dhe respektimin e dallimeve të kulturave të tjera.



RESURSE

- ▶ Fletë pune.
- ▶ Internet.



KOHA

Dy orë mësimore nga 45 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon ashtu që kërkohen dy nxënës të cilët vullnetarisht do të duhet të dalin përpara klasës dhe të qëndrojnë të kthyer me shpinë ndaj njëri-tjetrit.
2. Prej nxënësve të tjerë kërkohet që të tregojnë gjëra për dallimet e të dy nxënësve, të cilët vullnetarisht janë paraqitur për aktivitetin (dallimet mund të ndërlidhen me: 1) karakteristikat fizike/të jashtme – për shembull, a keni flokë të shkurtëra/të gjata, a keni sy të errët/të ndritshëm, a jeni të veshur me atlete/këpucë dhe 2) karakteristika personale – hobi, interesime, për shembull, a e keni picën ushqim të preferuar, a dëgjoni muzikë në kohë të lirë, a doni të lexoni libra, a bëni sport. Me të thënë të njëjti dallimi, nxënësit bëjnë hapin me të cilin largohen. Kur ata do të arrijnë deri te fundi i hapësirës, kthehen me fytyrë kah njëri-tjetri.
3. Pastaj prej nxënësve të tjerë kërkohet që të tregojnë ngjashmëritë për të dy nxënësit. Për çdo ngjashmëri të treguar nxënësit bëjnë nga një hap përpara.
4. Pas ushtrimit të gjithë nxënësit nxiten për diskutim:
 - ▶ Cilat gjëra u vërejtën si dallime? Sa prej gjërave të theksuara mund të shiheshin/vëreheshin lehtë (gjinia, ngjyra e flokëve, lloji i këpucëve e të ngjashme)?
 - ▶ Si ishte rasti me ngjashmëritë? Theksohet se edhe te ngjashmëritë karakteristikat fizike më lehtë vërehen, ndërsa për shumë ngjashmëri të tjera që kanë të bëjnë me karakteristikat personale nuk mund të caktohet shikueshmëria (për shembull: hobi, interesimi për jetën e të ngjashme).

Nxënësve u potencohet se me shumë rëndësi është të dihen ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet njerëzve të kulturave të ndryshme dhe është me rëndësi që ato ndërmjet vete të respektohen dhe të pranohen. Që ta kuptojnë më mirë konceptin e kulturës, ajo paraqitet përmes metaforës së ajsbergut, tek i cili një pjesë më e vogël është mbi ujë dhe shihet, ndërsa pjesa tjetër, që është më e madhe, është nën ujë dhe nuk shihet. Mund të shpjegohet se edhe kultura si një copë e madhe akulli ka aspektet e shikueshme dhe shumë aspekte të tjera për të cilat vetëm mund të supozojmë dhe të mësojmë që ta kuptojmë më mirë, me qëllim që të kemi interaksion të suksesshëm.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Nxënësit paralajmërohen se do të punojnë në grupe të vogla (3-4 nxënës) dhe iu shpërndahet Fleta e punës – Karakteristikat e kulturës. Secili nxënës i grupit në mënyrë individuale e plotëson fletën e punës dhe jep shpjegim për çdo karakteristikë. Në fillim mesimdhënësi u ndihmon nxënësve që të jenë objektivë në shpjegimin e zakoneve të kulturës së tyre.
2. Pas plotësimit të fletës së punës, nxënësve u jepen udhëzime që në kuadër të grupeve të tyre të diskutojnë rreth karakteristikave në vazhdim dhe të bëjnë krahasimin e përgjigjeve të tyre:
 - ▶ **Kremte:** Cilat lloje të kremteve janë të rëndësishme në familjet tuaja? Çka ngjason, e çka dallon?
 - ▶ **Mënyrat e përshëndetjes:** Në çfarë mënyre i përshëndetni njerëzit që nuk i njihni, e si i përshëndetni njerëzit që i njihni?
 - ▶ **Mikpritja:** Si e shprehni mikpritjen në bashkësinë tuaj, në shkollë, në familje?
 - ▶ **Roli i familjes:** Cilat ngjarje të rëndësishme dhe në çfarë moshe kremtohen në familjen ose në bashkësinë tuaj?
 - ▶ **Qëndrimi për hapësirë dhe privatësi personale:** Sa është e rëndësishme të kesh hapësirë dhe privatësi personale?

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

3. Pas diskutimit, prej nxënësve në grup kërkohet që të përcaktojnë se cilat karakteristika janë të dukshme, e cilat janë të padukshme. Secili grup merr fletë të zbrazët ku duhet të vizatojë ajsbergun dhe të tërheqë vijën me të cilën ndahet copa e akullit në një pjesë më të vogël, që është mbi sipërfaqen e ujit, dhe pjesën më të madhe, që është nën ujë.
4. Prej nxënësve kërkohet që të shkruajnë mbi vijën e ujit numra që kanë të bëjnë me karakteristikat e dukshme të kulturës së tyre. Në pjesën më të madhe, nën ujë, shkruhen numrat e karakteristikave të padukshme.
5. Në fillim grupeve u jepet disa shembuj, kurse pastaj ato punojnë në mënyrë të mëvetësishme (për shembull, stili i veshjes është karakteristikë e dukshme, qëndrimet e mikpritjes janë të padukshme).
6. Pas kryerjes së detyrës, secili grup në çift me grupin tjetër e krahason vendin e karakteristikave. Nxënësit duhet të jenë të përgatitur për të dhënë shpjegimin se përse vendi i secilës karakteristikë është mbi vijë ose nën vijë (është e dukshme ose e padukshme). Në listën e karakteristikave numrat që do të duhej të jenë nën vijë janë: 3, 5, 6, 7; 13; 14; 17 – 24.
7. Në fund të orës së parë nxënësve u jepet detyra e shtëpisë që të hulumtojnë përmes internetit për karakteristikat e pjesëtarëve të kulturës tjetër që jeton në Maqedoni dhe t'i përcaktojnë ngjashmëritë dhe dallimet e kulturës së tyre me kulturën tjetër për të cilën kanë bërë hulumtimin. Secili grup e cakton se për cilën kulturë do të bëjë hulumtimin, ndërsa në kuadër të grupit hulumtimi bëhet në nivel individual. Nxënësit orientohen që hulumtimin duhet ta bëjnë sipas karakteristikave të dhëna në Fletën e punës.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Nxënësit në grupet e tyre i përpunojnë të dhënat e fituara nga hulumtimi për karakteristikat e kulturës tjetër, të cilën e kanë zgjedhur në orën e mëparshme.
2. Nxënësit punojnë në përgatitjen e prezantimit për karakteristikat e kulturës tjetër dhe për ngjashmëritë dhe dallimet e kulturës së tyre.
3. Secili grup e prezanton punën e vet.
4. Me nxënësit bisedohet për çështjet në vazhdim:
 - ▶ Çka mësuat për kulturën së cilës ju i takoni?
 - ▶ Në çfarë mase e kishit vështirë që t'i përcaktoni karakteristikat e dukshme dhe të padukshme të kulturës suaj?
 - ▶ Cilat janë përshtypjet tuaja nga identifikimi i ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet kulturës suaj dhe kulturave të tjera?
 - ▶ Si mund të rritet pranimi dhe respektimi i dallimeve të kulturave të tjera?
 - ▶ Çka mund të ndërmerret që të pranohen dhe të respektohen dallimet ndërmjet kulturave në shoqërinë tonë?

Gjatë diskutimit nxënësit orientohen që të vijnë te përfundimi se në kuadër të secilës kulturë nuk mund të bëjmë përgjithësimin e karakteristikave të asaj kulture te të gjithë pjesëtarët për shkak të ekzistimit të dallimeve individuale tek individët (p.sh.: jo të gjithë myslimanët nuk hanë mish derri ose, jo të gjithë maqedonasit shkojnë në kishë)

KARAKTERISTIKAT E KULTURËS





Udhëzime për punë: Plotësojeni fletën e punës ashtu që për çdo karakteristikë shkruani shpjegimin për atë se çka është e përbashkëta për njerëzit nga kultura juaj.

1. Stili i veshjes	13. Koncepti për sjellje fer
2. Mënyra e përshëndetjes së njerëzve	14. Miqësia
3. Mikpritja	15. Ushqimi
4. Ardhja me kohë	16. Ekspresioni i fytyrës dhe gjestikulacioni i duarve
5. Qëndrimet për edukimin e fëmijëve dhe të rinjve	17. Koncepti për vetveten
6. Qëndrimet për hapësirën dhe privatësinë personale	18. Shprehitë e punës
7. Qëndrimet për përgjegjësitë e fëmijëve dhe të rinjve	19. Besimet religjioze
8. Gjestikulacioni që tregon se është kuptuar ajo çka të thuhet	20. Koncepti për të bukurën
9. Zakonet gjatë festave	21. Rregullat e sjelljes shembullore
10. Muzika	22. Qëndrimet për dallimet e gjeneratave
11. Danset dhe vallet	23. Roli i familjes
12. Kremtimet	24. Shikimet e përgjithshme për botën

PLANI I RI URBANISTIK



Klasa	Drejtimi profesional/ profili arsimor/ programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I DYTË	NDËRTIMTARI- GJEODEZI/ TEKNIK ARKITEKTURE/ ZHVILLIMI I ARKITEKTURËS	ARKITEKTURA POPULLORE MAQEDONASE	KARAKTERISTIKA DHE RREGULLIMI I ARKITEKTURËS TRADICIONALE NË MAQEDONI

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ zhvillojë vetëdijen për ruajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore dhe arkitektonike në Republikën e Maqedonisë; ▶ vërejë rëndësinë për mbrojtjen e autoktonisë së ndërtimeve të vjetra përmes konceptit të rikonstruktimit dhe revitalizimit; ▶ thellojë kompetencat për udhëheqjen e debatit dhe definimin e argumenteve logjike për temën.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ forcojë vetëdijen për vlerat e trashëgimisë së përbashkët dhe për ruajtjen e saj si pasuri e shumëllojshmërisë kulturore në Republikën e Maqedonisë.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Fletë pune
	KOHA	Dy orë mësimore prej nga 45 minuta.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Aktiviteti fillon me diskutimin për kontrollimin e njohurive të mëparshme të nxënësve përmes pyetjeve:
 - ▶ Cilat janë karakteristikat funksionale, konstruktive dhe shprehimore të shtëpisë krishtere tradicionale maqedonase dhe të shtëpisë myslimane tradicionale maqedonase në R. e Maqedonisë?
 - ▶ Cilat janë karakteristikat e rregullimit enterier të shtëpisë krishtere tradicionale maqedonase dhe të shtëpisë myslimane tradicionale maqedonase në R. e Maqedonisë?
 - ▶ Çka nënkuptoni me nocionin trashëgimi kulturore e shumëllojshme/e përbashkët?
2. Pastaj paralajmërohet debati në temë: "Propozim-planu urbanistik i qendrës së qytetit".

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Mësimdhënësi e shpërndan fletën e punës 1, ku është përshkruar situata hipotetike për debatin në temë: "Propozim-planu urbanistik i qendrës së qytetit", theksuar në fletën e punës.
2. Nxënësve u shpjegohet se do të zhvillojnë debat për planin urbanistik, me të cilin parashihet që unaza e vjetër e qytetit të priset dhe të ndërtohen ndërtesa të reja moderne banimi. Sipas skenarit, përfaqësuesit e pushtetit lokal janë për planin e propozuar urbanistik, me argumentet se arkitektura moderne është më e mirë, ndërsa ekspertët nga sfera e mbrojtjes së monumenteve kulturore haptas janë kundër – me argumente që të bëhet rikonstruktimi dhe revitalizimi i unazës së vjetër.
3. Nxënësit ndahen në pesë grupe, me detyrë që të përgatiten për debat dhe mbrojtjen e qëndrimeve të tyre si përfaqësues të institucioneve në vazhdim:
 - ▶ **grupi i parë** e paraqet pushtetin lokal, që është në mbrojtje të planit;
 - ▶ **grupi i dytë** i paraqet ekspertët, që janë kundër planit;
 - ▶ **grupi i tretë** i paraqet qytetarët që jetojnë në pjesën e vjetër të qytetit me shtëpi krishtere dhe myslimane të ndërtuara në stilin tradicional të arkitekturës popullore në Maqedoni;
 - ▶ **grupi i katërt** i paraqet arkitektët dhe urbanistët profesionalë;
 - ▶ **grupi i pestë** i paraqet përfaqësuesit e mediave.
4. Nxënësit, në kuadër të grupeve të tyre, përgatiten për mbrojtjen e qëndrimit dhe me këtë rast shfrytëzohet literatura profesionale dhe materiale për punë burimet e internetit ose konsultohen me mentorin/mësimdhënësin.
5. Klasa zgjedh komisionin me kryetar dhe dy nënkryetarë, të cilët do ta udhëheqin debatin, dhe dy procesmbajtës, të cilët do të shkruajnë raport nga takimi.
6. Pastaj, përfaqësuesi i grupit e jep arsyetimin e qëndrimit të grupit, argumentuar PËR dhe KUNDËR planit urbanistik të qendrës së qytetit (secili nga aspekti i vet, në pajtim me rolin që ka, në një kornizë kohore prej 5 minutave).
7. Kryetari dhe komisioni u bëjnë thirrje nxënësve në debat që të marrin pjesë në diskutim në lidhje me qëndrimet ndërmjet grupeve.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

8. Pas mbarimit të diskutimit, mësuesi e vazhdon debatin përmes diskutimit të strukturuar me të gjithë nxënësit:
 - ▶ Cilat elemente duhen pasur parasysh kur merret vendimi për planin urbanistik?
 - ▶ Përse është me rëndësi që të bëhet hulumtimi më i thelluar i temës për të cilën debatohet?
 - ▶ Në çfarë mase qëndrimet ishin të përgatitura mirë dhe qartësisht të arsyetuara me argumente?
 - ▶ Si e vlerësoni suksesshmërinë e debatit? Çka ishte mirë, e çka mund të ishte më mirë?
 - ▶ Cilat konkluzione mund t'i nxirrni nga debati?

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Çka nënkuptoni me trashëgimi kulturore?
2. A njihni shembuj të ngjashëm për objekte që janë të rëndësishme si trashëgimi e jonë historike kulturore, e që janë rrezikuar të rrënohen?
3. Përse është i rëndësishëm rikonstruktimi dhe revitalizimi i objekteve autentike nga arkitektura e vjetër e qytetit?
4. Përse është me rëndësi të ruhen vlerat e trashëgimisë së përbashkët si pasuri e shumëllojshmërisë kulturore në Republikën e Maqedonisë?
5. A dini për shembuj pozitiv në Evropë për zgjidhjen e problemit ekuivalent?



SITUATË HIPOTETIKE:

“Pushteti lokal ka përgatitur propozim-plan urbanistik për qendrën e qytetit ku jetoni. Qendra e qytetit përfshin një pjesë me disa ndërtime të ngritura në stilin tradicional të arkitekturës popullore të banimit – shtëpi myslimane dhe krishtere.

Standardi i banimit në unazën e vjetër shënon prapambetje në procesin e modernizimit. Objektet nuk kanë mundësi të kyçen në rrjetin e ujësjellësit dhe në to të ndërtohen tualete.

Realizimi i planit urbanistik do të thotë shkatërrim i pjesës më të vjetër të qytetit dhe ngritje e ndërtimeve bashkëkohore. Disa përfaqësues të pushtetit lokal janë për planin e propozuar urbanistik, me argumente se arkitektura bashkëkohore është më e mirë, ndërsa ekspertët tjerë nga pushteti lokal haptas janë kundër – me argumentet që të bëhet rikonstruktimi dhe revitalizimi i së vjetrës.”

VËREJTJE: Mbi bazë të rolit që keni në situatën e dhënë, merrni qëndrim dhe përpuni që ta argumentoni atë që t’i bindni të tjerët se qëndrimi juaj është i drejtë. Shfrytëzoni literaturë, internet, konsultime me mentorin/mësimdhënësin e të ngjashme, po qe se keni nevojë për ndihmë për argumentimin e qëndrimit tuaj.

ROLET:

GRUPI I PARË e paraqet pushtetin lokal, që është në mbrojtje të planit;

GRUPI I DYTË i paraqet ekspertët, që janë kundër planit;

GRUPI I TRETË i paraqet qytetarët që jetojnë në pjesën e vjetër të qytetit, në shtëpi krishtere dhe myslimane, të ndërtuara në stilin tradicional të arkitekturës popullore në Maqedoni;

GRUPI I KATËRT i paraqet arkitektët dhe urbanistët profesionalë;

GRUPI I PESTË i paraqet përfaqësuesit e mediave.



KRAHASIMI I NDËRTIMEVE TË VJETRA NË MAQEDONI



Klasa	Drejtimi/ profili arsimor/ programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I TRETË DHE I KATËR	NDËRTIMTARI- GJEODEZI/TEKNIK ARKITEKTURE, TEKNIK DISENJATOR PËR ARKITEKTURËN E BRENDSHME/ ZHVILLIMI I ARKITEKTURËS	ARKITEKTURA POPULLORE MAQEDONASE	KARAKTERISTIKAT STILISTIKE DHE RREGULLIMI I BRENDSHËM I SHTËPISË TRADICIONALE KRISHTERE DHE MYSLIMANE NË MAQEDONI



QËLLIMET E MËSIMIT

Nxënësi/nxënësjë të:




- ▶ njohë karakteristikat konstruktive dhe rregullimin enterier të arkitekturës tradicionale në Maqedoni;
- ▶ hulumtojë për karakteristikat e arkitekturës krishtere maqedonase dhe të arkitekturës myslimane maqedonase;
- ▶ paraqet në mënyrë grafike t'i ndërtimet e arkitekturës popullore;
- ▶ vërejë ngjashmëritë dhe dallimet multikulturore në zhvillimin e arkitekturës popullore të banimit në Maqedoni.
- ▶ zhvillojë vetëdijen për ruajtjen e trashëgimisë së pasur kulturore dhe arkitektonike në Maqedoni.



QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR

Nxënësi/nxënësjë të

- ▶ tejkalojë stereotipat dhe paragjykimet në lidhje me trashëgiminë kulturore, të cilën e konsideron si vlerë të përhershme të përbashkët;
- ▶ zhvillojë qasjen e hapur për njohjen e veçorive të trashëgimisë kulturore nga rrethina e drejtpërdrejtë.

	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Fletë pune; ▶ Internet.
	KOHA	Deri në 12 orë mësimore prej nga 45 minuta.
	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	AKTIVITET HYRËS
		<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmes më shumë ideve, përcaktohen njohuritë e mëparshme të nxënësve për arkitekturën tradicionale në Maqedoni. Nxënësve u shtrohen pyetjet në vazhdim: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Në cilat qytete të Maqedonisë ka ndërtime të ruajtura nga arkitektura popullore? ▶ Cilat janë karakteristikat kryesore (funktionale, konstruktive, shprehimore)? ▶ Cilat ndikime mund të vërehen tek arkitektura tradicionale në Maqedoni? ▶ Cilat ndërtime janë të njohura nga kjo periudhë? ▶ Cilat janë karakteristikat kryesore të arkitekturës popullore në Maqedoni? ▶ Bëni paralelen me zhvillimet e asaj periudhe në Evropë. 2. Pas diskutimit me nxënësit, mësimdhënësi jep një rezymë të shkurtër për arkitekturën popullore maqedonase.
		AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE
		<ol style="list-style-type: none"> 1. Nxënësve u thuhet se do të bëjnë hulumtimin e shtëpisë tipike myslimane dhe të shtëpisë tipike krishtere nga rajone të ndryshme në Maqedoni. Pastaj nxënësit duhet që në mënyrë grafike ta paraqesin dhe në mënyrë tekstuale ta shpjegojnë shtëpinë, ndërsa të dhënat e fituara t'i vënë në broshurë/katalog dhe t'i prezantojnë. 2. Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secili grup merr për detyrë që të bëjë hulumtimin e shtëpive në Shkup (ose në qytetet tjera të Maqedonisë: Tetovë, Gostivar, Dibër, Ohër, Strugë). Prej grupeve kërkohet që vetë të përcaktohen se cilat shtëpi do t'i hulumtojnë, në koordinim me mentorin/mësimdhënësin. 3. Nxënësve u shpjegohet se hulumtimi për secilin ndërtim, që përfshin edhe vizitën në terren, duhet t'i përmbajë elementet në vazhdim: <ul style="list-style-type: none"> ▶ informatat bazë për ndërtesën (vendshtirja, koha e ndërtimit, të dhëna për pronarin); ▶ kushtëzimet klimatike dhe të terrenit; ▶ struktura e përmbajtjes dhe forma e ndërtimit; ▶ zgjidhja konstruktive; ▶ formatimi i fasadës; ▶ rregullimi enterier. 4. Secilit grup të nxënësve i ndahet fleta e punës me udhëzime të detajuara për detyrën e tyre. Nxënësit, në kuadër të grupeve të veta, bashkë e shqyrtojnë detyrën e dhënë në fletën e punës dhe bëjnë planin për punë dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të grupit. 5. Nxënësit udhëzohen që të shfrytëzojnë materiale të shtypura dhe resurse të tjera nga interneti. Për këtë aktivitet me nxënësit organizohet vizita në terren, që ta kompletojnë hulumtimin e ndërtimeve. Me këtë rast i incizojnë objektet, bëjnë matjen dhe i fotografojnë elementet kyç të ndërtesave. Gjithashtu, bëhet intervistë me persona profesionalë/arkitektë nga institucionet në qytet (Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore, muze, etj.).

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

6. Pas mbarimit të hulumtimit, secili grup bën analizën dhe përmbledhjen e të dhënave të fituara dhe e përgatit tekstin për broshurën/katalogun, shoqëruar me fotografi të bëra nga hulumtimi në terren.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Secili grup i prezanton broshurat/katalogët e vet.
2. Zhvillohet diskutim strukturor nga ana e mësimit/ndërmjetës:
 - ▶ Cilat janë karakteristikat kryesore të arkitekturës krishtere maqedonase dhe të arkitekturës myslimane maqedonase?
 - ▶ Cilat ngjashmëri dhe dallime i vërejtët ndërmjet arkitekturës krishtere maqedonase dhe arkitekturës myslimane maqedonase?
 - ▶ Çka mendoni, cilat janë arritjet më të rëndësishme nga zhvillimi i arkitekturës tradicionale në Maqedoni?
 - ▶ Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet arkitekturës bashkëkohore dhe tradicionale në Maqedoni?



Detyra juaj është të hulumtoni për shtëpinë myslimane dhe krishtere, karakteristike për qytetin për të cilin u përcaktuat të bëni hulumtimin. Hulumtimi duhet të përfshijë kërkimin e të dhënave për karakteristikat e ndërtesave dhe vizitën në terren. Të dhënat e fituara paraqiten në broshurë/katalog, për t'u vënë pastaj në internet (në ueb-faqen e shkollës tuaj, në bllog e të ngjashme).

Broshura/katalogu duhet të përmbajë:

- ▶ vizatime dhe tekst për shtëpinë krishtere maqedonase dhe për shtëpinë myslimane maqedonase, bashkë me fotografitë ku janë paraqitur pjesët/elementet kyç të shtëpive;
- ▶ përshkrimi i ngjashmërive dhe i dallimeve ndërmjet shtëpisë krishtere maqedonase dhe myslimane maqedonase.

UDHËZIME PËR HULUMTIMIN E NDËRTIMEVE DHE VIZITA NË TERREN:

1. Shikoni pyetjet që do t'ju shërbejnë si udhëzime për hulumtimin dhe vizitën në terren e pastaj bëni planin e punës dhe ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve të grupit (mund të punoni në mënyrë individuale ose në çifte).
 - ▶ Në cilat pjesë të vendbanimit e kanë vëndshtrirjen dy shtëpitë për të cilat vendosët të bëni hulumtimin?
 - ▶ Kur janë ndërtuar dhe kush ka jetuar në ato shtëpi? A jeton ende ndokush aty?
 - ▶ Çfarë është struktura e përmbajtjes dhe formës te secila ndërtesë (ka të bëjë me aspektet në vazhdim: orientimi, horizonti, hapësirat, pozita e çardakut, pozita e shkallëve, ndarja në banesë dimërore/verore)?
 - ▶ Çfarë është sistemi i konstruksionit (shtyllat, trarët, muret bartës, konstruksioni i çatisë, konstruksioni ndërmjet kateve, themelet e supozuara)?
 - ▶ Si është formatimi i fasadës (ka të bëjë me aspektet në vazhdim: fasada e mureve, streha, dritaret, dyert, materialet, ngjyra, formatimi plastik)?
 - ▶ Si është rregullimi enterier (ka të bëjë me aspektet në vazhdim: muret, dritaret dhe dyert, gjërat e instaluara të shtëpisë, tavanet, dyshemetë, shkallët)?
2. Që të mund të përgjigjeni në pyetjet, shfrytëzoni materiale të shtypura dhe resurse të tjera nga interneti.
3. Gjatë vizitës në terren objektet duhet të incizohen, ndërsa elementet kyç të ndërtesave duhet t'i fotografoni. Gjithashtu, duhet të bëni intervista me pronarët dhe me personat profesionalë/arkitektë nga institucionet në qytet (Enti për Mbrojtjen e Monumenteve, muzetë, etj.) sipas përgatitjes së bërë prej më parë. Incizimi i objektit do të thotë të bëhen matjet.






UDHËZIME PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE DHE PËRGATITJEN E BROSHURËS/KATALOGUT

1. **HAPI 1** – Secili grup cakton liderin/koordinatorin e grupit, cakton detyrat për secilin anëtar në kuadër të grupit, i përpunon të dhënat e mbledhura nga hulumtimi dhe nga vizita në terren.
2. **HAPI 2** – Secili grup përgatit tekst dhe vizatime për shtëpinë krishtere maqedonase dhe për shtëpinë myslimane maqedonase, shoqëruar me fotografi që përfshijnë pjesë/elemente kyç të shtëpive.
3. **HAPI 3** – Grupet punojnë bashkërisht në analizimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet shtëpisë krishtere maqedonase dhe shtëpisë myslimane maqedonase dhe përgatisin vizatime, tekst dhe fotografi si arritje përfundimtare nga hulumtimi.
4. **HAPI 4** – Grupet bashkë e caktojnë ekipin dhe liderin/koordinatorin që do ta udhëheqë procesin e përpilimit të broshurës/katalogut.
5. **HAPI 5** – Broshura/katalogu prezantohet dhe publikohet.

SAPUNI DJE DHE SOT



Klasa	Drejtimi profesional/ Profili arsimor/ Programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I TRETË	KIMI-TEKNOLOGJI/ TEKNIK I KIMI-TEKNOLOGJISË/ TEKNOLOGJI	TEKNOLOGJIA PËR MJETET E HIGJENËS	PRODHIMI I SAPUNIT

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ njihet me llojet e lëndës së parë për prodhimin e sapunit; ▶ njihet dhe ta pranojë mënyrën dhe procesin e prodhimit të sapunit; ▶ shohë dallimin ndërmjet mënyrës tradicionale dhe bashkëkohore të prodhimit të sapunit;
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ dallojë mënyrën tradicionale të prodhimit të sapunit të religjione të ndryshme; ▶ dallojë mënyrën tradicionale nga mënyra bashkëkohore e fitimit të sapunit të religjione të ndryshme; ▶ njohë lëndët e para dhe procesin e punimit tradicional dhe bashkëkohor të sapunit të religjione të ndryshme; ▶ zhvillojë ndjenjën e respektit dhe të pranimit të kulturave të tjera.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Laptop, LCD-projektor, Hamer, Fllomasterë me ngjyra.
	KOHA	Një orë mësimore prej 45 minutash.
	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	<p>AKTIVITET HYRËS</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nxënësit i prezantojnë rezultatet nga hulumtimi², realizuar përmes tubimit dhe klasifikimit të të dhënave prej më parë të marra prej burimeve të ndryshme (literaturë profesionale, internet dhe, sipas mundësive, intervistë me persona më të vjetër nga religjione të ndryshme).

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

- Grupet kanë punuar në këto tema:
 - ▶ **Grupi i parë:** mënyra tradicionale e fitimit të sapunit te pjesëtarët e religjionit mysliman që jeton në R. të Maqedonisë.
 - ▶ **Grupi i dytë:** mënyra tradicionale e fitimit të sapunit te pjesëtarët e religjionit të krishterë që jeton në R. të Maqedonisë.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

- Nxënësit sërish ndahen në dy grupe, me qëllim që të bëjnë analizën e të dhënave të fituara nga hulumtimi. Në grupet e reja të formuara ka nxënës të cilët më parë kanë hulumtuar në të dyja temat.
- Analiza ka të bëjë me ngjashmëritë dhe dallimet gjatë fitimit të sapunit te pjesëtarët e religjioneve të ndryshme që jetojnë në R. të Maqedonisë.
 - ▶ **Grupi i parë** bën analizën e ngjashmërive dhe të dallimeve në lidhje me përdorimin e lëndës së parë gjatë punimit të sapunit dhe me këtë rast e shfrytëzon teknikën Diagrami i Venit.
 - ▶ **Grupi i dytë** bën analizën e ngjashmërive dhe dallimeve në lidhje me procedurën e fitimit të sapunit dhe me këtë rast e shfrytëzon teknikën skelet.
- Përfundimet nga analiza nxirren duke shtruar pyetjet:
 - ▶ Cilat lëndë të para janë të ngjashme, e cilat janë të ndryshme gjatë prodhimit të sapunit te pjesëtarët e religjionit mysliman dhe të krishterë?
 - ▶ Përse myslimanët kanë shfrytëzuar dhjamë gjedhi, ndërsa të krishterët dhjamë derri?
 - ▶ Pjesëtarët e besimit islam a kanë shfrytëzuar sapuna të fituar nga dhjami i derrit? Përse nuk kanë shfrytëzuar?
 - ▶ Pjesëtarët e besimit të krishterë a kanë shfrytëzuar dhjamë gjedhi, përse mendoni ashtu?
 - ▶ Çka mendoni, në kohën e sotme a shfrytëzohet dhjami i shtazëve gjatë prodhimit të sapunit?
- Mësimdhënësi e shpjegon mënyrën bashkëkohore të fitimit të sapunit.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Pyetjet për diskutim i referohen tërë procesit.

- ▶ Me cilat dilema u ballafaquat gjatë hulumtimit të mënyrave për fitimin e sapunit në rrugë tradicionale?
- ▶ Çka mësuar për mënyrën bashkëkohore të fitimit të sapunit?
- ▶ Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mënyrës tradicionale dhe bashkëkohore të fitimit të sapunit?
- ▶ Mënyra bashkëkohore e fitimit të sapunit a siguron shfrytëzim të sapunit nga të gjithë konsumatorët, pa dallim se cilit religjion i takon konsumatori?
- ▶ Çka mësuar të re për pjesëtarët e religjionit tjetër, të ndryshëm prej tuajit?
- ▶ Si u ndjetë derisa hulumtuat për kulturën së cilës nuk i takoni?
- ▶ Kur jeni më të pasur-kur dini vetëm për kulturën tuaj, apo kur dini edhe për kulturat tjera?





- I tërë procesi mund të zgjasë më shumë orë mësimore. Në këtë shembull artikullohet faza e prezantimit dhe e nxjerrjes së përfundimeve, që na jep mundësinë ta promovojmë konceptin multikulturor të temës prodhim i sapunit. Nxënësit hulumtojnë, përzgjedhin të dhëna, prezantojnë dhe njerrin përfundime. Grupet kanë punuar në këto tema:
Grupi i parë: mënyra tradicionale e fitimit të sapunit te pjesëtarët e grupit etnik shqiptar dhe/ose turk, përkatësisht nga religjioni mysliman që jeton në R. të Maqedonisë.
Grupi i dytë: mënyra tradicionale e fitimit të sapunit te pjesëtarët e grupit etnik maqedonas, përkatësisht të religjionit të krishterë që jeton në R. të Maqedonisë.

PRODHIMI TRADICIONAL KUNDREJT ATIJ BASHKËKOHOR I KREMRAVE

7



Klasa	Drejtimi profesional/ Profili arsimor/ Programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I TRETË	KIMI-TEKNOLOGJI/ PRODHUES I PRODUKTEVE KIMIKE DHE KOZMETIKE/ TEKNOLOGJIA E PUNËS	PREPARATE PËR KURIMIN DHE RUAJTJEN E LËKURËS	PRODHIMI I KREMRAVE

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ mund t'i identifikojë lëndët e para për prodhimin e kremrave për ruajtjen dhe kurimin e fytyrës; ▶ njohë llojet e kremrave; ▶ njihet me procesin e fitimit të kremrave për fytyrë.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ njohë lëndët e para dhe procesin e punimit tradicional (te pjesëtarët e religjioneve të ndryshme) dhe bashkëkohorë të kremrave për fytyrë; ▶ të dallojë mënyrën tradicionale të prodhimit të kremrave te pjesëtarët e religjioneve të ndryshme nga mënyra bashkëkohore e prodhimit; ▶ të zhvillojë ndjenjën e respektit dhe të pranimit të kulturave të tjera.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kompjuter. ▶ LCD-projektor. ▶ Skema teknologjike të prodhimit bashkëkohor të kremrave. ▶ Lëndët e para për fitimin e kremrave për fytyrë.
	KOHA	Dy orë mësimore prej 45 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

- ▶ Aktiviteti hyrës fillon ashtu që nga një përfaqësues i grupit i prezanton të dhënat nga hulumtimi³ (në formë elektronike ose të shkruar) në fillim të orës.
- ▶ Nxënësit kanë hulumtuar në dy grupe për mënyrën tradicionale të fitimit të kremit për fytyrë:
- ▶ **grupi i parë** ka hulumtuar në këtë temë për pjesëtarët e religjionit mysliman;
- ▶ **grupi i dytë** ka hulumtuar në këtë temë për pjesëtarët e religjionit të krishterë.
- ▶ Gjatë kohës së prezantimit mësimdhënësi shfrytëzon teknikën Diagram i Venit, ku i shënon të dhënat themelore deri te të cilat kanë arritur nxënësit në hulumtimin e temës. Teknikën do ta shfrytëzojnë për të bërë krahasimin e ngjashmërive dhe dallimeve gjatë fitimit të kremit për fytyrë në mënyrë tradicionale të të dy religjionet.
- ▶ Pas prezantimit të dy grupeve, mësimdhënësi hap diskutim me pyetjet në vazhdim:
 - » Gjatë hulumtimit a hasët në nocione të reja?
 - » Çfarë është e përbashkët, e çfarë është e ndryshme në mënyrën tradicionale të fitimit të kremit për fytyrë të pjesëtarët e të dy religjioneve?
 - » Cilat lëndë të para janë të nevojshme për të bërë prodhimin sipas të dy qasjeve?
 - » Cili ka qenë destinimi i shfrytëzimit të Hg dhe ZnO të kremrat??

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

AKTIVITETI 1

- ▶ Mësimdhënësi e shpjegon procesin e mënyrës bashkëkohore të fitimit të kremit për fytyrë të pjesëtarët e dy religjioneve. Me këtë rast shfrytëzon skema teknologjike si mbështetje në shpjegimin e procesit.
- ▶ Nxënësit punojnë në çifte. Gjysma e çifteve bëjnë krahasimin ndërmjet mënyrës tradicionale dhe bashkëkohore të prodhimit të kremit të pjesëtarët e religjionit mysliman. Pjesa tjetër e çifteve bëjnë krahasimin ndërmjet mënyrës tradicionale dhe bashkëkohore të fitimit të kremit të pjesëtarët e religjionit të krishterë.
- ▶ Në fund punojnë një poster të përbashkët ku do t'i lidhin elementet e përbashkëta nga të dy mënyrat e prodhimit, që është adekuate për punimin e një kremi të përbashkët që do të përgjigjet për pjesëtarët e të dy religjioneve.

3 Për nevojat e këtij aktiviteti mësimdhënësi u jep për detyrë nxënësve të vet që një javë përpara të bëjnë hulumtimin me temë: „Mënyra tradicionale e fitimit të kremit për fytyrë”. Për nevojat e këtij hulumtimi, mësimdhënësi i ndanë nxënësit në dy grupe, edhe atë:

grupi i parë do ta hulumtojë këtë temë për pjesëtarët e kulturës dhe të religjionit mysliman, ndërsa

grupi i dytë këtë temë do ta hulumtojë për pjesëtarët e kulturës dhe të religjionit të krishterë.

Në secilin grup të hulumtuesve duhet të formohen çifte nxënësish që do të shfrytëzojnë burime të ndryshme prej këtyre të ofruarave në vazhdim: literaturë profesionale – libra shkollorë dhe material të dorës, burime të internetit, intervistë me persona më të vjetër nga religjioni gjegjës, intervistë me persona profesionalë-praktikantë nga sfera e teknologjisë dhe e industrisë kozmetike.

PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

- ▶ Hapet diskutim përmes të cilit bëhet rezymimi i të dhënave të fituara të posterit:
 - » Sa ngjashmëri gjetët në të dy mënyrat e prodhimit të kremrave për fytyrë në të dy religjionet, dhe cilat janë ato?
 - » Sa dallime gjetët në dy mënyrat e prodhimit të kremrave për fytyrë në të dy religjionet, dhe cilat janë ato?

AKTIVITETI 2

- ▶ Nxënësit të ndarë në katër grupe përgatisin krem universal për fytyrë, receta e të cilit del nga të dhënat e posterit të përbashkët punuar nga klasa. (Për furnizimin me lëndën e parë të nevojshme nxënësit informohen në orën paraprake.)
- ▶ Për nxitjen e invencës, mësimmshënësi i inkurajon që t'i vënë emër të përbashkët produktit të tyre.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

Nxitet diskutimi i strukturuar përmes pyetjeve në vazhdim:





- ▶ Çka mësuar të re në lidhje me prodhimin e kremrave në mënyrë tradicionale te pjesëtarët e religjioneve të ndryshme?
- ▶ Mënyra bashkëkohore e fitimit të kremrave për fytyrë a i shfrytëzon lëndët e para që i kanë shfrytëzuar edhe në mënyrën tradicionale?
- ▶ Pjesëtarët e religjioneve të ndryshme sot a duan të kenë fytyrë sa më të bardhë?
- ▶ Çka mendoni, gjatë mënyrës bashkëkohore të prodhimit të kremrave për fytyrë a shfrytëzohen Hg dhe/ose ZnO?
- ▶ Ju a do t'i kishit rekomanduar dhe a do t'i kishit përdorur këto lëndë të para në prodhimin e kremit për fytyrë?
- ▶ Çka mendoni, në kohën e sotme a është e pranishme ende tradita e përgatitjes së kremrave sikurse në të kaluarën?



HACCP DHE HALLALL



Klasa	Drejtimi profesional/ Profili arsimor/ Programi mësimor	Tema nga programi mësimor	Njësia mësimore
VITI I KATËRT	KIMI-TEKNOLOGJI/ TEKNIK I USHQIMIT/ KONTROLLI I KUALITETIT	ZBATIMI I STANDARDEVE NË PROCESET PRODHUESE	STANDARDET NË INDUSTRIJË USHQIMORE

	QËLLIMET E MËSIMIT	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ kuptojë qëllimin dhe përmbajtjen e standardeve; ▶ dallojë llojet e standardeve.
	QËLLIMET E MËSIMIT MULTIKULTUROR	<p>Nxënësi/nxënësja të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ dallojë parimet e standardeve HACCP dhe HALLALL në pjesën e industrisë ushqimore; ▶ kuptojë nevojën e zbatimit të standardeve HACCP dhe HALLALL gjatë prodhimit, që të sigurojë besimin nga ana e të gjithë qytetarëve që jetojnë në RM, pa marrë parasysh religjionin e tyre; ▶ zhvillojë qasjen e hapur për tolerancë ndaj veçorive të kulturave në rrethinën tonë. ▶ zhvillojë ndjesinë e respektit, empatisë, besimit dhe të pranimit të kulturave të tjera.
	RESURSE	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Fletë pune. ▶ Laptop me lidhje interneti. ▶ Produkte ushqimore nga prodhues të ndryshëm dhe me artikuj të ndryshëm (disa prej tyre të prodhuara sipas HACCP, ndërsa disa sipas HACCP dhe HALLALL), që mund t'i sigurojë shkolla ose mbi bazë të marrëveshjes paraprake secili nxënës të sjell ndonjë prej produkteve.
	KOHA	Një orë mësimore prej 45 minutash.



PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

AKTIVITET HYRËS

1. Për fillim të ky aktivitet shfrytëzohet teknika rrush që të arrihet deri te definicioni i nocioneve: standard, proces prodhues dhe industri ushqimore.
2. Pastaj demonstrohen produkte të ambalazuara nga prodhues të ndryshëm dhe artikuj të ndryshëm ushqimorë dhe hapet diskutimi me nxënësit përmes pyetjeve në vazhdim:
 - ▶ Çfarë llojesh standardesh ka në industrinë ushqimore?
 - ▶ Nga ambalazhi i produkteve a mund të kuptoni se cilat standarde janë zbatuar gjatë prodhimit të produkteve?
 - ▶ Theksoni standardet që janë zbatuar gjatë prodhimit të produkteve të dhëna.
3. Rezultate të pritshme: HACCP dhe HALALL.

AKTIVITET PËR MËSIM DHE NXËNIE

1. Zbatohet teknika DI, DUA TË DI, MËSOJ (DDM).
2. Nxënësit ndahen në gjashtë grupe. Tre grupet e para punojnë në parimet e standardit HACCP (Fleta e punës 1), ndërsa tre grupet tjera në parimet e standardit HALLALL (Fleta e punës 2).
3. Nxënësit i plotësojnë dy kolonat e para nga tabela (DDM).
4. Varësisht prej asaj se në cilën problematikë punojnë, hulumtojnë në internet (shih linkun: <http://www.eufic.org/article/en/artid/Food-industry-standards-focus-on-HACCP/> dhe http://www.sudairy.com/mer/halal_guidelines_1.pdf) dhe e plotësojnë kolonën e tretë, ku theksohen informatat të cilat nuk kanë qenë të njohura prej më parë, e që i kanë mësuar gjatë kërkimit. Pas plotësimit të kolonës së tretë formohen tri grupe të reja, të cilat janë kombinim i nga një grupi që ka punuar në standardin HACCP, e tjetri që ka punuar në standardin HALALL.
5. Secili grup ka për detyrë të bëjë krahasimin e të dy standardeve dhe t'i paraqet ngjashmëritë dhe dallimet në Diagramin e Venit. Me këtë rast shfrytëzohet kolona e tretë nga Fletët e punës 1 dhe 2 si burim i të dhënave.

AKTIVITETI/REFLEKSIONI EVALUATIV

1. Grupet i prezantojnë rezultatet nga produkti final (Diagrami i Venit) duke bërë kështu analizën e asaj çka është e njëjtë, e çka është e ndryshme në parimet e këtyre standardeve.
2. Zhvillohet një diskutim i strukturuar nga ana e mësimeve:
 - ▶ Përse zbatohen standardet në proceset prodhuese?
 - ▶ Me futjen e standardit HACCP në ndërmarrje a rritet besimi i të gjithë konsumatorëve që jetojnë në RM?
 - ▶ Çka do të kishit bërë për ta fituar besimin edhe të konsumatorëve nga religjioni mysliman?
 - ▶ Kur ju do ta kishit hapur ndërmarrjen tuaj personale, çka do të kishit bërë që produktet tuaja të konsumohen nga të gjithë qytetarët e RM-së, pa bërë dallimin e përkatësisë së tyre fetare?
 - ▶ Çka do të kishit ndërmarrë që t'i njihni më të afërmit tuaj me standardin HALLALL dhe me zbatimin e tij në industrinë ushqimore?
 - ▶ A konsideroni se zbatimi i standardit HALALL e rrit besimin te konsumatorët?
 - ▶ Në çfarë mënyre ekzistimi i standardeve ushqimore ndikon në rritjen e tolerancës ndërreligjioze?

<u>TABELA</u> <u>DDM</u>	<u>DI</u> <u>Çka mendojmë</u> <u>se dimë</u>	<u>DUA TË DI</u> <u>Çka duam të</u> <u>mësojmë?</u>	<u>MËSOJ</u> <u>Çka mësuam?</u>

<u>TABELA</u> <u>DDM</u>	<u>DI</u> <u>Çka mendojmë</u> <u>se dimë</u>	<u>DUA TË DI</u> <u>Çka duam të</u> <u>mësojmë?</u>	<u>MËSOJ</u> <u>Çka mësuam?</u>

